



Building free of torture and impunity societies in Western Balkans



UDHËZUES PËR TË LUFTUAR MOSNDËSHKIMIN PËR TORTURË DHE SHKELJE TË TJERA TË TË DREJTAVE TË NJERIUT



Building free of torture and impunity societies in Western Balkans
An EU-funded project

Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut (Mal i Zi), Qendra Shqiptare për Rehabilitimin e Traumës dhe Torturës (QSHRT), Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut (Serbi)

Për botuesin

Nisma e të rinjëve për të drejtat e njeriut

Redaktore

Edina Hasanaga Çobaj

Autorët

Erinda Bllaca
Milan Radović
Zoran Vujičić
Ivan Kutlarović
Marko Milosavljević

Korrektura

Xhemal Perović

Përkthyer

Neli Rashović

Dizajni

Copy Center DOO, Podgorica

Shtypi

Copy Center DOO, Podgorica

Tirazhi

450

Каталогизација у публикацији
Национална библиотека Црне Горе, Цетиње

ISBN 978-9940-608-07-1
COBISS.CG-ID 30666512

ISBN 978-9940-608-07-1



9 789940 608071 >

PËRMBAJTJA

I PARATHËNIE	4
II HYRJE	5
III METODOLOGJIA	6
IV PARIMET DHE PËRKUFIZIMET	7
a) Mosndëshkimi	
b) Krime të rënda sipas të drejtës ndërkombëtare	
c) Qasja në drejtësi e viktimave dhe të drejtat e tyre	
d) E drejta për dëmshpërblim	
e) Juridiksioni universal	
V STRATEGJITË KRYESORE DHE UDHËZIMET PËR LUFTËN KUNDËR MOSNDËSHKIMIT	10
a) Përballimi me pengesat deri në arritjen e zbatimit të plotë të ligjeve	
b) Fuqizimi i OJQ-ve për të afirmuar drejtësi për viktimat	
c) Mbështetja e ndjekjes penale të zyrtarëve publik të përfshirë në torturë dhe keqtrajtim dhe thelbi i aftësisë për dënim	
d) Monitorimi i gjykimit	
e) Dhënia e ndihmës juridike falas	
f) Këshillimi për të drejtave të njeriut	
g) Procesi gjyqësor strategjik	
h) Pjesëmarrja në grupet e punës për amendimin e legjislacionit	
i) Monitorimi i institucioneve ku personat e privuar nga liria janë të ndaluar/të burgosur	
j) Linja telefonike SOS	
VI Aneks: Çrrenjosja e mosndëshkimit për shkelje të rënda të drejtave të njeriut	17
<i>Udhëzime të miratuara nga Komiteti i Ministrave më 30 Mars të vitit 2011 në mbledhjen e 1110-të të zëvendësministrave</i>	

I PARATHËNIE

Ky Manual është pjesë e projektit rajonal “Ndërtimi i shoqërive pa torturë dhe mosndëshkim në Ballkanin Perëndimor”, i cila është duke u implementuar nga Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut ((YIHR), anëtare e Aleancës Qytetare)) si partner kryesor dhe partnerët e mëposhtëm: Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut Serbi (YIHR SR), Qendra për Rehabilitimin e Traumës dhe Torturës nga Shqipëria (QSHRT) dhe Këshilli Ndërkombëtar për Rehabilitimin e viktimave të Torturës nga Danimarka (IRCT). Projekti financohet nga Bashkimi Evropian dhe do të implementohet nga nëntori i vitit 2013 deri në shtator të vitit 2016.

Qëllimi i projektit është të kontribuojë në krijimin e një shoqërie pa torturë përmes aktiviteteve të shoqërisë civile të cilat janë të drejtuara kundër torturës dhe trajtimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese ose ndëshkimit dhe përmes promovimit të standardeve ndërkombëtare, në veçanti të Protokollit Fakultativ të Konventës kundër Torturës (OPCAT).¹ Objektivi specifik është të përmirësojë qasjen në shërbime adekuate ligjore dhe ekspertizë për kategorinë e rrezikut të të burgosurve për të arritur ndryshime të rëndësishme të praktikave të paraburgimit të zyrtarëve publikë. Projekti parashikonte, ndër të tjera, aktivitetet e eksplorimit dhe dokumentimit e rasteve të torturës, trajtimit çnjerëzor dhe poshtëruës ose ndëshkimit dhe ofrimin e ndihmës juridike për personat e dënuar.

Konkretisht, misioni kryesor i organizatave tona në kontributin në luftën botërore kundër krimit të torturës është ndihma e viktimave për të siguruar një mjet juridik. Që nga krijimi ynë na ka kontaktuar një numër i të mbijetuarve të torturës ose grupe në emër të tyre dhe kanë punuar për të ardhur në kontakt me organet kompetente dhe për të krijuar marrëdhënie me praktikuesit. Për shkak të ekspertizës që kemi zhvilluar, ne kemi qenë në gjendje të promovojmë dinjitetin e njeriut në burgje përmes eliminimit të torturës dhe trajtimit çnjerëzor të personave të cënueshëm në paraburgim, sidomos të atyre që u përkasin grupeve të margjinalizuara shoqërore në Mal të Zi, Serbi dhe Shqipëri.

Krahas përpjekjeve për të promovuar të drejtat e njeriut të personave në paraburgim, ne gjithashtu kemi zhvilluar trajnime për stafin e burgjeve, si dhe stafin mjekësor në burgje dhe për studentët e drejtësisë dhe mjekësisë në kuadër të këtij projekti. Ne gjithashtu i implementuam vizitat studimore me qëllim që të përforcojmë kapacitetet e OJQ-ve në këtë fushë nëpërmjet shkëmbimit të eksperiencave bazuar në një qasje të fortë rajonale.

Ky manual është një komponent i rëndësishëm i një pakete për shumë shtete të materialeve që i dedikohen qasjes në nivel rajonal të çrrënjësjes së torturës, qasje më të mirë në drejtësi dhe luftë më të madhe kundër mosndëshkimit dhe neglizhencës. Ai është hartuar për të a) plotësuar angazhimin e tanishëm lokal të mbrojtësve të të drejtave të njeriut dhe OJQ-ve në ofrimin e shërbimeve ligjore për viktimat e shkeljeve të të drejtave të njeriut, b) siguruar bazë për monitorimin e paraburgimit dhe programet e trajnimit të përfaqësimit gjyqësor për mbrojtësit e të drejtave të njeriut, c) krijuar strategji të ndryshme për OJQ-ve dhe mbrojtësit e të drejtave të njeriut për të luftuar mosndëshkimin, të tilla si këshillim, monitorim i gjykimit dhe i kontestimit strategjik gjyqësor. Ai gjithashtu mund të ofrojë informata të dobishme për organizata të tjera dhe monitorues të të drejtave të njeriut në rajon që mund të gjenden të situatë kur mund t’u kërkohet të këshillojnë viktimat e torturës apo të ndjekin çështje në emër të tyre. Së fundi, ky manual mund t’u shërbejë avokatëve, juristëve dhe ligjvënësve për të nxjerrë në pah fushat e mundshme problematike dhe për të bërë një pikë krahasimi për sistemet e tjera ligjore në rajon.

Ne do të donim të falënderonim njerëzit e shumtë të cilët kanë kontribuar në punën tonë gjatë viteve të fundit dhe nga përvojat e bollshme e të cilëve ky Manual është përpiluar. Ne gjithashtu mezi sa presim të marrim përshtypjet nga ata të cilët do ta përdorin atë në punën e tyre të ardhme.

1 Do ta gjeni në adresën: <http://www.ohchr.org/EN/HRBodies/OPCAT/Pages/OPCATIndex.aspx>

II HYRJE

Mosndëshkimi rrjedh nga që këto shtete nuk kanë arritur që të përmbushin detyrimet e tyre për të hetuar shkeljet e të drejtave të njeriut dhe për të marrë masat e duhura ndaj autorëve, duke siguruar që të dyshuarit për përgjegjësi penale të ndiqen penalisht, gjykoen dhe dënohen në mënyrë të rregullt; si dhe për t'u siguruar viktimave mjete efektive dhe dëmshpërblim për lëndimet e pësuar. Gjithashtu, shtetet kanë detyrimin për të siguruar të drejtën e patjetërsueshme të viktimave dhe publikut për të ditur të vërtetën në lidhje me shkeljet, si dhe për të ndërmarrë hapa të tjera të nevojshme për të parandaluar një përsëritje të shkeljeve.

Pavarësisht nga këto detyrime, në vende të shumta, krimet më të rënda mbeten pa u ndëshkuar. Viktimat nuk guxojnë të flasin; autorët e krimit ose nuk gjurmohen ose nuk mund të gjenden; autoritetet nuk kanë vullnetin ose mjetet për të siguruar drejtësi. Mosndëshkimi ka pasoja katastrofale: ai lejon autorët të mendojnë se ata nuk do të kenë nevojë të përballen me pasojat e veprimeve të tyre; ai injoron ankthin e viktimave dhe shërben për të përjetësuar krimin. Mosndëshkimi gjithashtu dobëson institucionet shtetërore, mohon vlerat themelore të njeriut dhe poshtëron tërë njerëzimin.

Megjithatë, komuniteti ndërkombëtar ka shtuar përpjekjet e tij për të luftuar kundër mosndëshkimit, duke përfshirë komplementaritetin dhe bashkëpunimin midis juridiksioneve ndërkombëtare dhe juridiksioneve kombëtare. Kategoritë e krimeve sipas të drejtës ndërkombëtare kanë dalë nga Gjykatat ndërkombëtare duke filluar me Kartën Nurembergut e cila i referohet personave të akuzuar për krime kundër paqes, krime të luftës dhe krime kundër njerëzimit. Në vitet 1993 dhe 1994, dy Gykata ad hoc, u themeluan për të gjykuar krimet e rënda të kryera në ish-Jugosllavi (TPNJ) dhe Ruandë (TPNR). Në vitin 2002, Kombet e Bashkuara themeluan Gjykatën Speciale për Sierra Leone. Statuti i Romës i Gjykatës Ndërkombëtare Penale (GjNP) hyri në fuqi më 1 korrik 2002. Krimet mbi të cilat GjNP ka juridiksion dhe të cilat janë përcaktuar në Statutin e Romës përfshijnë krimet e gjenocidit, krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit, nga të cilat të gjitha përfshijnë torturën.

Megjithatë, juridiksioni i gjykatave ad hoc mbeti i kufizuar për sa i përket kohës dhe mundësive gjeografike. Për sa i përket GjNP-së, asaj i drejtohen vetëm për të gjykuar majën e ajsbergut të krimeve të rënda të së drejtës ndërkombëtare humanitare. Në të vërtetë, Statuti i Romës i GjNP-së e kufizon juridiksionin e saj për krimet e kryera që nga momenti i hyrjes së saj në fuqi, për rastet e referuara nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së, si dhe për krime të kryera në territorin e shteteve që janë palë në Statutin e Romës ose nga një shtetas i atyre shteteve që e kanë miratuar juridiksionin e GjNP-së. Për më tepër, dispozita e fundit është e vlefshme vetëm në rastet kur shtetet kompetente për të gjykuar krimet nuk i gjykojnë vetë autorët.² Në këto raste, çdo juridiksion vepron si gjykatë e komunitetit ndërkombëtar kur vendose mbi krime të rënda të së drejtës ndërkombëtare humanitare.

Globalizimi i drejtësisë penale nuk është, megjithatë, i kufizuar në krijimin e institucioneve të reja ndërkombëtare. Ai gjithashtu manifestohet në aplikime të caktuara madhështore të së drejtës ndërkombëtare, veçanërisht nëpërmjet praktikës gjyqësore. Një numër në rritje i gjykimeve të bazuara në juridiksionin universal janë kryer në disa shtete, të nxitura kryesisht nga viktimat dhe OJQ-të. Gjyqtarët janë duke u bërë më të vetëdijshëm për rolin që ata mund dhe duhet të luajnë për të luftuar mosndëshkimin. Nëpërmjet mekanizmave bazë të OKB-së, Gykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut³ dhe të Legjislacionit Parësor të Bashkimit Evropian (*acquis communautaire*), e drejta gjyqësore dhe parimet ndërkombëtare mund të jenë jashtëzakonisht të dobishme për luftën e përgjithshme kundër mosndëshkimit dhe veçanërisht për viktimat.

- 2 Gjykatat vendase mund të hapin proces gjyqësor në rast se një Gjykatë Ndërkombëtare ka vendosur të mos zhvillojë proces.
- 3 Gykata Evropiane ka theksuar se Konventa Evropiane është një “instrument i gjallë” dhe duhet të interpretohet “duke marrë parasysh kushtet e ditës së sotme” (Tyrer kundër Mbretërisë së Bashkuar (1979-80) 2 Raporti Evropian për të drejtat e Njeriut 1).

III METOLOGJIA

Ky Udhëzues ka për qëllim të pajisë praktikuesit e ligjit dhe OJQ-të me një mjet gjithëpërfshirës referimi për të dhënë këshilla të mira, ndihmë dhe përfaqësim të njerëzve të cilët kanë qenë viktime të torturës dhe trajtimit poshtërues dhe çnjerëzor, me theks të veçantë në rolin dhe përgjegjësitë e ofruesve të ndihmës ligjore gjatë hetimit, arrestimit, paraburgimit, seancave të dorëzimit, gjykimeve, ankimimeve dhe procedurave të tjera të ndërmarra për të siguruar se të drejtat njerëzore të viktimave të kimit janë të mbrojtura.

Udhëzuesi përmban parime të përgjithshme, si dhe udhëzime të veçanta dhe instruksione për avokatët dhe ata që ofrojnë shërbime ligjore për të ndihmuar gratë dhe grupet e tjera shoqërore të lëndueshme dhe të marginalizuara, siç janë fëmijët, të rinjtë, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, personat që jetojnë me HIV / AIDS, personat me aftësi të kufizuara fizike dhe mendore, personat që vuajnë nga sëmundje të rënda, kërkuesit e azilit dhe refugjatët, personat e zhvendosur brenda vendit dhe shtetasve të huaj të cilët mund të jenë të përfshirë në sistemin e drejtësisë në pozitën e personit të akuzuar ose viktimës. Përveç kësaj, Udhëzuesi shërben për të nxitur lexuesit për të adresuar pengesat që ata perceptojnë se janë duke parandaluar zbatimin e dispozitave të veçanta të ligjit, dhe për t'i inkurajuar ata që të vlerësojnë këto pengesa në dritën e procedurave të brendshme.

Objektivat që ky Udhëzues synon të përmbushë janë si në vijim:

- Të jap një pamje të përgjithshme të parimeve dhe përcaktimeve të cilat janë të rëndësishme për luftën kundër mosndëshkimit për shkelje të të drejtave të njeriut, me referencë të veçantë për torturën;
- Të shqyrtoj strategjitë e mundshme të mbrojtësve të të drejtave të njeriut dhe OJQ-ve për të ndihmuar luftën kundër mosndëshkimit në vendet e tyre dhe më gjerë, duke përfshirë edhe strategjitë e mundshme për kontest gjyqësor dhe avokim;
- Të zbuloj potencialin për përdorimin e përvojave dhe avantazheve të vëzhgimeve të gjyqësorit, me një fokus në mësimet e nxjerra nga çështjet përkatëse të Gjykatës së Strasburgut;

Udhëzuesi bazohet mbi përvojat dhe ekspertizën e organizatave partnere në ofrimin e ndihmës juridike për viktimat e kimit, duke ndihmuar ndjekjen penale të zyrtarëve publikë dhe nëpunësve civilë të përfshirë në çështjet e torturës dhe keqtrajtimit, si dhe në jurisprudencën e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, kur është e mundur.

IV PARIMET DHE PËRKUFIZIMET

A. Mosndëshkimi⁴

Ligji ndërkombëtar për të drejtat e njeriut imponon një detyrë mbi shtetet për të hetuar dhe ndjekur penalisht shkeljet e kryera brenda juridiksionit të tyre. Megjithatë, shumë shpesh, autorët e shkeljeve nuk sillen para drejtësisë dhe viktimat e torturës dhe shkeljeve të tjera mbeten pa një dëmshpërblim. “Mosndëshkimi” nënkupton pamundësinë, de jure ose de facto, që autorët e shkeljeve të përgjigjen për to - qoftë në procedura penale, civile, administrative ose disiplinore, - pasi ata nuk janë subjekt të ndonjë hetimi që mund të çojë në ndjekjen e tyre formale dhe, nëse konstatohet të jenë fajtor, duhet të dënohen me dënime të përshatshme dhe viktimat duhet të marrin dëmshpërblim.

B. Krime të rënda sipas të drejtës ndërkombëtare

Fusha e krimeve të rënda sipas ligjit ndërkombëtar shtrihet përtej kufijve të territoreve ku ato janë kryer. Kjo imponon një sfidë për ndërgjegjen publike, pasi ata që kryejnë këto krime konsiderohen si armiq të gjithë njerëzimit (hostes humani generis). Megjithatë, pyetja se çfarë përbën qëllimin e vërtetë të ligjit me të cilën merret e drejta penale ndërkombëtare nuk është zgjidhur përfundimisht. Statutet e GjPN-së, TPNJ-së, TPNR-së dhe gjykatave të tjera ndërkombëtare, të cilat plotësojnë juridiksionet penale kombëtare, kanë tendencë të përqëndrohen ekskluzivisht në tre kategori kryesore të krimeve: krime kundër njerëzimit, genocid dhe krime lufte⁵, të cilat ndiqen penalisht pothuajse gjithmonë në kontekstin e një konflikti të armatosur. Për qëllime të këtij udhëzuesi, kuptimi i “shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut dhe të së drejtës humanitare ndërkombëtare” përfshin, në veçanti, krime kundër njerëzimit, gjenocid, torturë, ekzekutime jashtëgjyqësore dhe zhdukje të detyruara (më tej “krime të rënda”). Kjo fushë mund të përfshij gjithastu dhe krimin e sulmit.

Në këtë kontekst, detyrimi për të parandaluar krime të rënda dhe për të luftuar mosndëshkimin është një normë e detyrueshme (jus cogens)⁶ e së drejtës ndërkombëtare, e cila është pjesë e luftës për drejtësi ndërkombëtare dhe përbën përgjegjësi për tërë bashkësinë ndërkombëtare, në bazë të së drejtës ndërkombëtare. Ndalimi absolut i torturës është bërë gjithashtu një normë e së drejtës të zakonshme ndërkombëtare. Shtetet kanë detyrim të pajtohen me të drejtën e zakonshme ndërkombëtare pavarësisht nëse ato janë palë në çdo konvent e cila e përfshin këtë normë. Megjithatë, sipas të drejtës ndërkombëtare, ekzistojnë disa institute që mund të ndikojnë në luftën kundër krimeve, duke përfshirë institutet e ekstradimit, imunitetit (si imuniteti racione personae dhe racione materiae) dhe amnistisë dhe duhet të merren në konsideratë si të tillë.⁷

- 4 Përkufizim i përdorur sipas Setit të azhuruar të parimeve për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut nëpërmjet veprimtari për të luftuar mosndëshkimin.
- 5 Ligji humanitar ndërkombëtar në kuptimin e përgjithshëm mbulon dy sete ligjesh: së pari ‘Ligji i Gjenevës’, që rrjedh nga një sere Konventash të Gjenevës para vitit 1864, dhe veçanërisht Konventat e Gjenevës të vitit 1949 dhe Protokolleve të tyre shtesë të vitit 1977, të cilat kërkojnë që të lehtësojnë vuajtjet e atyre që nuk janë përfshirë direct në luftime; dhe së dyti, ‘Ligji i Hagës’, që rrjedh kryesisht nga disa Konventa të Hagës, veçanërisht nga ato të viteve 1899 dhe 1907, si dhe nga Protokollin shtesë i 1977, që kërkon të rregullojë mjetet dhe metodat e bërjes së luftës.
- 6 Disa të drejta të pranuar ndërkombëtarisht janë konsideruar aq thelbësore sa kanë përfituar statusin e jus cogens. Termi është përcaktuar në Konventën e Vjenës 1969 për të Drejtën e Traktateve, si një normë e detyrueshme e së drejtës ndërkombëtare të përgjithshme ... [që është] i pranuar dhe i njohur nga bashkësia ndërkombëtare e shteteve si një normë nga e cila nuk lejohet asnjë përjashtim dhe e cila mund të modifikohet vetëm nga një normë e mëvonshme e së drejtës së përgjithshme ndërkombëtare që ka të njëjtin karakter. “
- 7 Komiteti i të Drejtave të Njeriut të OKB-së 262 ka deklaruar në komentën e tij të përgjithshëm mbi nenin 7 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike që, në lidhje me torturën:

C. Qasja në drejtësi e viktimave dhe të drejtat e tyre

Qasja në drejtësi është më shumë se përmirësimi i qasjes së një individi ndaj gjykatave ose garantimi i përfaqësimit ligjor. Ajo më tepër përcaktohet si aftësia e njerëzve për të kërkuar dhe për të përfituar një mjet juridik (dëmshpërblim) përmes institucioneve zyrtare dhe jozyrtare të drejtësisë në përputhje me standardet e të drejtave të njeriut. Qasje në drejtësi nuk ekziston kur qytetarët (sidomos grupet e marginalizuara) kanë frikë nga sistemi dhe nuk arrijnë ti qasen; ku sistemi i drejtësisë është i paarritshëm nga pikëpamja financiare; ku individët nuk kanë avokatë; ku ata nuk kanë informacion ose njohuri për të drejtat e tyre; ose kur ekziston një sistem i dobët i drejtësisë. Qasja në drejtësi, pra, përfshin mbrojtje normative ligjore, ndërjegjësim ligjor, ndihmë ligjore, gjykim, zbatimin dhe mbikëqyrjen e shoqërisë civile. Kjo do të thotë se këto të drejta nuk mund të rrezikohen dhe se të gjitha vendimet përfundimtare lidhur me këto të drejta duhet të ekzekutohen.

Lufta kundër pandëshkueshmërisë dhe për drejtësinë ndërkombëtare në kontekstin e aksesit në drejtësi nënkupton ekzistencën e burimeve dhe strategjive efektive lidhur me viktimat (në mënyrë direkte dhe indirekte), me qëllim që të mbrohen të drejtat e tyre. Këto të drejta përfshijnë: (a) të drejtën për të ditur të vërtetën rreth krimeve të rënda; (B) të drejtën për të arritur drejtësi, në veçanti, të drejtën për të: 1) arritur ndjekjen dhe gjykimin e autorëve të supozuar të krimeve të rënda nga një juridiksion penal; 2) marrë dëmshpërblim të përshtatshëm për dëmet e pësuar; 3) patur qasje, nëse është e nevojshme, në organet administrative.

Neni 13 i Konventës Evropiane parashikon gjithashtu se “çdo person të drejtat dhe liritë e të cilit, siç përcaktohet në këtë Konventë, janë shkelur duhet të përfitoj një mjet juridik efektiv përpara një organi shtetëror”. Ky qëndrim i Gjykatës është afirmuar në çështjen Askoy kundër Turqisë, duke deklaruar se “natyra e së drejtës e mbrojtur sipas nenit 3 ka implikime për nenin 13. Për sa i përket nenit 13, kur një individ ka një pretendim të argumentueshëm se ai ka qenë i torturuar nga agjentët e shtetit, ideja e një “mjeti juridik efektiv” përfshin, përveç pagimit të kompensimit sipas rastit, një hetim të plotë dhe efektiv të aftë për të çuar në identifikimin dhe dënimin e atyre që janë përgjegjës.”⁸

Konventa kundër Torturës (KKT) përcakton gjithashtu, në nenin 14, se: “Çdo Shtet Palë do të sigurojë në sistemin e tij juridik se viktimat e një akti torture të marri dëmshpërblim dhe të ketë të drejtë për një kompensim të favorshëm dhe adekuat, duke përfshirë mjetet për rehabilitimin e plotë në masën më të mundshme” (ky nen u referohet mjeteve të së drejtës penale dhe civile). E drejta për një mjet të efektshëm civil është dhënë edhe në nenin 2 (3) të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (KNDCP).

D. E drejta për dëmshpërblim

E drejta për dëmshpërblime është përpunuar në Parimet Themelore të Kombeve të Bashkuara dhe Udhëzimet për të drejtën për dëmshpërblim dhe kompensim për viktimat e shkeljeve të rënda të së Drejtës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut dhe Shkeljet e Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare, në veçanti në Parimet 15 - 24, dhe në Setin e Parimeve për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Njeriut me anë të Veprimtimit për të Luftuar.

Mosdëshkimin, Parimet 31 - 34. Parimet Themelore dhe Udhëzimet (2005)⁹ pohojnë rëndësinë

“amnistitë janë në përgjithësi të papajtueshme me detyrën e shteteve për të hetuar akte të tilla; për të garantuar lirinë nga akte të tilla brenda juridiksionit të tyre dhe për të siguruar që ato të mos ndodhin në të ardhmen “.

8 Mungesa e një hetimi të tillë, sidomos nga ana e prokurorit, përfshin një shkelje të nenit 13.

9 Do ta gjeni në adresën: <http://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/RemedyAndReparation.aspx>

e adresimit të çështjes së mjeteve juridike dhe dëmshpërblimit për viktimat e përmendura më sipër në mënyrë sistematike dhe të plotë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, duke rekomanduar se "shtetet duhet t'i marrin ato parime parasysh dhe t'i sjellin ato në vëmendjen e anëtarëve të organeve ekzekutive të qeverisë, në veçanti në vëmendjen e zyrtarëve të zbatimit të ligjit dhe ushtarakëve dhe forcave të sigurisë, organeve legjislative, gjyqësorit, viktimave dhe përfaqësuesve të tyre, mbrojtësve të të drejtave të njeriut dhe avokatëve, mediave dhe publikut në përgjithësi."

E drejta për dëmshpërblime është pohuar më tej nga një gamë e gjerë e dispozitave të traktateve ndërkombëtare, siç janë nenet 2 (3), 9 (5) dhe 14 (6) të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, si dhe në nenet 5 (5), dhe nenet 13 dhe 41 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Konventa Evropiane për Kompensimin e Viktimave të Krimeve të Dhunshme e 24 nëntorit 1983 dhe Rekomandimit të Këshillit të Komitetit të Ministrave të Evropës për shtetet anëtare mbi ndihmën ndaj viktimave të krimit të 14 qershorit 2006, gjithashtu rregullojnë mbrojtjen dhe përm-bushjen e të drejtës së dëmshpërblimit për viktimat e krimit.

Megjithatë, qëndrimet e gjyqtarëve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg janë të tilla që ata nuk e pranojnë shpërblimin e dëmit në procedurë civile që të konsiderohet si një mjet juridik efektiv për ankesa, për aspektin substancial të nenit 3 të Konventës: "Nëse autoritetet do të kufizojë reagimin e tyre ndaj incidenteve të keqtrajtimit policor të qëllimshëm për pagesën e thjeshtë të kompensimit, ndërsa nuk bëjnë sa duhet për ndjekjen dhe dënimin e personave përgjegjës, do të lihet mundësia që në disa raste agjentët e shtetit të abuzojnë me të drejtat e atyre që janë nën kontrollin e tyre duke mos u dënuar, dhe ndalimet e përgjithshme ligjore të vrasjeve, torturave dhe trajtimit çnjerëzor dhe degradues, pavarësisht nga rëndësia e tyre themelore, do të jenë të paefektshëm në praktikë" (shih, ndër të tjera, Nikolova dhe Velichkova kundër Bullgarisë, nr. 7888/03, paragrafi 55, 20 dhjetor 2007 dhe rastet e cituara aty).

Gjyqtarët Işıl Karakaş, András Sajó dhe Egidijus Kūris kanë mendim të ndryshëm për gjykimin Miliq / Nikeziq kundër Malit të Zi dhe ata e përmendën këtë çështje në paragrafët 74 dhe 75 të gjykimit. Në paragrafin 74 të gjykimit, thuhet që "Edhe duke supozuar se një kërkesë për dëmshpërblim në kontest gjyqësor civil brenda vendit mund të duket si një kompesim efektiv për ankimesin në bazë të aspektit thelbësor të nenit 3 të Konventës, Gjykata vëren se ankimesit në rastin konkret e kanë shfrytëzuar ilaçin juridik të propozuar nga Qeveria, prandaj, kundërshtimi i tij në këtë drejtim duhet të rrëzohet." Në paragrafin 75 të gjykimit të lartpërmendur, më tej thuhet se: "Në çdo rast, dhe pavarësisht nga ajo që konstatimet e Gjykatave vendase ishin të mjaftueshme në kuptimin konstatim të shkëljes, Gjykata është e mendimit se kompensimi në rastin në fjalë prej 1,500 EUR, që ju dhanë secilit ankimes në lidhje me dëmet jopasurore, nuk mund të konsiderohet si një zhdëmtim i duhur për shkeljen..."

E. Jurisdiksioni universal

E drejta ndërkombëtare imponon një detyrë mbi shtetet për të bërë pjesën e tyre për të luftuar mosndëshkimin. Megjithatë, një krim ndërkombëtar paraqet një vepër që kërkon bashkëpunim ndërkombëtar për ndjekjen e tij dhe për këtë arsye përfshin më shumë se një juridiksion vendas. Gjykatat vendase mund të, të shqyrtojë rastet kundër torturuesve të cilët vijnë në kuadër të juridiksionit të tyre mbi bazën e parimit të juridiksionit universal, gjë që duhet ta bëjnë gjithnjë. Ajo rrjedh nga një nevojë për koshencë ndërkombëtare për të trajtuar dobësinë e mekanizmave kombëtare të zbatimit të ligjit për të zhvilluar proces gjyqësor kundrejt palëve që janë jashtë juridiksionit dhe kanë asete jashtë tij.

"Juridiksioni universal"¹⁰ është e drejta e një shteti të institucionalizojë procedura ligjore dhe të

10 Parathënia e Statutit të GjPN përmban parimin e juridiksionit universal: "Duke pohuar se krimet më të rënda që përbëjnë shqetësim për komunitetin ndërkombëtar në tërësi nuk duhet të mbeten

ndjekë penalisht autorët e supozuar të një veprë penale, pavarësisht nga vendi ku është kryer vepra në fjalë, kombësisë ose vendbanimit të autorit të supozuar ose të viktimës. Kjo i lejon organet shtetërore dhe ndërkombëtare për të kërkuar ndjekje penale kundër një personi të akuzuar pavarësisht se ku është kryer krimi i supozuar, dhe pavarësisht nga kombësia akuzuarit, vendin e banimit, apo ndonjë lidhje tjetër me organin e akuzës. Arsyeja që qendron pas saj bazohet në idenë se “disa lloj krimesh janë aq të dëmshëm për interesat ndërkombëtare dhe prandaj shtetet janë të detyruara të hapin proces penal kundër autorit të krimit”. Është e rëndësishme të theksohet se ky juridiksion është i zbatueshëm në përputhje me rregullat e gjykimit të paanshëm, pa marrë parasysh nëse autori i supozuar në territorin e shtetit ose jo, dhe kjo aplikohet për krime të rënda në bazë të të drejtës ndërkombëtare.

V STRATEGJITË KRYESORE DHE UDHËZIMET PËR LUFTËN KUNDËR MOSNDËSHKIMIT

a) Përbalimi me pengesat deri në arritjen e zbatimit të plotë të ligjeve

Mungesa e njohurive për ligjin, të drejtat e njeriut, dhe të sistemit të drejtësisë penale është një problem i madh në mbrojtjen e të drejtave të njeriut në shumë vende. Njerëzit të cilët nuk i dinë të drejtat e tyre ligjore nuk janë në gjendje për ti zbatuar ato dhe janë subjekt i abuzimit në sistemin e drejtësisë penale, veçanërisht grupet e cënueshme siç janë fëmijët, të rinjtë, gratë dhe refugjatët.

Të gjithë sëbashku, policia, prokurorët, gjykatësit dhe avokatët mbrojtës janë komponentët themelore të sistemit të drejtësisë dhe ata të gjithë duhet të bëhen më të vetëdijshëm për dispozitat kryesore të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurave Penale. Praktika e korruptuar mund të përsëritet, duke ngatërruar rrugën midis ndërgjegjshmërinë për ekzistencën e ligjit dhe zbatimin e tij të plotë. Avokatët mbrojtës dhe praktikuesit e të drejtave të njeriut janë shumë të interesuar që ligjet të zbatohen.

Mungesa e respektimit të ligjit të shkruar është pengesa kryesore për praktikuesit e të drejtave të njeriut, të cilët dëshirojnë të mbrojnë të drejtat e klientëve të tyre dhe të sigurojë një mbrojtje të përshtatshme. Efektiviteti i pothuajse të gjitha mjeteve të avokatëve mbrojtës varet nga parashikueshmëria dhe përgjegjshmëria e krijuar nga respektimi rigoroz i Kodit Penal dhe Kodit të Procedurave Penale. Prandaj, trajnimi i praktikuesve të të drejtave të njeriut për tu ballafaquar me divergjencat midis sistemi ligjor të përbërë nga kodet e lartpërmendura nga njëra anë, dhe praktikës aktuale, nga ana tjetër, është mjeti më premtues për të eliminuar këtë boshllëk dhe mund të shfrytëzohet me sukses nga OJQ-të dhe grupet e mbrojtësve të të drejtave të njeriut për të mbështetur trajnimin për çështjet e mosndëshkimit dhe të drejtave të njeriut.

Zhvillimi i një kuptim të plotë të kësaj mënyrë të veçantë është thelbësore, për arsye se kemi të bëjmë me rrethana aktuale në të cilat pengohet ecja drejt zbatimit të ligjit të shkruar. Nëpërmjet zbatimit të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe pranimin e juridiksionit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, potenciali për zhvillimin e një kuptimi më të thellë të të drejtave të njeriut në Mal të Zi, Shqipëri dhe Serbi është zgjeruar në mënyrë të konsiderueshme. Me një kuptim të tillë të zgjeruar të të drejtave të njeriut, praktikuesit dhe mbrojtësit e të drejtave të njeriut mund të punojnë së bashku për të zhvilluar strategji specifike për të ndryshuar rrethanat me rastet e tyre. Vetëm duke konfrontuar direkt supozimin se nuk kemi asnjë mundësi për të bërë diçka, është e mundur për të ndërtuar një konsensus të ri për atë që përmirësimet në zbatimin e ligjit janë të mundshme.

b) Fuqizimi i OJQ-ve për të afirmuar drejtësi për viktimat

Përfshirja aktive e shoqatave dhe organizatave të shoqërisë civile është thelbësor për të siguruar një progress të vazhdueshëm drejt plotësimin të të drejtave ndërkombëtare të njeriut. OJQ-të - ndër të tjera - ndihmojnë shtetet për të siguruar respektimin e plotë të të drejtave të njeriut, lirive themelore, demokracisë dhe sundimit të ligjit. Pra, njohuritë e OJQ-ve dhe institucioneve në lidhje me instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe rrugëve të mundshme për zbatimin e tyre janë një parakusht i rëndësishëm për të luftuar mosndëshkimin.¹¹ Dispozitat e Konventës Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, Konventës kundër Torturës dhe Konventës Ndërkombëtare mbi Zhdukjet me Forcë janë disa nga instrumentet ndërkombëtare të një rëndësie të veçantë, e prandaj OJQ-të dhe mbrojtësit e të drejtave të njeriut duhet të njihen mire me to. Seti i freskuar i Parimeve të OKB-së për të luftuar mosndëshkimin paraqet gjithashtu një instrument të fuqishëm për riorganizimin e luftës kundër mosndëshkimit, në përputhje me standardet kryesore ndërkombëtare. Disa nga temat e gjera të përfshira në Parimet Freskuara për të luftuar mosndëshkimin janë të drejtat e patjetërsueshme të viktimave të dinë të vërtetën, detyrimi për të kujtuar ata, e drejta për drejtësi, e drejta për dëmshpërblim dhe të drejtën për garanci të mos-përsëritjes së shkeljeve në fjalë. Ajo gjithashtu përcakton parimet të cilat i referohen garantimit të pavarësisë, paanshmërisë dhe aftësisë për zbardhjen e të vërtetës të komisioneve të caktuara për të luftuar mosndëshkimin dhe rregullon ruajtjen e qasjes në arkivat që ruajnë dëshmi për shkeljet.

Për shkak të njohurive dhe përvojës së tyre në lidhje me qasjen ndaj drejtësisë dhe të të drejtave të njeriut, OJQ-të, juristët dhe gazetarët janë të pozicionuar mirë për të luajtur një rol të rëndësishëm tërhequr vëmendjen e organeve shtetërore për shkeljet më flagrante të të drejtave të njeriut dhe për modelet e mosndëshkimit të mundshëm të tyre. Denoncimi publik i shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe mosndëshkimi për akte të tilla, shpesh mund të luajë një rol të dobishëm dhe konstruktiv në nxitjen për ndërmarrje veprimesh nga ana e autoriteteve shtetërore. Pra, ata me veprimtarinë e tyre mund të ndihmojnë për këto veprime, duke përfshirë këtu viktimat që janë torturuar, në emër të të cilëve ata veprojnë. Përvoja ka treguar se ndërhyrja e të viktimave të torturës, si dhe OJQ-të, shpesh mund të japin nxitjen kryesore pa të cilën nuk do të ishte nisur një ndjekje penale. Përveç kësaj, ndjekja e atyre që janë përfshirë në torturimin e tyre shpesh i jep nxitje viktimave të torturës për tu përpjekur që të fitojnë të drejtën, gjë që më vonë mund ti ndihmojnë ata për të vazhduar jetën e tyre. Marrja e lajmit se torturuesi i tyre është pranë, ka gjasa që ti rikthejë në mendjen e çdo viktime kujtimet e ngjarjeve dhe efektet e tyre. Megjithatë, në mënyrë që të mund të llogaritet në mbështetjen nga ana e viktimave të mbijetuara, mbrojtësit e të drejtave të njeriut dhe OJQ-të duhet të investojnë përpjekje për motivimin dhe përgatitjen e tyre për çështjet gjyqësore të mundshme, duke përfshirë këshillime ligjor të përshtatshme, mbështetjen dhe / ndihmën psikologjike mjekësore, në varësi me nivelin e traumave që ju janë shkaktuar viktimave.

c) Mbështetja e ndjekjes penale të zyrtarëve publik të përfshirë në torturë dhe keqtrajtim dhe thelbi i aftësisë për dënim

Ndalimi i përgjithshëm ligjor i vrasjes, torturës dhe trajtimit çnjerëzor dhe degradues është shpesh joefektiv në praktikë. Prandaj, ekziston nevoja që OJQ-të vazhdimisht të vënë në dukje rrezikun e mosndëshkimit, në qoftë se autoritetet e kufizojnë reagimin e tyre ndaj keqtrajtim në ndalimin policor dhe burg vetëm me pagimin e kompensimit për dëmin e pësuar dhe nëse autoritetet nuk kanë bërë përpjekje të mjaftueshme në ndjekjen penale dhe ndëshkimin e zyrtarëve shtetërorë përgjegjës. Këtu, duhet të kihet parasysh se vepra penale e torturës është fokusuar tek ata persona që kanë pozita zyrtare shtetërore e që abuzojnë me pushtetin e tyre dhe të vihet në dukje se Neni 1 i Konventës Torturës parashikon që roli i autoriteteve shtetërore nuk duhet të konsiderohet që ka kufizime kur aktet e torturës janë kryer. Ai thotë se akti duhet të jetë "i shkaktuar nga, ose me nxitjen,

11 Mund ta gjeni në adresën: http://www.impunitywatch.org/docs/UN_Updated_Principles_to_Combat_Impunity.pdf

ose me pëlqimin, ose aprovimin e një zyrtari shtetëror ose të një personi që vepron me cilësinë e zyrtarit". Trajtimi do të konsiderohet torturë vetëm në rast se autorët me vullnet dhe qëllimisht e kryen këtë vepër.¹²

Ka shumë mënyra me të cilat OJQ-ve dhe mbrojtësit e të drejtave të njeriut mund të ndihmojnë ndjekjen penale të zyrtarëve publikë të përfshirë në tortura dhe keqtrajtime dhe paraqesin rrethanat kryesore për dënimin e mundësinë të tyre. Identifikimi dhe ndëshkimi i çdo autori të supozuar nxjerr në pah thelbin e qëllimit të dënimit, dhe OJQ-të duhet të bëjnë vazhdimisht presion mbi autoritetet për të zhvilluar procedura penale urgjente, të paanshme dhe efektive në të gjitha rastet e akuzave për torturë, keqtrajtimi dhe trajtimi ose ndëshkimi çnjerëzor. Roli i OJQ-ve dhe mbrojtësve të drejtave të njeriut në fillimin e ndjekjes penale të të akuzuarve për torturë dhe keqtrajtim, si dhe mbështetja e saj, është shumë e rëndësishme në kontekstin e: a) këshillimeve për kryerjen e hetimeve efektive nga shteti, b) mbledhjen e dëshmive për të mbështetur akuzat penale ndaj autorëve, c) ndjekjen e rasteve në emër të viktimave dhe / ose duke ju ofruar atyre ndihmën e nevojshme ligjore dhe mbështetje gjatë dhe pas ndjekjes penale dhe gjykimit.

Megjithatë, mund të vihet në diskutim çështja pse OJQ-të duhet të përfshihen ligjërisht në emër të të mbijetuarve të torturës në ndjekjet penale, kur, përveç rasteve të padive private, rasti do të trajtohet nga Prokuroria e Shtetit. Një shqetësim i shprehur ishte a do të jenë gjithmonë në gjendje këto organizata për të paraqesin dëshmi në një formë që do të ishte e pranueshme në gjykatë. Megjithatë, eksperiencia praktike provon se ndjekja e rasteve të tilla kërkon një përfshirje aktive të palëve të tjera që kanë interes të justifikuar në nxjerrjen para drejtësisë të personave në fjalë. Gjithashtu eksperiencia tregon se roli i luajtur nga OJQ-të në hartimin e informacionit, duke siguruar që të tërhiqet shpejt vëmendja e autoriteteve kompetente për shkeljet, dhe në ndihmën për grumbullimin e provave nga ana e policisë, ka qënë shumë i rëndësishëm.

Përveç kësaj, OJQ-të mund të lehtësojnë përfshirjen e të mbijetuarve të cilët shpesh kanë informacione të dobishme për ti deklaruar, si dhe dëshmojnë me cilësinë e dëshmitarit për rrethanat e krimit. Në mënyrë të veçantë, mund të përmenden tre raste gjatë një hetimi penal, kur informacioni i dhënë nga të mbijetuarit e torturës mund të jetë kritik në qoftë se hetimi do të zhvillohet. Rasti i parë këtu është në pikën kur identiteti i një personi të dyshuar për përfshirje në akte të torturës është sjellë në vëmendjen e autoriteteve. Nuk ka asnjë diferencë nëse të mbijetuarit e torturës apo OJQ-të i tërheqin ligjërisht vëmendjen policisë për torturuesin. Së dyti, sapo të jetë kryer një arrestim, të mbijetuarit e torturës dhe OJQ-të janë shpesh në gjendje të japin informacion të vlefshëm për të vazhduar me një ndjekje penale. Së treti, provat që të mbijetuarit e torturës paraqesin ka të ngjarë të jenë vendimtare kur çështja është kaluar para gjykatës.

d) Monitorimi i gjykimit

Pavarësisht nga një praktikë gjyqësore relativisht e kufizuar në lidhje me torturën dhe keqtrajtimin, OJQ-të duhet të bëjnë përpjekje për të kryer monitorimin e gjyqeve që përfshijnë zyrtarët publikë të dyshuar për kryerje torture, keqtrajtimi dhe trajtimi ose ndëshkimi çnjerëzor. Arsyeja për këtë qëndron në faktin se vëzhgimet e gjykimit pajisin OJQ-të me konstatime të rëndësishme të bazuara në dëshmi, të cilat mund të mbështesin mjaft mirë veprimtarinë e tyre këshillimore dhe për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve të tyre për ndihmën ligjore falas të destinuar për viktimave e shkeljeve të të drejtave të njeriut. Megjithatë, ka disa udhëzime që duhet të kihen parasysh të zbatohen nga monitoruesit dhe organizatave në fjalë para fillimit të një vëzhgimi gjykimi për të siguruar objektivitetin e monitorimit të gjykimit, e si rrjedhojë e kësaj, edhe përgjegjshmërinë e palëve të interesuara kryesore në drejtim të konkluzioneve dhe rekomandimeve të tij kryesore.

Duke ditur se efektiviteti i çdo vëzhgimi të gjykimit varet drejtpërdrejt nga cilësia e hulumtimit dhe përgatitjes që është ndër marrë paraprakisht, përgatitjet plotë praktike duhet të kryhen para se të

fillojë vëzhgimi i gjykimit. Objektivat e monitorimit të gjykimit dhe mandatin e vëzhguesve duhet të para-përcaktuar në mënyrë që të kemi një proces efektiv dhe efikas të monitorimit të gjykimit. Është e nevojshme që të kryhet një përzgjedhje e kujdesshme e rasteve që do të monitorohen. Kjo ka të ngjarë të varet nga fusha e veprimtarisë OJQ-së, të prioriteteve të saj dhe të interesit që ajo ka për një rast të veçantë. Vëzhguesit, për të qënë në gjendje të monitorojnë procedurën e procesit penal dhe ndryshimit të avokatëve, duhet të kenë kapacitet të mjaftueshëm njohurish në lidhje me standardet e gjykimit të paanshëm. Kjo përfshin hulumtimet e mëparshme të kryera nga monitoruesit të tjerë, ku të jetë e mundur, duke përfshirë mbledhjen e informacionit në lidhje me të ligjet dhe procedurat ligjore vendase, ligjet ndërkombëtare në fuqi, si eksperiencën për konstatimin e fakteve dhe të misionëve të mëparshme të vëzhgimit gjyqësor në vend. Vetë monitorimi duhet të udhëhiqet gjithmonë nga parimet e objektivitetit, transparencës dhe mosndërhyrjes në procesin e gjykimit. Kjo do të thotë se vëzhguesit duhet të mos ndërhyjnë duke shkaktuar ndërprerjen e procedurës gjyqësore. Ata duhet të përqëndrohen në aspektet procedurale të gjykimit, dhe jo në marrjen e forms së prerë të vendimit të gjykatës.

Për shkak të rëndësisë së tyre, rezultatet e monitorimit duhet të pasyrohen në raportet e rregullta dhe speciale të OJQ-ve të cilat duhet të theksojnë si zhvillimet pozitive, ashtu edhe parregullsitë dhe mangësitë e proceseve gjyqësore të zbuluara gjatë monitorimit të gjykimit, të cilat mund të ndikojnë në mbajtjen gjallë të mosndëshkimit në praktikë, ose tregojnë paaftësinë e gjykatës. Këto, për shembull, mund të tregojnë caktimi e shpeshtë të dënimit me

kusht për oficerët e policisë dhe personelit të burgut për keqtrajtim dhe trajtim çnjerëzor. Përmes monitorimit të gjykimit, OJQ-të mund të zbulojnë informata të cilat mund të bëhen publike dhe mund të tregojnë rastin që zyrtarët publikë, të cilët janë shpallur fajtor për kryerjen e torturës, i kanë shpëtuar dënimit. Ato gjithashtu mund të japin njoftime për parashkrimin (vjetërimin) e ndjekjes penale.

e) Dhënia e ndihmës juridike falas

Puna dhe këmbëngulja e OJQ-ve jep kontribut të rëndësishëm në luftën kundër mosndëshkimit, përmes ofrimit të ndihmës juridike falas. Duke pasur parasysh se viktimat e torturës dhe keqtrajtimin zakonisht janë qytetarë të cilët kanë vuajtur shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut dhe pjestarë të grupeve shoqërore të marginalizuara, që shpesh nuk kanë ndihmë të mjaftueshme ligjore dhe mbështetje. Duke ofruar shërbime falas të ndihmës juridike, OJQ-të mund të kontribuojnë ndjeshëm në dënueshmërisë, dmth, të procedimit penal dhe përcaktimin e përgjegjësisë. Ndihma ligjore, që mund të sigurojnë organizatat e shoqërisë civile, përfshin dhënien e informacionit të përgjithshëm ligjor, këshilla ligjore, përgatitjen e dokumenteve dhe parashtrësive dhe përfaqësitë.

YIHRMNE ka ofruar ndihmë ligjore falas në rastin e Miliq / Nikeziq kundër Malit të Zi përpara Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut në Strasburg që nga fillimi i tij. Vendimi gjyqësor i marrë këtë rast ishte në favor të qytetarëve të cilëve u kemi dhënë ndihmë ligjore falas dhe teza se drejtësia është e arritshme u konfirmuar, gjë që përfaqëson një kënaqësi e madhe për YIHRMNE që punoi për të. Domethënë, Vendimi gjyqësor tregoi për mangësi të shumta në funksionimin e sistemit gjyqësor në Mal të Zi, duke përfshirë shkelje të nenit 3 të Konventës, sepse përcaktoi që shteti nuk arriti të kryejë hetim të plotë dhe të pavarur. Ne kujtojmë se Prokuroria Themelore Shtetit hodhi poshtë akuzat penale për veprat penale të torturës dhe keqtrajtimin, për shkak se nuk ka pasur elemente të rëndësishme për të treguar ekzistencën e veprës penale kallëzuar në veprimet e zyrtarëve të EKSP-së, apo të ndonjë vepër tjetër penale e cila ndiqet me detyrë zyrtare (ex officio). Gjykimi tregoi gjithashtu se vendimet e prokurorit të shtetit për të pezulluar procedurën penale nuk ishin të bazuara në vlerësimin e duhur të gjitha faktet përkatëse ishin në dispozicion në këtë rast, në veçanti të atyre përcaktuara nga Avokati i Popullit dhe të rezultateve të procesit disiplinor.

f) Këshillimi për të drejtave të njeriut

Këshillimi për të Drejtat e Njeriut është provuar që është një strategji efektive për përparimin e axhendës së të drejtave të njeriut dhe duke bërë thirrje për një përgjegjësi më të madhe për shkeljet e të drejtave të njeriut, si dhe që është një mjet i rëndësishëm për luftimin e mosndëshkimit për shkelje të të drejtave të njeriut. Ajo i ndihmon OJQ-të promovuar një kuptim më të thellë të të drejtave të njeriut në të gjitha grupet e ndryshme të palëve të interesuara dhe për të nxitur marrëdhënie reciprokisht të dobishme me një gamë të gjerë politikë-bërësish, donatorësh, organizatash, mediash dhe individësh. Gjatë shumë viteve, Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut, Nisma e të Rinjve për Serbinë të Drejtat e Njeriut dhe Qendra e Rehabilitimit për Traumës dhe Torturës nga Shqipëria kanë tërhequr në mënyrë të përsëritur vëmendjen e autoriteteve vendore, organizatave ndërkombëtare dhe organet e traktateve të çështjeve aktuale shqetësuese që pengojnë punën e tyre në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si dhe për rreziqet serioze me të cilat ata përballohen here pas here.

Zakonisht, OJQ-të janë të angazhuara me dhënien e njoftimeve për publikun vendas, autoritetet shtetërore dhe organizatat ndërkombëtare, duke përfshirë KPT-së (Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës) dhe OSBE / ODIHR për rastet e mundshme dhe aktuale të torturës dhe keqtrajtimit, duke përshkruar rrethanat për secilin rast, Mbron të drejtat e viktimave dhe duke këmbëngulur në nxjerrjen e autorëve para drejtësisë. Këto veprime mund të kryhen në formë të veprimeve ad hoc, kur paraqitet ndonjë rast, ose si pjesë e një këshillimi më të gjerë të vazhdueshëm dhe të fushatave të nxitjes së ndërgjegjësimit të publikut.

OJQ-të mund tu paraqesin raporte alternativë ose "hije" organeve të traktateve ndërkombëtare, të cilat ofrojnë një pikëpamje alternative të pajtueshmërisë të shtetit me detyrimet e traktatit. Zakonisht, raportet "hije" hartohen në bazë të informatave që përmbahen në raportet e organeve shtetërore dhe sigurojnë një analizë alternative. OJQ-të e akredituara gjithashtu mund të monitorojnë si vëzhgues shumicën e procedimeve të Komiteteve të OKB-së (p.sh. Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave, etj). Indeksi i të Drejtave Universale të Njeriut¹³, i projektuar dhe i mbajtur nga Zyra e Komisionerit të Lartë të OKB-së për të Drejtat e Njeriut, është hartuar kryesisht për të lehtësuar qasjen në dokumenta të të drejtave të njeriut të nxjerra nga organet e traktateve të drejtave të njeriut të OKB-së dhe mund tu sigurojë OJQ-të një mjet të ri për të kërkuar vëzhgimet dhe rekomandimet e këtyre organeve të specializuara.

Pjesëmarrja në kontributin e dhënë për Raportin e Progresit të vendit në integrimin në BE gjithashtu të hap një vend të rëndësishëm për ndikim më të lartë të OJQ-ve për nivelin e respektimit të të drejtave të njeriut në vendet candidate të BE-së. Ajo i pajis OJQ-të me një mundësi për të sjellë pikëpamjet e tyre që tregojnë gjendjen e të drejtave të njeriut në vendin e tyre dhe për të kanalizuar më mirë zërat e viktimave ndaj Komisionit Evropian dhe Parlamentit Evropian. Takime me përfaqësues të këtyre institucioneve mund të shërbejë për të mbështetur ndryshimet para aktorë të rëndësishëm ndërkombëtarë.

g) Procesi gjyqësor strategjik

Procesi gjyqësor strategjik është një metodë që mund të bëjë ndryshime të rëndësishme në ligje, praktika apo ndërgjegjësimit publik nëpërmjet shfrytëzimit me kujdes të rasteve të zgjedhura në gjykata. Kjo metodë përfshin një organizatë apo një individ duke e marrë në një çështje ligjore, si pjesë e një strategjie më të gjerë për të arritur ndryshime sistematike sepse përfituesit e përfshirë në proceset gjyqësore strategjike janë shpesh viktimat të shkeljes së të drejtave të njeriut, gjëra këto që i kanë vuajtur edhe shumë njerëz të tjerë. Rëndësia e procesit gjyqësor strategjik qëndron në faktin se ai mund të krijojë ndryshime ose përmes suksesit të veprimit dhe të ndikimit të tij në ligj, duke vendosur precedent të rëndësishëm të praktikës gjyqësore, ose duke vënë në dukje publikisht padrejtësinë, ngritjen e vetëdijes dhe gjenerimin e një sërë ndryshimesh. Është e rëndë-

sishme që procesi gjyqësor strategjik është përdorur si pjesë e një fushate më të gjerë, në mënyrë optimale, si pjesë e veprimeve të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, se sa duke u konceptuar si një qëllim në vetvete.

Ka arsye shumë të forta për ndjekjen e rasteve për procese gjyqësore strategjike. Së pari, çdo rast i paraqitur ka të ngjarë të ketë një ndikim në ligjin në zhvillim. Raste të profilit të lartë i kanë dhënë shtysë si akademikëve ashtu dhe praktikuesve për të shqyrtuar ligjin dhe vlerësojnë efektivitetin e tij. Eksperiencia e fituar nga këto raste dhe frekuenca më e madhe e ndërgjegjësimit dhe arrestimeve nxjerrë në pah se këto janë çështje të cilat nuk do të shkojnë larg vetë. Për më tepër, efektet e rastësishme të procesit gjyqësor strategjik, siç janë mbulimi mediatik më i madh dhe vendosjen e një çështje përpara opinionit publik, mund të jenë të rëndësishme, sidomos në rastet e torturës dhe keqtrajtimit, edhe në qoftë se rasti vetë dështon. Kur marrim në konsideratë proceset gjyqësore strategjike si një strategji të mundshme për luftimin e mosndëshkimit, ajo do të jetë e rëndësishme për të kuptuar se çfarë duan viktimat dhe çfarë efekti do të ketë tek ata përfshirja e tyre në të.

Megjithatë, ekzistojnë disa kufizime në lidhje me proceset gjyqësore strategjike. Së pari, ata mund të jenë të kushtueshëm dhe të vënë një tendosje të madhe mbi burimet. OJQ-të duhet të kenë kapacitetin njerëzor për të marrë përsipër një proces gjyqësor strategjik të propozuar. Kjo mund të rezultojë që një aplikant i pasuksesshëm të paguajë shpenzimet gjyqësore të palës kundërshtare. Për më tepër, nga natyra e tij, procesi gjyqësor është e pasigurt dhe për këtë arsye nuk garanton një rezultat të suksesshëm për kërkuesit. Avokatët që marrin në konsideratë një proces gjyqësor strategjik duhet të jenë të vetëdijshëm për organet rajonale që mund të shfrytëzohen në një nivel më të lartë apo të përfshihen në strategjitë lokale. Megjithatë shpesh ndodh që të gjitha ilaçet ligjore efektive vendase mund të ezaurohen para se çojnë një ankimim në një forum rajonal apo ndërkombëtar, duke përfshirë edhe në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Organizmat ndërkombëtarë që marrin ankimime, siç janë organet e traktateve apo komisionet të cilat janë të krijuara për të mbikëqyrur zbatimin e traktateve kryesore ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, po ashtu duhet të merret parasysh.¹⁴

h) Pjesëmarrja në grupet e punës për amendimin e legjislacionit

OJQ-të mund të japin kontribut të madh me anë të angazhimit në grupet e punës për ndryshimin e legjislacionit në fushën e të drejtave dhe lirive të njeriut. Përfaqësuesit e OJQ-ve që merren kryesisht me mbrojtjen e të drejtave të njeriut mund të veprojnë si anëtarë të grupeve të punës të organizuara nga ministrinë e kësaj fushe në bazë të ligjeve dhe akteve nënligjore që rregullojnë pjesëmarrjen e përfaqësuesve të OJQ-ve në grupet e punës të ngritura për qëllim legjislativ dhe mund të emërohen anëtarë të këtyre grupeve të punës në bazë të njoftimeve publike, siç ekziston praktika në Mal të Zi. Gjithashtu, këto OJQ-të mund të japë një kontribut të rëndësishëm gjatë debateve publike për projektligjet e propozuara në fushën e të drejtave të njeriut, të cilat organizohen edhe para diskutimit dhe miratimit përfundimtar në Parlament. Përfundimisht, organizatat e të drejtave të njeriut gjithashtu kanë mundësi që tu paraqisin deputetëve që votojnë në ligjet në Parlament rekomandime dhe shpjegime.

i) Monitorimi i institucioneve ku personat e privuar nga liria janë të ndaluar/të burgosur

OJQ-të duhet të monitorojë respektimin e të drejtave të personave të privuar nga liria regullisht dhe periodikisht në institucionet ku ata janë të ndaluar apo të burgosur. Format e ndryshme të kontratave dhe memorandumëve të bashkëpunimit me institucionet në të cilat personat e privuar nga liria janë të ndaluar mund të përcaktojnë aktivitetet të tilla si: vizita dhe kontrollin e punës së tyre

14 Shënim: Para se të bëhet kjo gjë, është e rëndësishme të kontrollohet nëse shteti në fjalë ka pranuar jurisdiksionin e organit që i dërgohet ankimimi.

në këtë fushë monitorimit. Në këtë mënyrë, komunikimi i drejtpërdrejtë me personat e privuar nga liria dhe ekzaminimi i dhomave të tyre mundëson përfaqësuesit e organizatave të të drejtave të njeriut për të zbuluar dhe ndjekur faktet në lidhje me shkeljet e të drejtave të njeriut, duke përfshirë ato që lidhen me torturën dhe keqtrajtimin. Ky lloj monitorimi nga ana e organizatave të pavarura është me rëndësi të madhe, duke pasur parasysh se personat e privuar nga liria janë të pambrojtur dhe shpesh të paafte për të paraqitur faktet e shkeljes së të drejtave të njeriut për publikun dhe institucionet. Kur përcaktohen rregullat e bashkëpunimit me institucionet, është e rëndësishme që të kërkohet e drejta për të kryer intervista me personat e privuar nga liria pa praninë e zyrtarëve të këtij institucioni. Në këtë mënyrë, personat e privuar nga liria mund të japin informata dhe fakte që lidhen me shkeljen e të drejtave të njeriut pa pasur frikë se për këtë gjë do të ndëshkohet më vonë.

j) Linja telefonike SOS

Organizatave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut duhet të jenë në dispozicion të qytetarëve dhe të komunikojnë me ta në mënyrë të drejtpërdrejtë. Një nga mënyrat për të marrë informacion të drejtpërdrejtë është për të hapur linjë telefonike SOS. Është e rëndësishme që informacioni me numrin e telefonit, ku qytetarët mund të raportojnë faktet në lidhje me shkeljet e të drejtave të njeriut të jetë sa më i përhapur që të jetë e mundur. Informacioni duhet të publikohet në media, tu dorëzohet personave të privuar nga liria në fletushka të shtypura gjatë vizitave monitoruese dhe kjo për shkak të institucioneve ku këta persona janë të izoluar.

Çrrënjosja e mosndëshkimit për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut

Udhëzime dhe tekste referimi

Drejtoria e përgjithshme për të drejtat e njeriut dhe sundimin e ligjit
Këshilli i Evropës
Strasburg

Drejtoria e përgjithshme për të drejtat e njeriut dhe sundimin e ligjit

Këshilli i Evropës

F-67075 Strasbourg Cedex

www.coe.int/justice

© Këshilli i Evropës, 2011

Shtypur në Këshillin e Evropës

Çrrënjësja e mosndëshkimit për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut

Përmbajtja

Udhëzime të miratuara nga Komiteti i Ministrave më 30 Mars të vitit 2011 në mbledhjen e 1110-të të zëvendësministrave.....	20
Tekstet e referimit.....	28

Çrrënjosja e mosndëshkimit për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut

Udhëzime të miratuara nga Komiteti i Ministrave më 30 Mars të vitit 2011 në mbledhjen e 1110-të të zëvendësministrave

Hyrje

Komiteti i Ministrave,

Duke përkujtuar se ata që janë përgjegjës për akte që përbëjnë shkelje të rënda të të drejtave të njeriut duhet të përgjigjen për veprimet e tyre;

Duke marrë parasysh se mungesa e përgjegjshmërisë inkurajon përsëritjen e krimeve, pasi autorët e krimeve dhe të tjerë ndihen të lirë për të kryer vepra të tjera, pa frikë nga ndëshkimi;

Duke përkujtuar se mosndëshkimi i atyre që janë përgjegjës për akte që përbëjnë shkelje të rënda të të drejtave të njeriut u shkakton vuajtje më të mëdha viktimave;

Duke marrë parasysh se mosndëshkimi duhet luftuar si një çështje e drejtësisë për viktimat, si një shembull për të parandaluar shkelje të reja, dhe për të mbështetur sundimin e ligjit dhe besimin publik në sistemin e drejtësisë, duke përfshirë edhe atje ku ekziston një trashëgimi e shkeljeve të rënda të drejtave të njeriut;

Duke pasur parasysh nevojën e shteteve për të bashkëpunuar në nivel ndërkombëtar, në mënyrë që t'i jepet fund mosndëshkimit;

Duke rikonfirmuar se çrrënjosja e mosndëshkimit në të gjithë kontinentin është një objektiv i rëndësishëm i Këshillit të Evropës, ashtu si edhe Asambleja Parlamentare përkujtoi në Rekomandimin 1876 (2009) mbi "Gjendjen e të drejtave të njeriut në Evropë: nevoja për të çrrënjosur mosndëshkimin", dhe se veprimi i saj mund të kontribuojë në përpjekjet në mbarë botën kundër mosndëshkimit;

Duke marrë parasysh Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (ETS nr 5, më tej "Konventa"), në dritën e praktikës gjyqësore përkatëse të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Gjykata), si dhe standardeve të Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit Çnjerëzor ose Poshtëruar apo Ndëshkimit dhe standarde të tjera relevante të themeluara në kuadrin e Këshillit të Evropës;

Duke theksuar se zbatimi i plotë dhe i shpejtë i vendimeve gjyqësore të Gjykatës është një faktor kryesor në luftën kundër mosndëshkimit;

Duke marrë parasysh Setin e Parimeve për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Njeriut me anë të Veprimit për të luftuar mosndëshkimin e Komisionit për të Drejtat e Njeriut i Kombeve të Bashkuara;

Duke përkujtuar rëndësinë e të drejtës për një mjet juridik efektiv për viktimat e shkeljeve të të drejtave të njeriut, siç përmbahet në instrumente të shumta ndërkombëtare - sidomos në nenin 13 të Konventës, nenin 2 të Marrëveshjes Ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Civile dhe Politike dhe nenin 8 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut - dhe siç pasqyrohet në Parimet dhe Udhëzimet e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara për të Drejtën e Kompensimit dhe Dëmshpërblimeve për Viktimat e Shkeljeve të Rënda të Ligjit Ndërkombëtar për të Drejtat e Njeriut dhe Shkeljeve të Rënda të Ligjit Humanitar Ndërkombëtar;

Duke marrë parasysh Rekomandimin e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës Rec (2006) 8 për shtetet anëtare mbi ndihmën ndaj viktimave të krimit të 14 qershorit të vitit 2006 dhe Deklaratën e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara mbi Parimet Themelore të Drejtësisë për Viktimat e Krimit dhe Abuzimit të Pushtetit;

Duke pasur parasysh nevojën për të siguruar respektimin e të drejtave themelore të personave të akuzuar për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut si dhe sundimit të ligjit gjatë luftës kundër mosndëshkimit;

Miraton udhëzimet e mëposhtme dhe fton shtetet anëtare për t'i zbatuar ato në mënyrë efektive dhe për të siguruar që atë të jenë shumë të përhapura, dhe ku ekziston nevoja duhen përkthyer, sidomos midis të gjitha autoriteteve përgjegjëse për luftën kundër mosndëshkimit.

I. Nevoja për të luftuar mosndëshkimin

1. Këto udhëzime trajtojnë problemin e mosndëshkimit në lidhje me shkelje të rënda të të drejtave të njeriut. Mosndëshkimi lind kur ata që janë përgjegjës për akte që përbëjnë shkelje të rënda të të drejtave të njeriut nuk mbahen përgjegjës.
2. Kur ndodh, mosndëshkimi shkaktohet ose lehtësohet dukshëm nga mungesa e reagimit të zellshëm të institucioneve apo agjentëve shtetërorë për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut. Në këto rrethana, gabimet mund të vërehen në kuadër të institucioneve shtetërore, si dhe në çdo fazë të procedurës gjyqësore ose administrative.
3. Shtetet ekzistojnë për të luftuar mosndëshkimin si një çështje të drejtësisë për viktimat, si një parandalues në lidhje me shkeljet e të drejtave të njeriut në të ardhmen dhe në mënyrë që të mbështesë sundimin e ligjit dhe besimin publik në sistemin e drejtësisë.

II. Qëllimi i udhëzimeve

1. Këto udhëzime trajtojnë mosndëshkimin për akte ose mosveprime që përbëjnë shkelje të rënda të drejtave të njeriut dhe të cilat ndodhin në kuadër të juridiksionit të shtetit në fjalë.
2. Ato u drejtohen shteteve dhe përfshijnë aktet ose mosveprimet e shteteve, duke përfshirë edhe ato të kryera me anë të agjentëve të tyre. Ato gjithashtu përfshijnë detyrimet e shteteve sipas Konventës për të ndërmarrë veprime pozitive në lidhje me aktorët jo-shtetërorë.
3. Për qëllimet e këtyre udhëzimeve, "shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut" u referohen atyre

akteve në lidhje me të cilat shtetet kanë detyrime në bazë të Konventës dhe në dritën e praktikës së mëparshme të Gjykatës, për të miratuar dispozitat e të drejtës penale. Detyrime të tilla lindin në kontekstin e të drejtës për jetën (neni 2 i Konventës), ndalimit të torturës dhe trajtimit çnjerëzor ose poshtërues ose ndëshkimit (neni 3 i Konventës), ndalimit të punës së detyruar dhe skllavërisë (Neni 4 i Konventës) dhe në lidhje me aspekte të caktuara të së drejtës për liri dhe siguri (neni 5, paragrafi 1 i Konventës) dhe të së drejtës për respektimin e jetës private dhe familjare (neni 8 i Konventës). Jo të gjitha shkeljet e këtyre neneve domosdoshmërisht do të arrijë në këtë prag.

4. Në udhëzimet, termi “autor” u referohet atyre që janë të përgjegjshëm për akte ose mosveprime që përbëjnë shkelje të rënda të të drejtave të njeriut.
5. Në udhëzimet, termi “viktimë” i referohet personit fizik i cili ka pësuar dëm, duke përfshirë lëndime fizike apo mendore, vuajtje shpirtërore ose humbje ekonomike, të shkaktuara nga një shkelje e rëndë të drejtave të njeriut. Termi “viktimë” gjithashtu mund të përfshijë, sipas rastit, familjen e ngushtë ose vartësit e drejtpërdrejtë të viktimës. Një person duhet të konsiderohet viktimë pavarësisht nëse autori i shkeljes është identifikuar, arrestuar, ndjekur penalisht ose dënuar, dhe pavarësisht nga marrëdhëniet familjare ndërmjet autorit dhe viktimës.
6. Këto udhëzime plotësojnë dhe nuk zëvendësojnë standarde të tjera në lidhje me mosndëshkimin. Në veçanti, ato nuk përsërisin dhe nuk kualifikojnë detyrimet dhe përgjegjësitë e shteteve në kuadër të të drejtës ndërkombëtare, duke përfshirë të drejtën ndërkombëtare humanitare dhe të drejtën penale ndërkombëtare, dhe as nuk janë të destinuara për të zgjidhur çështje, si marrëdhënia midis të drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe rregullave të tjera të së drejtës ndërkombëtare. Asnjë gjë në këto udhëzime nuk i parandalon shtetet nga krijimi ose ushtrimi i masave më të forta ose më të gjera për të luftuar mosndëshkimin.

III. Masa të përgjithshme për parandalimin e mosndëshkimit

1. Në mënyrë që të shmangin defektet ose mangësitë ligjore që kontribuojnë në mosndëshkim,
 - Shtetet duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për të përmbushur detyrimet e tyre si pas Konventës për të miratuar dispozitat e të drejtës penale me qëllim që shkeljet e rënda të drejtave të njeriut të ndëshkohen në mënyrë efektive nëpërmjet dënimeve të përshtatshme. Këto dispozita duhet të zbatohen nga organet përkatëse ekzekutive dhe gjyqësore në mënyrë koherente dhe jo diskriminuese.
 - Shtetet duhet të sigurojnë mundësinë e procedimit disiplinor ndaj zyrtarëve shtetërorë.
 - Në të njëjtën mënyrë, shtetet duhet të sigurojnë një mekanizëm që përfshin masa penale dhe disiplinore në mënyrë që të ndëshkojnë sjelljen dhe praktikën në kuadër të organeve shtetërore të cilat çojnë drejt mosndëshkimit për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut.
2. Shtetet - duke përfshirë zyrtarët dhe përfaqësuesit e tyre - duhet të dënojnë publikisht shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut.
3. Shtetet duhet të përpunojnë politika dhe të marrin masa praktike për të parandaluar dhe luftuar një kulturë institucionale brenda autoriteteve të tyre e cila nxit mosndëshkimin. Këto masa duhet të përfshijnë:
 - promovimin e kulturës së respektimit të të drejtave të njeriut dhe punën sistematike për zbatimin e të drejtave të njeriut në nivel kombëtar;
 - krijimin ose forcimin e mekanizmave përkatëse të trajnimit dhe të kontrollit;
 - futjen e politikave kundër korrupsionit;
 - bërjen e autoriteteve përkatëse të vetëdijshme për detyrimet e tyre, duke përfshirë edhe marrjen e masave të nevojshme në lidhje me parandalimin e mosndëshkimit, dhe vendosjen e ndëshkimeve të duhura për dështimin në zbatimin e këtyre detyrimeve;
 - zbatimin e një politike të tolerancës zero për shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut;

- sigurimin e informacioneve për publikun në lidhje me shkeljet dhe reagimin e autoriteteve ndaj këtyre shkeljeve;
 - ruajtjen e arkivave dhe lehtësimin e qasjes së duhur ndaj tyre përmes mekanizmave të zbatueshme.
4. Shtetet duhet të krijojnë dhe publikojnë procedura të qarta për raportimin e akuzave për shkeljet e rënda të drejtave të të njeriut, si brenda autoriteteve të tyre, ashtu edhe për publikun e gjerë. Shtetet duhet të sigurojnë që raportime të tilla të pranohen dhe të trajtohen në mënyrë efektive nga autoritetet kompetente.
 5. Shtetet duhet të marrin masa për të inkurajuar raportimin nga ata që janë të vetëdijshëm për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut. Ato duhet, ku është e nevojshme, të marrin masa për të siguruar që ata të cilët raportojnë shkelje të tilla të jenë të mbrojtur nga çdo ngacmim dhe hakmarrje.
 6. Shtetet duhet të përcaktojnë plane dhe politika për t'iu kundërvënë diskriminimit që mund të çojë në shkelje të rënda të të drejtave të njeriut dhe të mosndëshkimit për akte të tilla dhe përsëritjen e tyre.
 7. Shtetet duhet të krijojnë mekanizma për të siguruar integritetin dhe përgjegjësinë e agjentëve të tyre. Shtetet duhet të pushojnë nga puna individë, për të cilët është konstatuar, nga organi kompetent, të jenë përgjegjës për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut ose për avancimin e mëtejshëm apo tolerimin e mosndëshkimit, ose të miratojnë masa të tjera të përshtatshme disiplinore. Shtetet duhet veçanërisht të zhvillojnë dhe të institucionalizojnë kodet e sjelljes.

IV. Masa mbrojtëse për mbrojtjen e personave të cilëve u është hequr liria prej shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut

1. Shtetet duhet të ofrojnë garanci të përshtatshme për personat të cilëve u është hequr liria nga ana e një autoriteti publik, me qëllim që të parandalohet çdo heqje lirie e paligjshme apo keqtrajtim, dhe të sigurojnë që çdo heqje lirie e paligjshme apo keqtrajtim nuk do të mbetet pa u ndëshkuar. Në veçanti, personave të cilëve u është hequr liria duhet tu sigurohen garancitë në vijim:
 - e drejta për të informuar ose të kenë të informuar një palë të tretë të zgjedhur nga vetë ai ose ajo rreth heqjes së lirisë së tyre, vendndodhjes së tyre dhe rreth ndonjë transferimi;
 - e drejta për të pasur qasje në një avokat;
 - e drejta për të pasur qasje në një mjek.
 Personat të cilëve u është hequr liria duhet të informohen në mënyrë të qartë pa vonesë për të gjitha të drejtat e tyre, duke përfshirë edhe ato të lartpërmendura. Çdo mundësi e autoriteteve për të shtyrë zbatimin e njëres prej këtyre të drejtave, me qëllim që të mbrohen interesat e drejtësisë dhe rendit publik, duhet të përcaktohet qartë me ligj, dhe zbatimi i saj duhet të jetë i kufizuar në mënyrë të saktë në kohë dhe t'i nënshtrohet masave mbrojtëse procedurale të duhura.
2. Përveç të drejtave të lartpërmendura, personat të cilëve u është hequr liria kanë të drejtë për procedura gjyqësore nëpërmjet të cilave në mënyrë të shpejt do të merret vendimi për ligjshmërinë e heqjes së lirisë së tyre dhe të urdhërohet lëshimi në qoftë se heqja e lirisë është e paligjshme. Personat e arrestuar apo të cilëve u është hequr liria në lidhje me kryerjen e një veprë penale duhet të çohen menjëherë përpara një gjykatësi, dhe ata kanë të drejtë të kenë një gjykim brenda një afati të arsyeshem ose të lirohen në pritje të gjykimit, në përputhje me praktikën gjyqësore të Gjykatës.
3. Shtetet duhet të marrin masa efektive për të mbrojtur nga rreziku i shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut duke mbajtur të dhëna në lidhje me datën, kohën dhe vendin e personave të cilëve u është hequr liria, si dhe informacione të tjera përkatëse në lidhje me heqjen e lirisë.
4. Shtetet duhet të sigurojnë që oficerët që kryejnë arrestimet apo marrjet në pyetje ose që përdorin forcë, të mund të identifikohen në hetimet e mëvonshme penale ose disiplinore dhe procedura.

V. Detyra për të hetuar

1. Lufta kundër mosndëshkimit kërkon që të kryhet një hetim efektiv në rastet e shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut. Kjo detyrë ka karakter absolut.

E drejta për jetën (Neni 2 i Konventës)

Detyrimi për të mbrojtur të drejtën për jetën kërkon midis të tjerave që të kryhet një hetim efektiv kur individë janë vrarë, qoftë nga agjentë shtetëror ose persona fizik, dhe në të gjitha rastet e vdekjeve të dyshimta. Ky detyrim gjithashtu lind në situata në të cilat është e paqartë nëse viktima ka vdekur apo jo, dhe ekziston arsye për të besuar se rrethanat janë të dyshimta, si në rastin e rrëmbimeve të dhunshme.

Ndalimi i torturës dhe trajtimit çnjerëzor ose poshtëruës ose ndëshkimit (Neni 3 i Konventës)

Shtetet kanë një detyrim procedural që rrjedh nga neni 3 i Konventës për të kryer një hetim efektiv për shkak të pretendimeve të besueshme që një person ka qenë i keqtrajtuar rëndë, ose kur autoritetet kanë arsye për të dyshuar se ka ndodhur një trajtim i tillë.

Ndalimi i skllavërisë dhe i punës së detyruar (Neni 4 i Konventës)

Ndalimi i skllavërisë dhe punës së detyruar përfshin një detyrim procedural për të kryer një hetim efektiv në situatat e trafikimit të mundshëm të qenieve njerëzore.

E drejta për liri dhe siguri (Neni 5 i Konventës)

Masat mbrojtëse procedurale që rrjedhin ndër të tjera nga e drejta për liri dhe siguri kërkojnë që shtetet të kryejnë hetime efektive për pretendimet e besueshme që një personi i është hequr liria e tij ose e saj dhe nuk është parë që atëherë.

E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare (Neni 8 i Konventës)

Shtetet kanë për detyrë të hetojnë në mënyrë efektive pretendime të besueshme për shkelje serioze të të drejtave të përfshira në Nenin 8 të Konventës, ku natyra dhe rëndesa e shkeljes së pretenduar kështu kërkon, në përputhje me praktikën e mëparshme të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

2. Kur është bërë një pretendim i argumentuar, apo autoritetet kanë shkaqe të arsyeshme për të dyshuar se ka ndodhur një shkelje e rëndë të drejtave të njeriut, autoritetet duhet të fillojnë një hetim me iniciativën e tyre.
3. Fakti që viktima nuk dëshiron të paraqesë ankesë zyrtare, që më pas tërheq një ankesë të tillë ose që vendos të ndërpresë procedimin, nuk i liron autoritetet nga detyrimi i tyre për të kryer një hetim efektiv, në qoftë se ekziston arsye për të besuar se ka ndodhur një shkelje e rëndë e të drejtave të njeriut.
4. Vendimi për të refuzuar fillimin ose përfundimin e hetimeve mund të merret vetëm nga një autoritet i pavarur dhe kompetent, në përputhje me kriteret e një hetimi efektiv siç përcaktohet në Udhëzimin VI. Ato duhet të jenë të arsyetuara në mënyrë të rregullt.
5. Vendime të tilla duhet të jenë subjekt i shqyrtimit të duhur dhe të jenë në përgjithësi të diskutueshme nëpërmjet një procesi gjyqësor.

VI. Kriteret për një hetim efektiv

Me qëllim që një hetim të jetë efektiv, ai duhet të respektojë kërkesat e mëposhtme themelore:

Përshtatshmëria

Hetimi duhet të jetë në gjendje të çojë në identifikimin dhe dënimin e atyre që janë përgjegjës. Kjo nuk krijon një detyrim për shtetet që të sigurojnë që hetimi të shpjerë në një rezultat të caktuar, por autoritetet duhet të kenë marrë hapat e arsyeshme në dispozicionin e tyre për të siguruar dëshmi lidhur me incidentin.

Përpikmëria

Hetimi duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe të adresojë të gjitha rrethanat përkatëse në prapavijë, duke përfshirë çdo motivim racist apo diskriminues. Ai duhet të jetë i aftë për të identifikuar çdo dështim sistematik që shpie në shkelje. Kjo kërkon marrjen e të gjitha hapave të arsyeshme për të siguruar prova relevante të tilla si identifikimi dhe marrja në intervistë e viktimave të supozuara, të dyshuarve dhe dëshmitarëve; ekzaminimi i vendit së shkeljes së supozuar për prova materiale; dhe mbledhja e provave të ekspertizës dhe ato mjekësore nga specialistët kompetentë. Provat duhet të vlerësohen në mënyrë të plotë, të qëndrueshme dhe objektive.

Paanshmëria dhe pavarësia

Personat përgjegjës për kryerjen e hetimit duhet të jenë të paanshëm dhe të pavarur nga personat e përfshirë në ngjarjet. Kjo kërkon që autoritetet të cilat janë të përfshira në ngjarjet nuk mund të kryejnë marrjen e provave dhe as hetimet paraprake; në veçanti, hetuesit nuk mund të jenë pjesë e së njëjtës njësi si zyrtarët të cilët janë objekt i hetimit.

Gatishmëria

Hetimi duhet të fillohet me gatishmërinë e mjaftueshme me qëllim që të arrihet sasia dhe cilësia më e mirë e mundshme e dëshmive në dispozicion. Edhe pse mund të ketë pengesa apo vështirësi të cilat parandalojnë avancimin në një hetim në një situatë të veçantë, një përgjigje e shpejtë nga autoritetet mund, në përgjithësi, të konsiderohet si thelbësore në ruajtjen e besimit të publikut, në ruajtjen e sundimit të ligjit si dhe në parandalimin e shfaqjes së çdo marrëveshjeje të fshehtë për tolerimin e akteve të paligjshme. Hetimi duhet të përfundojë brenda një kohe të arsyeshme dhe, në të gjitha rastet, të bëhet me gjithë kujdesin e nevojshëm.

Mbikëqyrja publike

Duhet të ekzistojë një element i mjaftueshëm i mbikëqyrjes publike mbi hetimin ose rezultatet të tij për të siguruar përgjegjësi, për të ruajtur besimin e publikut në respektimin e sundimit të ligjit nga ana e autoriteteve dhe për të parandaluar çdo shfaqje të marrëveshjeve të fshehta për aktet e paligjshme ose tolerancën e tyre. Mbikëqyrja publike nuk duhet të rrezikojë qëllimet e hetimit dhe të drejtat themelore të palëve.

VII. Përfshirja e viktimave në hetim

1. Shtetet duhet të sigurojnë që viktimat të kenë mundësi të marrin pjesë në hetim dhe në procedurë deri në masën e nevojshme për të mbrojtur interesat e tyre legjitime nëpërmjet procedurave përkatëse sipas ligjit kombëtar.
2. Shtetet duhet të sigurojnë që viktimat të kenë mundësi që, në masën e nevojshme për të mbrojtur interesat e tyre legjitime, të marrin informacione në lidhje me vijueshmërinë dhe

rezultatit e ankesave të tyre, progresin e hetimit dhe të ndjekjes penale, ekzekutimin e vendimeve gjyqësore dhe të gjitha masat e marra në lidhje me dëmshpërblimin për dëmet e shkaktuara ndaj viktimave.

3. Në rastet e vdekjeve të dyshimta ose rrëmbimeve të dhunshme, shtetet duhet, deri në masën e mundur, të sigurojnë informacione për familjen e tij ose të saj në lidhje me fatin e personit në fjalë.
4. Viktimave mund tu jepet mundësia që të thonë se ata nuk dëshirojnë të marrin një informacion të tillë.
5. Atje ku legjislati brendshëm parashikon pjesëmarrjen si palë në procedurë, shtetet duhet të sigurojnë që viktimës ti ofrohet ndihma dhe këshillat e duhura juridike publike, aq sa është e nevojshme për pjesëmarrjen e tyre në procedurë.
6. Shtetet duhet të sigurojnë që, në të gjitha fazat e procedurës kur ekziston nevoja, të merren masa mbrojtëse për integritetin fizik dhe psikik të viktimave dhe dëshmitarëve. Shtetet duhet të sigurojnë që viktimat dhe dëshmitarët të mos jenë të frikësuar, subjekte të përndjekjes ose të dekurajuar me mjete të tjera për të bërë ankimim ose për të ndjekur ankesën ose për të marrë pjesë në procedurat gjyqësore. Këto masa mund të përfshijnë mjete të veçanta të hetimit, mbrojtje dhe asistencë para, gjatë ose pas procesit hetimor, për të garantuar sigurinë dhe dinjitetin e personave në fjalë.

VIII. Ndjekjet penale

1. Shtetet kanë detyrim që të ndjekin penalisht kur rezultati i hetimit e bën të domosdoshme këtë. Edhe pse nuk ekziston e drejta e cila garanton ndjekjen penale ose dënimin e një personi të caktuar, prokurori duhet që, aty ku faktet e bëjnë të domosdoshme këtë, të marrë hapat e nevojshme për të sjellë ata që kanë kryer shkelje të rënda të të drejtave të njeriut para drejtësisë.
2. Kërkesat themelore për një hetim efektiv të cilat janë të përcaktuara në Udhëzimet V dhe VI gjithashtu i referohen fazës së ndjekjes penale.

IX. Procedurat gjyqësore

1. Shtetet duhet të sigurojnë pavarësinë dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor, në përputhje me parimin e ndarjes së pushteteve.
2. Masat mbrojtëse duhet të merren për të siguruar që avokatët, prokurorët dhe gjykatësit mos të kenë frikë nga hakmarrja për ushtrimin e funksioneve të tyre.
3. Procedura duhet të përfundojë brenda një kohe të arsyeshme. Shtetet duhet të sigurojnë që autoritetet gjyqësore dhe hetimore të kenë në dispozicion mjetet e nevojshme për këtë qëllim.
4. Personat e akuzuar se kanë kryer shkelje të rënda të të drejtave të njeriut kanë të drejtë për një gjykim të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga ana e një gjykatë të pavarur dhe të paanshme të themeluar me ligj.

X. Vendimet penale

Duke respektuar pavarësinë e gjykatave, kur janë vërtetuar shkelje të rënda të të drejtave të njeriut, përcaktimi i një dënimi të përshtatshëm duhet të vijoj. Vendimet penale të cilat janë marrë duhet të jenë efektive, proporcionale dhe të përshtatshme me veprën e kryer.

XI. Zbatimi i vendimeve gjyqësore të gjykatave vendase

Vendimet gjyqësore të gjykatave vendase duhet të zbatohet plotësisht dhe pa vonesë nga autoritetet kompetente.

XII. Bashkëpunimi ndërkombëtar

Bashkëpunimi ndërkombëtar luan një rol të rëndësishëm në luftën kundër mosndëshkimit. Me qëllim që të parandalohet dhe të çrrënjosjet mosndëshkimi, shtetet duhet të plotësojnë detyrimet e tyre, sidomos në lidhje me ndihmën ligjore reciproke, ndjekjet penale dhe ekstradimet, në përputhje me respektimin e të drejtave të njeriut, duke përfshirë parimin e "moskthimit", dhe qëllim të mirë. Për këtë qëllim, shtetet inkurajohen që të intensifikojnë bashkëpunimin e tyre përtej detyrimeve të tyre ekzistuese.

XIII. Përgjegjësia e vartësve

Ndërkohë që zbatimi i urdhrave ose udhëzimeve të dhëna nga një epror mund të ndikojë tek dënimi, kjo gjë nuk mund të shërbejë si një rrethanë për të përjashtuar përgjegjësinë për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut.

XIV. Kufizime dhe limitime

Shtetet duhet të mbështesin, me të gjitha mjetet e mundshme, hetimin e shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut dhe ndjekjen penale të autorëve të dyshuar. Kufizimet dhe limitimet e ligjshme në hetimet dhe ndjekjet penale duhet të kufizohen në masën minimale të nevojshme për të arritur qëllimin e tyre.

XV. Mekanizmat jashtë gjyqësore

Shtetet duhet të konsiderojnë krijimin e mekanizmave jashtë gjyqësore si diskutimet parlamentare ose diskutimet e tjera publike, Avokatin e Popullit, komisionet e pavarura dhe ndërmjetësimin si procedura të dobishme plotësuese për mjetet juridike vendase të garantuara në bazë të Konventës.

XVI. Dëmshpërblimi

Shtetet duhet të marrin të gjitha masat e duhura për të krijuar mekanizma të qasshëm dhe efektivë të cilët sigurojnë që viktimat e shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut të marrin dëmshpërblimin e menjëhershëm dhe adekuat për dëmin e pësuar. Kjo mund të përfshijë masat e rehabilitimit, kompensimit, shpërblimit moral, kthimit dhe garancisë që se një gjë e tillë nuk do të përsëritet.

Çrrënjosja e mosndëshkimit për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut

Tekste referimi

Shënim paraprak

Ky dokument është përgatitur nga Sekretariati, në bashkëpunim me Kryetarin e Komitetit të Ekspertëve për Mosndëshkimin (DH-I).

Qëllimi i udhëzimeve

Udhëzimet përqendrohen mbi përgjegjësinë e autorëve të shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut. Ato janë të konceptuara kryesisht si udhëzime për praktikën gjyqësore të gjera që Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka zhvilluar mbi luftën kundër mosndëshkimit, në mënyrë të veçantë duke u imponuar shteteve anëtare të Këshillit të Evropës detyrimin për të hetuar shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut dhe për të dënuar autorët e tyre, si dhe për të siguruar një ilaç efektiv për viktimat e këtyre shkeljeve.

Baza ligjore

Është e nevojshme të rikujtohet rëndësia e veçantë e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm "Konventa"). Konventa dhe praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në tekstin e mëtejshëm "Gjykata") janë një burim kryesor për përcaktimin e udhëzimeve në luftën kundër mosndëshkimit. Këtyre u referohen edhe Burime të tjera të rëndësishme të tilla si raportet e Komitetit për Parandalimin e Torturës (CPT). Ku ka qenë e nevojshme, standardet ndërkombëtare ekzistuese gjithashtu janë marrë në konsideratë, duke bërë të qartë se vetëm shtetet anëtare të cilat kanë ratifikuar këto tekste duhet të zbatojnë detyrimet dhe praktikën gjyqësore që rrjedh prej tyre. Gjithsesi nga këto instrumente mund të nxirren përfundime të cilat mund të përdoren në luftën kundra mosndëshkimit.

Preamble

Komiteti i Ministrave,

Duke përkujtuar se ata që janë përgjegjës për akte që përbëjnë shkelje të rënda të të drejtave të njeriut duhet të përgjigjen për veprimet e tyre;

Në Rezolutën e Kuvendit 1675 (2009) mbi "gjendjen e të drejtave të njeriut në Evropë: nevoja për të çrrënjosur mosndëshkimin", Asambleja Parlamentare këmbënguli që:

1. [...] të gjithë autorët e shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut duhet të përgjigjen për veprimet e tyre.

Duke marrë parasysh se mungesa e përgjegjshmërisë inkurajon përsëritjen e krimeve, pasi autorët e krimeve dhe të tjerë ndihen të lirë për të kryer vepra të tjera, pa frikë nga ndëshkimi;

Duke përkujtuar se mosndëshkimi i atyre që janë përgjegjës për akte që përbëjnë shkelje të rënda të të drejtave të njeriut u shkakton vuajtje më të mëdha viktimave;
Duke marrë parasysh se mosndëshkimi duhet luftuar si një çështje e drejtësisë për viktimat, si një shembull për të parandaluar shkelje të reja, dhe për të mbështetur sundimin e ligjit dhe besimin publik në sistemin e drejtësisë, duke përfshirë edhe atje ku ekziston një trashëgimi e shkeljeve të rënda të drejtave të njeriut;

Duke pasur parasysh nevojën e shteteve për të bashkëpunuar në nivel ndërkombëtar, në mënyrë që t'i jepet fund mosndëshkimit;

Duke rikonfirmuar se çrrënjësia e mosndëshkimit në të gjithë kontinentin është një objektiv i rëndësishëm i Këshillit të Evropës, ashtu si edhe Asambleja Parlamentare përkujtoi në Rekomandimin 1876 (2009) mbi "Gjendjen e të drejtave të njeriut në Evropë: nevoja për të çrrënjësuar mosndëshkimin", dhe se veprimi i saj mund të kontribuojë në përpjekjet në mbarë botën kundër mosndëshkimit;

Në Rekomandimin e Asamblesë 1876 (2009) mbi "gjendjen e të drejtave të njeriut në Evropë: nevoja për të çrrënjësuar mosndëshkimin", Asambleja Parlamentare ka deklaruar:

1. Asambleja Parlamentare, duke iu referuar Rezolutës së saj 1675 (2009) mbi "gjendjen e të drejtave të njeriut në Evropë: nevoja për të çrrënjësuar mosndëshkimin", e konsideron çrrënjësimin e mosndëshkimit për autorët, nxitësit dhe organizatorët e shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut si një prioritet në veprimtarinë e Këshillit të Evropës, si një çështje e drejtësisë individuale, parandalimit dhe mbështetjes së sundimit të ligjit.

Duke marrë parasysh Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (ETS nr 5, më tej "Konventa"), në dritën e praktikës gjyqësore përkatëse të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Gjykata), si dhe standardeve të Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit Çnjerëzor ose Poshtëruar apo Ndëshkimit dhe standarde të tjera relevante të themeluara në kuadrin e Këshillit të Evropës;

Duke theksuar se zbatimi i plotë dhe i shpejtë i vendimeve gjyqësore të Gjykatës është një faktor kryesor në luftën kundër mosndëshkimit;

Në Rekomandimin e Asamblesë 1675 (2009) mbi "gjendjen e të drejtave të njeriut në Evropë: nevoja për të çrrënjësuar mosndëshkimin", Asambleja Parlamentare ka deklaruar:

8. Zbatimi i plotë dhe i shpejtë i vendimeve të Gjykatës në rastet e mosndëshkimit është kryesor për të luftuar këtë plagë në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës.
 - 8.1. Zbatimi i vendimit penal nuk mund të kufizohet deri në pagesën e dëmshpërblimit në të holla të caktuar nga Gjykata, atëherë kur gjykata ka konstatuar dështimin e një hetimi efektiv. Ende duhet të kryhen hetime në mënyrën e duhur dhe të merren masa të përgjithshme për të gjetur shkaqet që fshihen pas këtyre shkeljeve.

[...]

- 8.3. Asambleja e përshëndet Komitetin e Ministrave për vënien në dukje në mënyrë konsistente se ekziston një detyrim i vazhdueshëm për të kryer hetime efektive, pasi Gjykata ka konstatuar shkelje procedurale të nenit 2 të Konventës. Zbatimi i këtyre rregullave në mënyrë të njëjtë për të gjitha shtetet, pa standarde të dyfishta, ka një rëndësi të veçantë.
- 8.4. Komunikimi në kohë reale i Gjykatës me shtetet që kanë bërë kërkesa që kanë të bëjnë me dështime në hetime dërgon një mesazh të rëndësishëm për autoritetet kompetente duke u dhënë atyre mundësinë për të kryer veprime hetimore më përpara se sa një dëshmi të ketë humbur në mënyrë të pakthyeshme.

Duke marrë parasysh Setin e Parimeve për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Njeriut me anë të Veprimit për të luftuar mosndëshkimin e Komisionit për të Drejtat e Njeriut i Kombeve të Bashkuara;

Në grupin e lartpërmendur të parimeve të 8 shkurtit të vitit 2005, Komisioni për të Drejtat e Njeriut i Kombeve të Bashkuara ka përcaktuar si Parimin 1 ("Detyrimet e përgjithshme të shteteve me qëllim që të marrin masa efektive për të luftuar mosndëshkimin"):

Mosndëshkimi lind nga dështimi i shteteve për të përmbushur detyrimet që kanë në lidhje me hetimin e shkeljeve; për të marrë masat e duhura në lidhje me autorët, veçanërisht në fushën e drejtësisë, duke siguruar që ata që janë të dyshuar si përgjegjës për vepra penale të ndiqen penalisht, të gjykoohen dhe dënohen në mënyrë të rregullt; për tu siguruar viktimave mjetet juridike efektive dhe për të siguruar që ato të marrin dëmshpërblim për lëndimet e pësuar; për të siguruar të drejtën e patjetërsueshme për të ditur të vërtetën rreth shkeljes; dhe për të marrë hapa të tjera të nevojshme për të parandaluar përsëritjen e shkeljeve.

Duke përkujtuar rëndësinë e të drejtës për një mjet juridik efektiv për viktimat e shkeljeve të të drejtave të njeriut, siç përmbahet në instrumente të shumta ndërkombëtare - sidomos në nenin 13 të Konventës, nenin 2 të Marrëveshjes Ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Civile dhe Politike dhe nenin 8 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut - dhe siç pasqyrohet në Parimet dhe Udhëzimet e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara për të drejtën e dëmshpërblimeve dhe kompensimit për viktimat e shkeljeve të rënda të së Ligjit Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut dhe Shkeljeve Serioze të Ligjit Humanitar Ndërkombëtar;

Në parathënien e parimeve dhe udhëzimeve të lartpërmendura të 16 dhjetorit të vitit 2005, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara deklaroi:

Duke pranuar se duke respektuar të drejtën e viktimave për të përfituar nga mjetet juridike dhe dëmshpërblimi, komuniteti ndërkombëtar e mban besimin me gjendjen e vështirë të viktimave, të mbijetuarve dhe brezave të ardhshëm njerëzor dhe përsëri konfirmon parimet ligjore ndërkombëtare të përgjegjësisë, drejtësisë dhe sundimit të ligjit, [...].

Duke marrë parasysh Rekomandimin e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës Rec (2006) 8 për shtetet anëtare mbi ndihmën ndaj viktimave të krimit të 14 qershorit të vitit 2006 dhe Deklaratën e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara mbi Parimet Themelore të Drejtësisë për Viktimat e Krimit dhe Abuzimit të Pushtetit;

Duke pasur parasysh nevojën për të siguruar respektimin e të drejtave themelore të personave të akuzuar për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut si dhe sundimit të ligjit gjatë luftës kundër mosndëshkimit;

Miraton udhëzimet e mëposhtme dhe fton shtetet anëtare për t'i zbatuar ato në mënyrë efektive dhe për të siguruar që atë të jenë shumë të përhapura, dhe ku ekziston nevoja duhen përkthyer, sidomos midis të gjitha autoriteteve përgjegjëse për luftën kundër mosndëshkimit.

I. Nevoja për të luftuar mosndëshkimin

1. Këto udhëzime trajtojnë problemin e mosndëshkimit në lidhje me shkelje të rënda të të drejtave të njeriut. Mosndëshkimi lind kur ata që janë përgjegjës për akte që përbëjnë shkelje të rënda të të drejtave të njeriut nuk mbahen përgjegjës.
2. Kur ndodh, mosndëshkimi shkaktohet ose lehtësohet dukshëm nga mungesa e reagimit të zellshëm të institucioneve apo agjentëve shtetërorë për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut. Në këto rrethana, gabimet mund të vërehen në kuadër të institucioneve shtetërore, si dhe në çdo fazë të procedurës gjyqësore ose administrative.

3. Shtetet ekzistojnë për të luftuar mosndëshkimin si një çështje të drejtësisë për viktimat, si një parandalues në lidhje me shkeljet e të drejtave të njeriut në të ardhmen dhe në mënyrë që të mbështesë sundimin e ligjit dhe besimin publik në sistemin e drejtësisë.

Lidhur me parandalimin e torturës dhe trajtimit çnjerëzor dhe poshtëruës, KPT-ja e ka përcaktuar problemin e mosndëshkimit në mënyrën vijuese:

Besueshmëria në ndalimin e torturës dhe formave të tjera të keqtrajtimit është e rrezikuar çdo herë kur zyrtarët përgjegjës për vepra të tilla nuk janë përgjigjur për veprimet e tyre. Në qoftë se shfaqja e një informacioni që dëshmon për vepër keqtrajtimi nuk rezulton në një përgjigje të shpejtë dhe efektive, ata që janë të prirur për të keqtrajtuar personat të cilëve u është hequr liria, shumë shpjet do të fillojnë të besojnë - dhe me arsye shumë të mirë - që mund të veprojnë në këtë mënyrë pa u ndëshkuar. Të gjitha përpjekjet për të promovuar parimet e të drejtave të njeriut përmes politikave të rrepta të punësimit dhe trajnimeve profesionale do të sabotohen. Duke dështuar në marrjen e masave efektive, personat në fjalë - kolegët, menaxherët e lartë, autoritetet hetimore - në fund do të kontribuojnë në shpërbërjen e vlerave që përbëjnë themelet e një shoqërie demokratike.

Në anën tjetër, kur zyrtarët të cilët urdhërojnë, autorizojnë, falin apo mbështesin torturën dhe keqtrajtimin, sillen para drejtësisë për veprimet ose mosveprimet e tyre, atëherë dërgohet një mesazh i qartë se një sjellje e tillë nuk do të tolerohet. Përveç vlerës së tij të konsiderueshme për parandalimin, ky mesazh do të bindi publikun e gjerë se askush nuk është mbi ligjin, madje as ata që janë përgjegjës për ruajtjen e tij. Dija se ata që janë përgjegjës për keqtrajtimin janë sjellë para drejtësisë do të ketë një efekt të dobishëm për viktimat.¹

II. Qëllimi i udhëzimeve

1. Këto udhëzime trajtojnë mosndëshkimin për akte ose mosveprime që përbëjnë shkelje të rënda të drejtave të njeriut dhe të cilat ndodhin në kuadër të juridiksionit të shtetit në fjalë.

Për qëllimet e këtyre udhëzimeve, termi "juridiksion" ka të njëjtin kuptim si termi "juridiksion" në Nenin 1 të Konventës.

2. Ato u drejtohen shteteve dhe përfshijnë aktet ose mosveprimet e shteteve, duke përfshirë edhe ato të kryera me anë të agjentëve të tyre. Ato gjithashtu përfshijnë detyrimet e shteteve sipas Konventës për të ndërmarrë veprime pozitive në lidhje me aktorët joshitetërorë.

Nga termi "shtetet" që përdoret në udhëzimet nuk do të përjashtohet aplikimi i tyre ndaj një Pale Kontraktuale e Konventës e cila nuk është shtet.

3. Për qëllimet e këtyre udhëzimeve, "shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut" u referohen atyre akteve në lidhje me të cilat shtetet kanë detyrime në bazë të Konventës dhe në dritën e praktikës së mëparshme të Gjykatës, për të miratuar dispozitat e të drejtës penale. Detyrime të tilla lindin në kontekstin e të drejtës për jetën (neni 2 i Konventës), ndalimit të torturës dhe trajtimit çnjerëzor ose poshtëruës ose ndëshkimit (neni 3 i Konventës), ndalimit të punës së detyruar dhe skllavërisë (Neni 4 i Konventës) dhe në lidhje me aspekte të caktuara të së drejtës për liri dhe siguri (neni 5, paragrafi 1 i Konventës) dhe të së drejtës për respektimin e jetës private dhe familjare (neni 8 i Konventës). Jo të gjitha shkeljet e këtyre neneve domosdoshmërisht do të arrijë në këtë prag.

1 Raporti i 14-të i përgjithshëm i aktiviteteve të KPT-së, për periudhën nga 1 gusht i vitit 2003 deri më 31 korrik të vitit 2004 [CPT / Inf (2004) 28], para. 25.

Shkelje të rënda të të drejtave të njeriut mund të përfshijnë, për shembull:

- vrasjet jashtë-gjyqësore;
- neglizhencën e cila çon drejt rrezikut serioz për jetën ose shëndetin;
- torturën apo trajtimin çnjerëzor ose poshtëruës nga forcat e sigurisë, oficerët e burgut apo zyrtarët e tjerë publikë;
- zhdukjet e detyruara;
- rrëmbimet;
- skllavërinë, punën e detyruar dhe trafikimin e qenieve njerëzore;
- dhunimin ose abuzin seksual;
- sulme të rënda fizike, duke përfshirë edhe në kuadrin e dhunës në familje;
- shkatërrimi me qëllim i shtëpive ose pronave.

Shtetet anëtare, në bazë të Konventës, kanë detyrim të sigurojnë mbrojtje nga ligji penal në lidhje me disa nga të drejtat e parashikuara në këtë Konventë:

Neni 2 i Konventës

Gjykata vëren se në fjalinë e parë të Nenit 2 Paragrafi 1, jo vetëm që shtetiti i ndalohet të marri jetë me qëllim dhe në mënyrë të paligjshme, por i urdhërohet që të marri hapat e duhura për të mbrojtur jetën e personave brenda juridiksionit të tij (shih LCB k. Mbretëria e Bashkuar gjykimi i 9 qershorit 1998, Raportet mbi gjykimet dhe vendimet 1998- III, fq. 1403, paragrafi 36). Qëndrimi i përbashkët është që detyrimi i shtetit në këtë drejtim e tejkalon detyrimin e tij kryesor për të mbrojtur të drejtën për jetën me anë të hyrjes në fuqi të dispozitave efektive të së drejtës penale, me qëllim që të parandalojë kryerjen e veprave penale kundër personit të mbështetur nga makineria e zbatimit e ligjit për parandalimin, shuarjen dhe sanksionimin e shkeljeve të dispozitave të tilla. Megjithatë, është e pranuar nga ana e atyre që dalin para Gjykatës se Neni 2 i Konventës mund të nënkuptojë, në rrethana të veçanta të përcaktuara mirë, një detyrim pozitiv për autoritetet me qëllim që të marrin masa parandaluese operative për të mbrojtur një individ, jeta e të cilit është në rrezik nga veprat penale e një individi tjetër. [...]²

Neni 3 i Konventës

Me qëllim që një hetim të jetë efektiv në praktikë, parakushti është që shteti të miratoj dispozita të së drejtës penale duke shpallur të dënueshme me ligj praktikat të cilat janë në kundërshtim me Nenin 3 (krahaso, *mutatis mutandis*, M.C. kundër Bullgarisë, nr. 39272/98, paragrafët 150, 153 dhe 166, GJEDNJ 2003-XII, Nikolova dhe Veliçkova, cituar më lart, paragrafi 57, dhe Çamdereli, cituar më lart, paragrafi 38).³

Në lidhje me nenin 3 të Konventës, Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Torturës dhe Trajtimeve të tjera Çnjerëzore dhe Poshtëruese ose Dënimit e datës 10 dhjetor 1984 parashikon në nenin 4:

1. Çdo Shtet Palë duhet të sigurojë që të gjitha aktet e torturës të konsiderohen vepra penale në kuadër të ligjit të tij penal. E njëjta gjë duhet të jetë e vlefshme edhe në rastin e një përpjekje për të kryer torturë dhe për një akt nga çdo person i cili është bashkëfajtor ose pjesëmarrjes në torturë.
2. Çdo Shtet Palë duhet ti bëjë këto vepra të dënueshme me dënime të përshtatshme, të cilat marrin parasysh natyrën e tyre të rëndë.

Neni 4 i Konventës

Në këto rrethana, Gjykata çmon se kufizimi i pajtueshmërisë me Nenin 4 të Konventës vetëm në

- 2 Osman kundër Mbretërisë së Bashkuar (nr. 23452/94), gjykimi i datës 28 Tetor të vitit 1998 [Dhoma e Madhe], paragrafi 115
- 3 Gäfgen kundër Gjermanisë (nr. 22978/05), gjykimi i dates 1 Qershor të vitit 2010 [Dhoma e Madhe], paragrafi 117.

një veprim të drejtpërdrejtë nga ana e autoriteteve shtetërore, do të ishte në kundërshtim me instrumentet ndërkombëtare të cilat merren me këtë çështje dhe do të rezultonte në paefektshmëri. Në këto rrethana, Gjykata çmon se kufizimi i pajtueshmërisë me Nenin 4 të Konventës vetëm në një veprim të drejtpërdrejtë nga ana e autoriteteve shtetërore, do të ishte në kundërshtim me instrumentet ndërkombëtare të cilat merren me këtë çështje dhe do të rezultonte në paefektshmëri. Prandaj, nga kjo dispozitë vijon në mënyrë të domosdoshme që shtetet kanë detyrime pozitive, në të njëjtën mënyrë si, për shembull, në kuadër të Nenin 3, për të miratuar dispozita të së drejtës penale të cilat bëjnë të dënueshme me ligj praktikat e përmendura në Nenin 4 dhe i zbatojnë ato në praktikë (shih M.C. kundër Bulgarisë, cituar më lart, paragrafi 153).⁴

Neni 5 i Konventës

Gjykata thekson në këtë drejtim se heqja e lirisë së një individi e cila ka mbetur pa përgjigje është një mohim i plotë i këtyre garancive dhe shkelja më e rëndë e Nenit 5. Pasi e kanë marrën nën kontroll atë individ, autoritet kanë për detyrë të përgjigjen për vendndodhjen e tij ose të saj. Për këtë arsye, Neni 5 duhet kuptuar në mënyrë që kërkon nga autoritetet të marrin masa efektive për të mbrojtur nga rreziku i zhdukjes dhe për të kryer një hetim të shpejtë efektiv në bazë të një pretendimi të argumentuar se një person është ndaluar dhe nuk është parë më që atëherë.⁵

Neni 8 i Konventës

Në kontekstin e abuzimit seksual të personave me aftësi të kufizuara mendore, Gjykata deklaron:

Gjykata konstaton se mbrojtja që ofron ligji civil për veprime të këqija të tilla si në rastin e Znj. Y (Miss Y) nuk është e mjaftueshme. Ky është rasti ku vlerat themelore dhe aspektet thelbësore të jetës private janë vënë në rrezik. Parandalimi efektiv është i domosdoshëm në këtë fushë dhe mund të arrihet vetëm me anë të dispozitave të së drejtës penale; faktikisht, me dispozita të tilla dhe rregullohet çështja normalisht.⁶

Abuzimi seksual është pa dyshim një lloj i neveritshëm i veprimeve të këqija, me efekte të mëdha negative tek viktimat e tij. Fëmijët dhe individë të tjerë të lëndueshëm kanë të drejtë të mbrohen nga shteti, në formën e parandalimit efektiv të llojeve të tilla të rënda të ndërhyrjes me aspektet thelbësore të jetës së tyre private (shih, mutatis mutandis, gjykimin e lartpërmendur X dhe Y, f. 13, paragrafi 27).⁷

Ne kontekstin e dhunimit, Gjykata deklaron:

Mbi këtë bazë, Gjykata vlerëson se shtetet kanë një detyrim pozitiv të natyrshëm në Nenet 3 dhe 8 të Konventës për të miratuar dispozita të së drejtës penale me anë të të cilave do të ndëshkohet përdhunimi në mënyrë efektive dhe për t'i zbatuar ato në praktikë me anë të hetimit dhe ndjekjes penale efektive.⁸

4. Në udhëzimet, termi “autor” u referohet atyre që janë të përgjegjshëm për akte ose mosveprime që përbëjnë shkelje të rënda të të drejtave të njeriut.

Në Rezolutën e Asamblesë 1675 (2009) mbi “Gjendjen e të drejtave të njeriut në Evropë: nevoja për të çrrënjësuar mosndëshkimin”, në të cilën ka këmbëngulur që të gjithë autorët e shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut duhet të përgjigjen për veprimet e tyre, Asambleja Parlamentare ka deklaruar se:

4 Siliadin kundër Francës (nr. 73316/01), gjykimi i datës 26 Korrik të vitit 2005, paragrafi 89

5 Kurt kundër Turqisë (nr. 24276/94), gjykimi i datës 25 Maj të vitit 1998, paragrafi 124

6 X dhe Y kundër Hollandës (nr. 8978/80), gjykimi i datës 26 Mars të vitit 1985, paragrafi 27

7 Stubbings dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Baskuar (nr. 22083/93 dhe 22095/93), gjykimi i datës 22 Tetor të vitit 1996, paragrafi 64

8 M.C. kundër Bulgarisë (nr. 39272/98), gjykimi i datës 4 dhjetor 2003, paragrafi 153

2. Kjo duhet të zbatohet edhe për nxitësit dhe organizatorët e krimeve të tilla, siç u afirmua kohët e fundit nga Kuvendi në Rezolutën 1645 (2009) në lidhje me çështjen Gongadze.⁹

5. Në udhëzimet, termi “viktimë” i referohet personit fizik i cili ka pësuar dëm, duke përfshirë lëndime fizike apo mendore, vuajtje shpirtërore ose humbje ekonomike, të shkaktuara nga një shkelje e rëndë të drejtave të njeriut. Termi “viktimë” gjithashtu mund të përfshijë, sipas rastit, familjen e ngushtë ose vartësit e drejtpërdrejtë të viktimës. Një person duhet të konsiderohet viktimë pavarësisht nëse autori i shkeljes është identifikuar, arrestuar, ndjekur penalisht ose dënuar, dhe pavarësisht nga marrëdhëniet familjare ndërmjet autorit dhe viktimës.

Përkufizimi është i bazuar në përkufizimin e “viktimave” në Rekomandimin e Këshillit të Evropës të Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi ndihmën ndaj viktimave të krimit (Rec (2006) 8, të miratuar më 14 qershor 2006):

1.1. Viktima nënkupton një person fizik i cili ka pësuar dëm, duke përfshirë lëndime fizike apo mendore, vuajtje shpirtërore ose humbje ekonomike, shkaktuar nga veprime ose mosveprime që përbëjnë shkelje të së drejtës penale të një shteti anëtar. Termi “viktimë” gjithashtu përfshin, sipas rastit, familjen e ngushtë ose vartësit e drejtpërdrejtë të viktimës.

Shihni gjithashtu përkufizimin e “viktimave” në parimin 2 të Deklaratës së Parimeve Bazë të Drejtësisë për Viktimat e Krimit dhe Abuzimit të Pushtetit të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara të datës 29 Nëntor të vitit 1985, si dhe në Udhëzimin I për Mbrojtjen e Viktimave të Akteve Terroriste, miratuar nga Komiteti i Ministrave më 2 mars 2005.

6. Këto udhëzime plotësojnë dhe nuk zëvendësojnë standarde të tjera në lidhje me mosndëshkimin. Në veçanti, ato nuk përsërisin dhe nuk kualifikojnë detyrimet dhe përgjegjësitë e shteteve në kuadër të të drejtës ndërkombëtare, duke përfshirë të drejtën ndërkombëtare humanitare dhe të drejtën penale ndërkombëtare, dhe as nuk janë të destinuara për të zgjidhur çështje, si marrëdhënia midis të drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe rregullave të tjera të së drejtës ndërkombëtare. Asnjë gjë në këto udhëzime nuk i parandalon shtetet nga krijimi ose ushtrimi i masave më të forta ose më të gjera për të luftuar mosndëshkimin.

Udhëzimet nuk kanë për qëllim të zgjidhin çështje siç është marrëdhënia midis të drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut (siç pasqyrohet në këto udhëzime) dhe rregullave të tjera të së drejtës ndërkombëtare.

9 Çështja të cilës i referohet Asambleja Parlamentare është çështja e Gongadze kundër Ukrainës (nr. 34056/02), gjykimi i datës 8 nëntor 2005.

III. Masa të përgjithshme për parandalimin e mosndëshkimit

1. Në mënyrë që të shmangin defektet ose mangësitë ligjore që kontribuojnë në mosndëshkim,
 - Shtetet duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për të përmbushur detyrimet e tyre sipas Konventës për të miratuar dispozitat e të drejtës penale me qëllim që shkeljet e rënda të drejtave të njeriut të ndëshkohen në mënyrë efektive nëpërmjet dënimeve të përshtatshme. Këto dispozita duhet të zbatohen nga organet përkatëse ekzekutive dhe gjyqësore në mënyrë koherente dhe jo diskriminuese.
 - Shtetet duhet të sigurojnë mundësinë e procedimit disiplinor ndaj zyrtarëve shtetërorë.
 - Në të njëjtën mënyrë, shtetet duhet të sigurojnë një mekanizëm që përfshin masa penale dhe disiplinore në mënyrë që të ndëshkojnë sjelljen dhe praktikën në kuadër të organeve shtetërore të cilat çojnë drejt mosndëshkimit për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut.
2. Shtetet - duke përfshirë zyrtarët dhe përfaqësuesit e tyre - duhet të dënojnë publikisht shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut.
3. Shtetet duhet të përpunojnë politika dhe të marrin masa praktike për të parandaluar dhe luftuar një kulturë institucionale brenda autoriteteve të tyre e cila nxit mosndëshkimin. Këto masa duhet të përfshijnë:
 - promovimin e kulturës së respektimit të të drejtave të njeriut dhe punën sistematike për zbatimin e të drejtave të njeriut në nivel kombëtar;
 - krijimin ose forcimin e mekanizmave përkatëse të trajnimit dhe të kontrollit;
 - futjen e politikave kundër korrupsionit;
 - bërjen e autoriteteve përkatëse të vetëdijshme për detyrimet e tyre, duke përfshirë edhe marrjen e masave të nevojshme në lidhje me parandalimin e mosndëshkimit, dhe vendosjen e ndëshkimeve të duhura për dështimin në zbatimin e këtyre detyrimeve;
 - zbatimin e një politike të tolerancës zero për shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut;
 - sigurimin e informacioneve për publikun në lidhje me shkeljet dhe reagimin e autoriteteve ndaj këtyre shkeljeve;
 - ruajtjen e arkivave dhe lehtësimin e qasjes së duhur ndaj tyre përmes mekanizmave të zbatueshme.
4. Shtetet duhet të krijojnë dhe publikojnë procedura të qarta për raportimin e akuzave për shkeljet e rënda të drejtave të të njeriut, si brenda autoriteteve të tyre, ashtu edhe për publikun e gjerë. Shtetet duhet të sigurojnë që raportime të tilla të pranohen dhe të trajtohen në mënyrë efektive nga autoritetet kompetente.
5. Shtetet duhet të marrin masa për të inkurajuar raportimin nga ata që janë të vetëdijshëm për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut. Ato duhet, ku është e nevojshme, të marrin masa për të siguruar që ata të cilët raportojnë shkelje të tilla të jenë të mbrojtur nga çdo ngacmim dhe hakmarrje.
6. Shtetet duhet të përcaktojnë plane dhe politika për t'iu kundërvënë diskriminimit që mund të çojë në shkelje të rënda të të drejtave të njeriut dhe të mosndëshkimit për akte të tilla dhe përsëritjen e tyre.
7. Shtetet duhet të krijojnë mekanizma për të siguruar integritetin dhe përgjegjësinë e agjentëve të tyre. Shtetet duhet të pushojnë nga puna individë, për të cilët është konstatuar, nga organi kompetent, të jenë përgjegjës për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut ose për avancimin e mëtejshëm apo tolerimin e mosndëshkimit, ose të miratojnë masa të tjera të përshtatshme disiplinore. Shtetet duhet veçanërisht të zhvillojnë dhe të institucionalizojnë kodet e sjelljes.

Në raportin e tij të 14-të të përgjithshëm KPT-ja deklaron:

26. Lufta kundër mosndëshkimit duhet të fillojë në shtëpi, domethënë në kuadër të agjencisë në fjalë (policia apo shërbimi i burgjeve, autoritet ushtarake, etj). Shumë shpesh ndjenja e bashkësisë çon drejt gatishmërisë për të ndenjur së bashku dhe për të ndihmuar njëri-tjetrin atëherë

kur janë bërë akuzat për keqtrajtime, duke arritur deri tek fshehja e veprave të paligjshme të kolegëve. Kërkohej një veprim pozitiv, përmes trajnimit dhe duke dhënë shembuj, me qëllim që të promovoj një kulturë ku nga njëra anë, puna dhe shoqërimi me kolegë të cilët janë të prirur për keqtrajtime, konsiderohen si joprofesionale - dhe të rrezikshme nga pikëpamja e përparimit në karrierë, dhe nga ana tjetër përkatësia një ekipi i cili nuk kryhen vepra të tilla konsiderohet si e saktë dhe shpërblyese nga ana profesionale. Duhet krijuar një atmosferë ku gjëja e drejtë për të bërë është të denoncohet keqtrajtimi nga ana e kolegëve; duhet të ekzistoj një kuptim i plotë se fajësia për keqtrajtim shtrihet përtej autorëve të vërtetë duke përfshirë secilin person që ka ose që duhet të kishte dijeni se keqtrajtimi po ndodh dhe nuk ka vepruar për ta parandaluar ose denoncuar atë. Kjo nënkupton ekzistencën e një linjë të qartë të denoncimit, si dhe miratimin e masave mbrojtëse për bilbilfryrësit.

27. Në shumë shtete të vizituara nga KPT-ja, tortura dhe vepra të tilla si keqtrajtimi gjatë kryerjes së një detyre, ushtrimi i forcës për të marrë një deklaratë, abuzimi i autoritetit, etj. përbëjnë vepra të veçanta penale që ndiqen penalisht sipas detyrës zyrtare. KPT-ja mirëpret ekzistencën e dispozitave ligjore të këtij lloji. Megjithatë, KPT-ja ka konstatuar se, në disa vende, organet e prokurorisë kanë liri veprimi të konsiderueshme në lidhje me fillimin e një hetimi paraprak kur një informacion në lidhje me një keqtrajtim të mundshëm të personave të privuar nga liria del në pah. Sipas mendimit të Komitetit, edhe në mungesë të një ankimimi formal, autoritete të tilla duhet kenë një detyrim ligjor për të ndërmarrë një hetim sa herë që marrin ndonjë informacion të besueshëm, nga çdo burim, që mund të ketë ndodhur keqtrajtim i personave të privuar nga liria e tyre. Në lidhje me këtë, kuadri ligjor për sa i përket përgjegjësisë do të forcohet nëse zyrtarëve publikë (policë, drejtorë të burgjeve, etj.) do tu kërkohej zyrtarisht që të njoftojnë autoritetet përkatëse menjëherë sapo të bëhen të vetëdijshëm për çdo informacion dëshmon për keqtrajtim.

Ekzistenca i një kuadri të përshtatshëm ligjor nuk është i mjaftueshëm në vetvete për të garantuar që do të merren veprimet përkatëse në lidhje me rastet e keqtrajtimit të mundshëm. Vëmendje e duhur i duhet kushtuar sensibilizimit të autoriteteve përkatëse për obligimet e rëndësishme të cilat janë detyrë e tyre.

[...]

37. Procedurat disiplinore sigurojnë një lloj shtesë dëmshpërblym kundër keqtrajtimit dhe mund të kryhen paralelisht me procedurën penale. Fajësia disiplinore e zyrtarëve në fjalë duhet të shqyrtohet në mënyrë sistematike, pavarësisht nëse sjellja e keqe në fjalë është konstatuar se përbën vepër penale. KPT-ja ka rekomanduar një sërë masash mbrojtëse procedurale që duhen ndjekur në këtë kontekst; për shembull, kolegjet e gjykimit për procedurat policore disiplinore duhet të përfshijnë të paktën një anëtar të pavarur.
38. Hetimet për shkelje të mundshme disiplinore nga zyrtarët publikë mund të kryhen nga një departament hetimor i veçantë i brendshme në kuadër të strukturave të agjencive në fjalë. Megjithatë, KPT-ja inkurajon krijimin e një organi fuqiplotë të pavarur hetimor. Një organ i tillë duhet të ketë kompetencën për të urdhëruar fillimin e procedurave disiplinore. Pavarësisht nga struktura zyrtare e agjencisë hetimore, KPT-ja konsideron se funksionet e saj duhet të bëhen të njohura publikisht në mënyrë e duhur. Pavarësisht nga mundësia që personat kanë për të paraqitur ankimime direkt tek agjencia, për autoritete publike të tilla si policia regjistrimi i të gjitha paraqitjeve të cilat mund të përbëjnë një ankimim duhet të jetë i detyrueshëm; për këtë qëllim, duhen futur forma të duhura për të bërë të ditur se ankimimi është pranuar dhe për të konfirmuar se çështja do të ndiqet penalisht. Nëse, në një rast të caktuar, është konstatuar se sjellja e zyrtarëve në fjalë mund të jetë e një natyre penale, agjencia hetimore duhet të njoftojë menjëherë - pa vonesë - organet kompetente të prokurorisë.

39. Me kujdes të veçantë duhet siguruar që personat të cilët kanë qenë viktime të keqtrajtimit nga ana e zyrtarëve publikë të mos dekurajohen nga bërja e ankimit. Për shembull, efektet e mundshme negative të një mundësie që zyrtarë të tillë mund të nisin proces penal për shpifje kundër një personi i cili i akuzon ata gabimisht për keqtrajtim duhet të mbahen nën shqyrtim. Bilanci ndërmjet interesave konkurruese të ligjshme duhet të vendoset në mënyrë të barabartë. Në këtë kontekst u duhet referuar disa pikave të caktuara tashmë në paragrafin 28.
40. Çdo dëshmi për keqtrajtim nga ana e zyrtarëve publikë që shfaqet gjatë proceseve civile gjithashtu meriton shqyrtim të hollësishëm. Për shembull, në rastet ku kanë ekzistuar pretendime të suksesshme për dëme apo marrëveshje jashtë-gjyqësore mbi baza që përfshijnë sulmin nga ana e oficerëve të policisë, KPT-ja ka rekomanduar kryerjen e një shqyrtimi të pavarur. Një rishikim i tillë duhet të përpiqet që të vërtetojë, duke pasur parasysh natyrën dhe rëndësinë e akuzave ndaj policëve në fjalë, nëse çështja e procedurave penale dhe/ose disiplinore duhet të merret (përsëri) në konsideratë.
- [...]
42. Së fundi, askush nuk duhet të ketë ndonjë dyshim për sa i përket angazhimit të organeve shtetërore në luftën kundër mosndëshkimit. Kjo do të mbështesë veprimet që do të merren në të gjitha nivelet e tjera. Kur është e nevojshme, këto autoritete nuk duhet të ngurrojnë për të dhënë, nëpërmjet një deklarate zyrtare në nivelin më të lartë politik, mesazhin e qartë se duhet të ekzistoj "tolerancë zero" për torturën dhe format e tjera të keqtrajtimit.¹⁰

Në lidhje me trajnimin e personelit përgjegjës për zbatimin e ligjit, KPT-ja deklaroi në Raportin e Përgjithshëm të 2-të:

59. Së fundi, KPT-ja dëshiron të theksojë rëndësinë e madhe që i kushton trajnimit të personelit përgjegjës për zbatimin e ligjit (i cili duhet të përfshijë edukimin mbi çështjet e të drejtave të njeriut - krh. edhe Nenin 10 të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Torturës dhe Trajtimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëruese ose Ndëshkimit). Ndoshta nuk ekziston garanci më e mirë kundër keqtrajtimit të një personi të privuar nga liria e tij sesa një oficer policie ose burgu i trajnuar si duhet. Oficerët e kualifikuar do të jenë në gjendje për të kryer me sukses detyrat e tyre, pa pasur nevojë të keqtrajtojnë dhe duke ushtruar masat mbrojtëse themelore të paraburgosurve dhe të dënuarve.
60. Në lidhje me këtë, KPT-ja beson se aftësia për të komunikuar me njerëzit duhet të jetë një faktor kryesor në procesin e punësimit të personelit përgjegjës për zbatimin e ligjit dhe se, gjatë trajnimit, duhet theksuar në mënyrë të konsiderueshme zhvillimi i aftësive për të komunikuar me njerëzit, i bazuar në respektimin e dinjitetit njerëzor. Zotërimi i aftësive të tilla shpesh do t'i mundësojë një oficeri policie ose oficeri burgu të qetësojë një situatë e cila përndryshe mund të kthehet në dhunë, dhe në përgjithësi, do të çojë në uljen e tensionit dhe ngritjen e cilësisë së jetës, në institucionet e policisë dhe të burgjeve, nga do të përfitojnë të gjitha palët.¹¹

10 Raporti i përgjithshëm i 14-të mbi aktivitetet e KPS-së për periudhën 1 gusht 2003 deri më 31 korrik 2004 [CPT/Inf (2004)28]

11 Raporti i përgjithshëm i 2-të mbi aktivitetet e KPS-së për periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor 1991 [CPT/Inf (92) 3].

IV. Masa mbrojtëse për mbrojtjen e personave të cilëve u është hequr liria prej shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut

1. Shtetet duhet të ofrojnë garanci të përshtatshme për personat të cilëve u është hequr liria nga ana e një autoriteti publik, me qëllim që të parandalohet çdo heqje lirie e paligjshme apo keqtrajtim, dhe të sigurojnë që çdo heqje lirie e paligjshme apo keqtrajtim nuk do të mbetet pa u ndëshkuar. Në veçanti, personave të cilëve u është hequr liria duhet tu sigurohen garancitë në vijim:
 - e drejta për të informuar ose të kenë të informuar një palë të tretë të zgjedhur nga vetë ai ose ajo rreth heqjes së lirisë së tyre, vendndodhjes së tyre dhe rreth ndonjë transferimi;
 - e drejta për të pasur qasje në një avokat;
 - e drejta për të pasur qasje në një mjek.Personat të cilëve u është hequr liria duhet të informohen në mënyrë të qartë pa vonesë për të gjitha të drejtat e tyre, duke përfshirë edhe ato të lartpërmendura. Çdo mundësi e autoriteteve për të shtyrë zbatimin e njërës prej këtyre të drejtave, me qëllim që të mbrohen interesat e drejtësisë dhe rendit publik, duhet të përcaktohet qartë me ligj, dhe zbatimi i saj duhet të jetë i kufizuar në mënyrë të saktë në kohë dhe t'i nënshtrohet masave mbrojtëse procedurale të duhura.

Kur një person është lënduar gjatë ndalimit ose heqjes së lirisë, gjykata ka vendosur masa të caktuara për mbrojtjen e personit në fjalë:

Gjykata thekson se një shtet është përgjegjës për çdo person të cilit i është hequr liria, pasi ky i fundit, duke qenë në duart e oficerëve të policisë, është në një situatë të lëndueshme dhe autoritetet kanë për detyrë ta mbrojnë atë person. Zbatimi me rreptësi i garancive themelore siç është e drejta për t'u ekzaminuar nga një mjek i zgjedhur nga vetë personi, përveç ekzaminimit nga një mjek i thirrur nga organet e policisë, që nga momenti i heqjes së lirisë, si dhe mundësia për të pasur një avokat dhe kontakt me një anëtar të familjes, krahas një ndërhyrje të shpejtë gjyqësore efektive, mund të çojë në zbulimin dhe parandalimin e keqtrajtimit të cilit, si në rastin në fjalë, personat e paraburgosur rrezikojnë t'i nënshtrohen, sidomos për marrjen e dëshmive.

Gjykata rikujton në këtë drejtim se kur një person është dëmtuar duke qenë i ndaluar në polici, edhe pse ai person është tërësisht nën kontrollin e policëve, do të lindin supozime të forta rreth fakteve në lidhje me çdo dëmtim që ndodh gjatë asaj periudhe (shih gjykimin e Salman kundër Turqisë [GC], nr. 21986/93, paragrafi 100, GjEDNJ 2000-VII). Shteti ka për detyrë që të japi një shpjegim të arsyeshëm se si kanë ndodhur këto dëmtime dhe të siguroj prova të cilat konstatojnë fakte të cilat hedhin dyshime mbi pretendimet e viktimës, sidomos nëse këto fakte janë të mbështetura nga raportet mjekësore (shih, ndër të tjera, gjykimet e Selmouni-t cituar më lart, paragrafi 87, dhe Altay kundër Turqisë, nr. 22279/93, paragrafi 50, 22 maj 2001).¹²

Për sa i përket ndalimit nga policia, KPT-ja deklaron në Raportin e tij të përgjithshëm 2-të:

36. KPT-ja i kushton rëndësi të veçantë tre të drejtave për personat e ndaluar nga policia: e drejta e personit në fjalë për të njoftuar një palë të tretë sipas zgjedhjes së tij (anëtar të familjes, mik, konsullatën) rreth faktit të ndalimit të tij, të drejtën për të pasur një avokat, dhe të drejtën për të kërkuar ekzaminim mjekësor nga një mjek i zgjedhur nga vetë ai (përveç ekzaminimeve mjekësore të kryera nga një mjek i thirrur nga autoritetet e policisë). Këto janë, sipas mendimit të KPT-së, tre masat mbrojtëse themelore kundër keqtrajtimit të personave të ndaluar e të cilat duhet të zbatohen që nga momenti i heqjes së lirisë, pavarësisht se si ajo mund të përshkruhet në sistemin ligjor në fjalë (ndalim, arrest, etj.).

12 Algür kundër Turqisë (nr. 32574/96), gjykim i datës 22 tetor 2002, paragrafi 44 (në dispozicion vetëm në gjuhën franceze; përkthimi jozyrtar është i siguruar nga Sekretariati).

37. Personat e ndaluar prej policisë duhet të informohen në mënyrë të qartë e pa vonesë rreth të gjitha të drejtave të tyre, duke përfshirë edhe ato të përmendura në paragrafin 36. Më tej, çdo mundësi e ofruar për autoritetet me qëllim që të vonojnë ushtrimin e njërës ose e të drejtave të tjera që vijojnë më tej, në mënyrë që të mbrohen interesat e drejtësisë, duhet të përcaktohen qartë dhe zbatimi i tyre duhet kufizuar në mënyrë të caktuar në kohë. Për sa i përket më hollësisht të drejtave për të pasur një avokat dhe për të kërkuar një ekzaminim mjekësor nga një mjek tjetër përveç mjekut të thirrur nga policia, në sistemet ku veçanërisht avokatët dhe mjekët mund të zgjidhen nga lista të paracaktuara të hartuara në pajtim me organizatat përkatëse profesionale, duhet të eliminohet çdo nevojë për ta shtyrë ushtrimin e këtyre të drejtave.
38. Mundësia për të pasur një avokat për personat e ndaluar nga policia duhet të përfshijë të drejtën për të kontaktuar dhe për t'u vizituar nga avokati (në të dyja rastet sipas kushteve që garantojnë fshehtësinë e diskutimet e tyre), si dhe, në parim, të drejtën e personit në fjalë që ta ketë avokatin të pranishëm gjatë marrjes në pyetje.

Në lidhje me ekzaminim mjekësor të personave të ndaluar nga policia, të gjitha ekzaminimet e tilla duhet të kryhen veçmas marrjes në pyetje, dhe mundësisht pa praninë e oficerëve të policisë. Për më tepër, rezultatet e çdo ekzaminimi mjekësor, si dhe deklaratat përkatëse nga të ndaluarit dhe konkluzionet e mjekut duhet të regjistrohen zyrtarisht nga mjeku dhe të vihen në dispozicion të të ndaluarit dhe avokatit të tij.¹³

Në këtë drejtim, duhet të përkujtojmë se Komiteti i Ministrave, në përgjigjen e tij për Rekomandimin 1257 (1995) të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, tashmë ftoi autoritetet e shteteve anëtare për të respektuar udhëzimet e KPT-së të paraqitura më lartë (paragrafët 36-38).

Në raportin e tij të 12-të KPT-ja nënvizon edhe një herë rëndësinë e këtyre garancive themelore dhe sqaron më tej se si ato mund të zbatohen në praktikë:

Për sa i përket të drejtës për të pasur një avokat

41. [...] KPT-ja ka theksuar se, në përvojën e tij, periudha menjëherë pas heqjes së lirisë është periudha kur rreziku i frikësimit dhe keqtrajtimit fizik është më i madh. Si pasojë, mundësia që e personave të ndaluar nga policia për të pasur një avokat gjatë kësaj periudhe është një garanci themelore kundër keqtrajtimit. Ekzistimi i kësaj mundësie do të ketë një efekt bindës mbi ata që janë të prirur për të keqtrajtuar personat e ndaluar; më tej, një avokat është i përgatitur mirë për të marrë masat e duhura, nëse keqtrajtimi me të vërtetë ndodh. KPT-ja pranon se m qëllim që të mbrohen interesat legjitime të hetimit të policisë, mund të jetë veçanërisht e nevojshme për ta shtyrë për një periudhë të caktuar mundësinë e personit të ndaluar për të pasur një avokat të zgjedhur prej tij. Megjithatë, kjo nuk duhet të rezultojë tek heqja e të drejtës për të pasur një avokat gjatë gjithë periudhës në fjalë. Në raste të tilla, duhet të organizohet angazhimi i një avokati të pavarur.

E drejta për të pasur një avokat duhet të përfshijë të drejtën për të biseduar me të në mënyrë private. Personi në fjalë duhet që gjithashtu, në parim, të ketë të drejtë për të pasur të pranishëm avokatin gjatë çdo marrjeje në pyetje nga policia. Natyrisht, kjo nuk duhet të pengojë policinë për ta marrë në pyetje një person të ndaluar për çështje urgjente, madje edhe në mungesën e një avokati (i cili nuk mund të jetë menjëherë në dispozicion), dhe as nuk përjashton mundësinë për të zëvendësuar një avokat i cili pengon zhvillimin e duhur së marrjes në pyetje.

KPT-ja ka theksuar se të drejtët për të pasur një avokat duhet ta gëzojnë jo vetëm personat e ndaluar, por edhe të gjithë ata që kanë një detyrim ligjor për të marrë pjesë - dhe për të qëndruar - në një institucion të policisë, p.sh. si një "dëshmitar".

Më tej, me qëllim që e drejta për të pasur një avokat të jetë plotësisht efektive në praktikë, për persona që nuk janë në pozitë të paguajnë për një avokat, duhet të hartohen dispozita të përshtatshme.

13 Raporti i përgjithshëm i 2-të mbi aktivitetet e KPS-së për periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor 1991 [CPT/Inf (1992) 3].

Për sa i përket të drejtës për të pasur një mjek

42. Personat e ndaluar nga policia duhet të kenë të drejtë, e cila është të njohur zyrtarisht, për të pasur një mjek. Me fjalë të tjera, një mjek duhet të thirret gjithmonë e pa vonesë, nëse një person kërkon një ekzaminim mjekësor; oficerët e policisë nuk duhet të përpiqen për të filtruar kërkesa të tilla. Për më tepër, e drejta për të pasur një mjek duhet të përfshijë të drejtën e një personi të ndaluar që të ekzaminohet, dhe në qoftë se personi në fjalë dëshiron, të ekzaminohet nga ana e një mjeku të zgjedhur prej tij/saj (krahas çdo ekzaminimi mjekësor që kryhet nga një mjek i thirrur nga policia).

Të gjitha ekzaminimet mjekësore të personave të ndaluar duhet të kryhen veçmas marrjes në pyetje nga ana e zyrtarëve përgjegjës për zbatimin e ligjit dhe, në qoftë se mjeku në fjalë nuk kërkon ndryshe në një rast të veçantë, pa praninë e zyrtarëve të tillë.

Është gjithashtu e rëndësishme që personat që janë liruar pas ndalimit nga policia pa u çuar para një gjykatësi kanë të drejtë për të kërkuar në mënyrë të drejtpërdrejtë një ekzaminim mjekësor/vërtetim nga një mjek ligjor i akredituar.

Në Raportin e tij të përgjithshëm të 2-të KPT-ja thekson rëndësinë e të drejtës për të pasur një mjek në kontekstin e përdorimit të dhunës brenda burgjeve:

Personeli i burgut ndonjëherë duhet të ushtrojë forcë për të kontrolluar të burgosurit e dhunshëm dhe, jashtëzakonisht, madje mund të kenë nevojë të përdorë instrumente të kufizimit fizik. Këto janë qartë situata me rrezik të lartë për sa i përket keqtrajtimit të mundshëm të të burgosurve, dhe si të tilla bëjnë thirrje për masa mbrojtëse të veçanta. Një i burgosur ndaj të cilit është përdorur ndonjë lloj dhune duhet të ketë të drejtën të ekzaminohet menjëherë dhe, nëse është e nevojshme, të trajtohet nga një mjek. Ky ekzaminim duhet të kryhet pa u dëgjuar dhe me preferencë pa u parë nga personeli jo-mjekësor dhe rezultatet e ekzaminimit (duke përfshirë deklaratat përkatëse nga i burgosuri dhe konkluzionet e mjekut) duhet të evidentohen zyrtarisht dhe t'i vihen në dispozicion të burgosurit. Në ato raste të rralla kur kërkohet përdorimi i instrumenteve për kufizimin fizik, i burgosuri në fjalë duhet të mbahet nën mbikëqyrje të përshtatshme dhe të vazhdueshme. Më tej, instrumentet e kufizimit duhet të hiqen në rastin më të parë të mundshëm; ato nuk duhet të përdoren kurrë ose përdorimi i tyre nuk duhet zgjatur kurrë për ndëshkim. Së fundi, duhet të mbahet evidencë për çdo rast të përdorimit të forcës kundër të burgosurve.¹⁴

Për sa i përket të drejtës për të informuar një palë të tretë

43. E drejta e një personi të ndaluar nga policia për të informuar një palë të tretë për ndalimin e tij, parimisht, duhet të garantohet që nga fillimi i heqjes së lirisë së tij. Sigurisht, KPT-ja pranon që ushtrimi i kësaj të drejte mund t'i nënshtrohet disa përjashtimeve, me qëllim për të mbrojtur interesat legjitime të hetimit policor. Megjithatë këto përjashtime duhet të përcaktohen dhe kufizohen qartë në kohë dhe ushtrimi i këtyre përjashtimeve duhet të rrethohet nga garancitë e duhura (për shembull, çdo vonesë për njoftimin e një të afërmi ose të një personi tjetër duhet të depozitohet me shkrim me arsyet që e kanë motivuar, dhe i nënshtrohet më parë një funksionari të lartë të policisë që nuk ka asnjë lidhje me çështjen në fjalë ose një prokurori).
44. Të drejtat e personave të privuar nga liria nuk do të kenë asnjë vlerë në rast se këta persona nuk janë të vetëdijshëm për ekzistencën e tyre. Si pasojë, është e detyrueshme që personat e ndaluar nga policia të jenë shprehimisht të informuar për të drejtat e tyre, pa afat dhe në një gjuhë që ata kuptojnë. Për këtë, një formular që saktëson në mënyrë të thjeshtë të drejtat duhet t'u shpërndahet rregullisht personave të ndaluar nga policia, që nga fillimi i ndalimit të tyre. Për më tepër, personave të interesuar u duhet kërkuar nënshkrimi i një deklarate e cila dëshmon se ata janë mirë informuar për të drejtat e tyre.

14 Raporti i përgjithshëm i 2-të mbi aktivitetet e KPS-së për periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor 1991 [CPT/Inf (1992) 3], paragrafi 53.

Për sa i përket parandalimit të dhunës brenda institucioneve penale

61. Çdo shenjë dhune e vënë re kur një i burgosur kalon në kontrollin mjekësor të pranimit duhet të regjistrohet plotësisht, së bashku me çdo pohim përkatës nga i burgosuri dhe konkluzionet e mjekut. Më tej, ky informacion duhet t'i vihet në dispozicion të burgosurit.¹⁵

Ne Raportin e përgjithshëm të 12-të KPT-ja thekson rëndësinë e kontrollit gjyqësor në kuadër të ndalimit nga policia:

45. KPT-ja ka vënë në pah, shpeshherë, rolin e autoriteteve gjyqësore në luftën kundër keqtrajtimeve nga policia.
Për shembull, të gjithë personat e ndaluar nga policia të cilët parashikohen të paraburgosen duhet të paraqiten fizikisht përpara gjyqtarit kompetent për të marrë vendimin; por nuk ndodh kështu në të gjitha vendet e vizituara nga KPT-ja. Paraqitja e personit përpara gjyqtarit do t'i lejojë atij ose asaj që është keqtrajtuar të bëjë një ankim atëherë kur nevojitet. Për më tepër, edhe në mungesë të një ankimi formal, gjykatësi mund të marrë masat e duhura në rast se ka tregues të tjerë për keqtrajtme (për shembull, plagosje të dukshme; ose nga pamja apo sjellja e përgjithshme e një personi).

Sigurisht, gjykatësi duhet të marrë masat e duhura në rast se ka tregues për keqtrajtme nga policia. Në lidhje me këtë, sa herë që persona të dyshuar për një shkelje penale paraqiten përpara një gjyqtari pas paraburgimit nga policia me pretendimin se janë keqtrajtuar, gjyqtari duhet t'i depozitojë pretendimet me shkrim, të urdhërojë menjëherë një ekspertizë mjeko-ligjore dhe të marrë masat e nevojshme me qëllim që pretendimet të jenë të verifikuara ashtu si duhet. Këshillohet të ndiqet kjo procedurë pavarësisht se personi i interesuar ka ose jo plagë të jashtme të dukshme. Për më tepër, dhe në mungesë të një pretendimi për keqtrajtim të shprehur qartë, i takon gjyqtarit të kërkojë një ekspertizë mjekoligjore kur ka arsye të tjera për të besuar se një person që paraqitet para tij mund të ketë qenë viktimë e keqtrajtimeve.

Shqyrtimi i zellshëm nga autoritetet gjyqësore dhe autoritetet e tjera kompetente i të gjitha ankimeve për keqtrajtim bërë kundër anëtarëve të forcave të rendit, dhe nëse nevojitet, dhënia e një dënimi të duhur do të kenë një efekt bindës tepër të fortë. Në të kundërt, në rast se këto autoritete nuk marrin masa efektive për trajtimin e ankimeve të paraqitura, ata që janë të prirur për të përdorur forcën ndaj personave të ndaluar, fare lehtë do të mendojnë se mund të veprojnë pa u dënuar.¹⁶

2. Përveç të drejtave të lartpërmendura, personat të cilëve u është hequr liria kanë të drejtë për procedura gjyqësore nëpërmjet të cilave në mënyrë të shpejt do të merret vendimi për ligjshmërinë e heqjes së lirisë së tyre dhe të urdhërohet lëshimi në qoftë se heqja e lirisë është e paligjshme. Personat e arrestuar apo të cilëve u është hequr liria në lidhje me kryerjen e një vepre penale duhet të çohen menjëherë përpara një gjykatësi, dhe ata kanë të drejtë të kenë një gjykim brenda një afati të arsyeshëm ose të lirohen në pritje të gjykimit, në përputhje me praktikën gjyqësore të Gjykatës.
3. Shtetet duhet të marrin masa efektive për të mbrojtur nga rreziku i shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut duke mbajtur të dhëna në lidhje me datën, kohën dhe vendin e personave të cilëve u është hequr liria, si dhe informacione të tjera përkatëse në lidhje me heqjen e lirisë.

15 Raporti i përgjithshëm i 3-të mbi aktivitetet e KPS-së për periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor 1992 [CPT/Inf (93) 12],

16 Raporti i përgjithshëm i 12-të mbi aktivitetet e KPS-së për periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor 2001 [CPT/Inf (2002) 15],

Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës, të dhënat e mësipërme duhet të mbahen në mënyrë që ndalimi të jetë në përputhje me Nenin 5 Paragrafin 1 të Konventës:

Regjistrimi i të dhënave të sakta në lidhje me datën, kohën dhe vendin e të ndaluarve, si dhe arsyet për ndalimin dhe emrat e personave që e kryejnë atë, janë të nevojshme me qëllim që ndalimi i një individi të jetë në përputhje me kërkesat e ligjshmërisë sipas Nenit 5 Paragrafi 1. Mungesa e të dhënave të këtij aplikuesi zbulon një dështim të rëndë, i cili është e rënduar me konstatimet e Komisionit në lidhje me të mosbesueshmërinë dhe pasaktësinë e përgjithshme të të dhënave në fjalë. Gjykata gjithashtu ndan shqetësimet e Komisionit në lidhje me praktikën e zbatuar në regjistrimin e të dhënave të mbajtura nga xhandarë dëshmitarë të cilët u paraqitën para delegatëve të Komisionit - faktin që nuk është regjistruar kur një person është mbajtur në vende të tjera se sa në zonën e kujdestarisë të caktuar zyrtarisht ose kur një person është larguar nga një zonë ndalimi për çdo qëllim ose kur mbahet në tranzit. Ajo gjen të papranueshëm dështimin për të mbajtur të dhëna të cilat mundësojnë përcaktimin e vendndodhjes të një të ndaluarit në një kohë të caktuar.¹⁷

Gjykata ka deklaruar se mangësitë në praktikën e regjistrimit të ndalimit mund të përbëjë një shkelje të Nenit 5 Paragrafi 1 i Konventës:

Për më tepër, disa mangësi serioze janë vënë re në praktikën e regjistrimit të ndalimit në stacionet e xhandarmerisë [...]. Mangësia e parë e konstatuar nuk është e lejuar nga ligji i brendshëm përkatësisht, që është praktika e xhandarëve të ndalojnë persona për arsye të ndryshme në stacionet e tyre pa i regjistruar në dosjet e ndalimit. Dështimi i dytë dhe i tretë më tej theksojnë pabesueshmërinë e dosjeve të ndalimit pasi ato të dhëna nuk do të tregojnë nëse dikush është kapur nga forcat ushtarake dhe nuk mund të tregojnë datën e lirit nga stacioni i xhandarmerisë. Këto tre mangësi dëshmojnë për mungesën e masave efektive për të mbrojtur nga rreziku i zhdukjes së personave në ndalim.¹⁸

Veç kësaj, në Raportin e përgjithshëm të 2-të KPT-ja deklaron:

KPT-ja konsideron se masat mbrojtëse themelore të dhëna personave në mbikëqyrje në polici do të përforcohen (dhe puna e punonjësve të policisë do të kishte mjaft gjasa të lehtësohej) në se do të mbahej një evidencë e vetme përmbledhëse për çdo person të ndaluar, ku do të regjistroheshin të gjitha aspektet e mbikëqyrjes së tij dhe veprimet e ndërmarra lidhur me të (kur ju hoq liria dhe arsyet për atë masë; kur ju thanë të drejtat; shenjat e dëmtimeve, sëmundjes mendore, etj.; kur u kontaktuan të afërmit/konsullata dhe avokati dhe kur u vizitua prej tyre; kur ju ofrua ushqim; kur u pyet; kur u transferua ose lirua etj.). Për çështje të ndryshme (p.sh. sendet që kish personi, fakti që ju thanë të drejtat e tij dhe në se i kërkoi ose hoqi dorë prej tyre), duhet të merret firma e të ndaluarit dhe, në se është e nevojshme, të shpjegohet mungesa e firmës. Për më tepër, avokati i të ndaluarit duhet të ketë qasje në evidencën e mbikëqyrjes.¹⁹

Në Raportin e përgjithshëm të 12-të KPT-ja njih se regjistrimi audio dhe video i dëgjimeve të personave të privuar nga liria e tyre nga ana e autoriteteve kompetente është një garanci e rëndësishme kundër keqtrajtimit të të burgosurve:

Regjistrimi elektronik (domethënë audio dhe/ose video) i dëgjimeve nga policia përfaqëson, për personat e ndaluar, një garanci plotësuese kundër keqtrajtimeve. KPT-ja vëren me kënaqësi që futja e sistemeve të tilla parashikohet në shumë vende. Sisteme të tilla mund të ofrojnë një përmbledhje të plotë dhe autentike të procesit të hetimit dhe kështu, të lehtësojë së tepërmi hetimet në rast pretendimesh për keqtrajtime. Kjo është si në interes të personave që janë keqtrajtuar nga policia

- 17 Çakici kundër Turqisë (nr. 23657/94), gjykimi i datës 8 korrik 1999 [Dhoma e Madhe], paragrafi 105.
- 18 Orhan kundër Turqisë (nr. 25656/94, gjykimi i datës 18 qershor 2002, paragrafi 372.
- 19 Raporti i përgjithshëm i 2-të mbi aktivitetet e KPS-së për periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor 1991 [CPT/Inf (92) 30], paragrafi 40.

ashtu dhe në atë të policisë që përballet me pretendime të pabazuara për keqtrajtime fizike ose presione psikologjike. Regjistrimi elektronik i dëgjimeve nga policia gjithashtu kufizon mundësinë, për personat nën shqyrtim, për të mohuar në mënyrë të rreme se ata kishin dhënë deklaratat të veçanta.²⁰

4. Shtetet duhet të sigurojnë që oficerët që kryejnë arrestimet apo marrjet në pyetje ose që përdorin forcë, të mund të identifikohen në hetimet dhe procedurat e mëvonshme penale ose disiplinore.

Në lidhje me praktikën e mbylljes së syve, KPT-ja deklaron në Raportin e përgjithshëm të 12-të:

Në disa Shtete, KPT-ja është gjendur përballë me praktikën e mbylljes së syve të personave të ndaluar nga policia, veçanërisht gjatë marrjes në pyetje. Delegacionet e KPT-së kanë dëgjuar disa shpjegime – shpesh kontradiktore – në lidhje me arsyen e kësaj praktike. Është e qartë për KPT-në, pasur parasysh informacionet e mbledhura gjatë viteve, që pothuaj në të shumtën e rasteve, personat i kanë sytë e lidhura për të shmangur identifikimin e forcave të rendit që i keqtrajtojnë. Edhe në rastet kur nuk ka keqtrajtime fizike, fakti i lidhjes së syve të një personi të ndaluar – dhe në veçanti një personi që është duke u pyetur – është një lloj shtypje efektet e së cilës tek personi do të shfaqen si një trajtim i keq psikologjik. Komiteti rekomandon që të ndalohet shprehimisht praktika që ka të bëjë me lidhjen e syve të personave të ndaluar nga policia.²¹

V. Detyra për të hetuar

1. Lufta kundër mosndëshkimit kërkon që të kryhet një hetim efektiv në rastet e shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut. Kjo detyrë ka karakter absolut.

E drejta për jetën (Neni 2 i Konventës)

Detyrimi për të mbrojtur të drejtën për jetën kërkon midis të tjerave që të kryhet një hetim efektiv kur individë janë vrarë, qoftë nga agentë shtetëror ose persona fizik, dhe në të gjitha rastet e vdekjeve të dyshimta. Ky detyrim gjithashtu lind në situata në të cilat është e paqartë nëse viktima ka vdekur apo jo, dhe ekziston arsye për të besuar se rrethanat janë të dyshimta, si në rastin e zhdukjeve të detyruara.

Detyrimi për të kryer një hetim efektiv është zhvilluar për herë të parë nga Gjykata në kuadër të Nenit 2 të Konventës duke rrjedhur nga çështja e McCann dhe të tjerëve kundër Mbretërisë së Bashkuar:

Detyra për të mbrojtur të drejtën e jetës sipas kësaj dispozite, e lexuar së bashku me detyrën e përgjithshme të shtetit sipas Nenit 1 të Konventës për të "siguruar për të gjithë brenda juridiksionit të tyre të drejtat dhe liritë e përcaktuara në [këtë] Konventë", kërkon si pasojë ekzistimin e disa formave të hetimit zyrtar efektiv kur individë janë vrarë si rezultat i përdorimit të nga ana e, midis të tjerëve, dhe agjentëve të shtetit.²²

20 Raporti i përgjithshëm i 12-të mbi aktivitetet e KPS-së për periudhën 1 Janar deri më 31 Dhjetor 2001 [CPT/Inf (2002) 15], paragrafi 36.

21 Raporti i përgjithshëm i 12-të mbi aktivitetet e KPS-së për periudhën 1 Janar deri më 31 Dhjetor 2001 [CPT/Inf (2002) 15], paragrafi 38.

22 McCann dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar (nr. 18984/91), gjykimi i datës 27 shtator 1995 [Dhoma e Madhe], paragrafi 161.

Gjykata ka deklaruar se detyra për të hetuar gjithashtu vlen edhe në lidhje me vrasjet nga ana e aktorëve privatë:

Gjykata konstaton, para së gjithash, se obligimi procedural u ngrit për të hetuar rrethanat e vdekjes së Kristofer Eduardsit (Christopher Edwards). Ai ishte një i burgosur që ndodhej nën kujdesin dhe përgjegjësinë e autoriteteve kur vdiq nga aktet e dhunës të një të burgosuri tjetër dhe në këtë situatë nuk ka rëndësi nëse agjentët e shtetit kanë qenë të përfshirë nga ushtrimi i veprimeve ose mosveprimeve në ngjarjet që çojnë në vdekjen e tij. Shteti kishte për detyrë të fillonte dhe të kryente një hetim i cili do t'i përmbushte kërkesat e përcaktuara më sipër.²³

Gjykata konstatoi se konteksti politik në kohën e incidenteve përkatëse nuk i çliron autoritetet nga detyrimet e tyre për të kryer një hetim efektiv:

Megjithatë, as përhapja e konflikteve të armatosura të dhunshme dhe as shpeshësia e rasteve të vdekjeve nuk mund të zhvendosin detyrimin që rrjedh nga Neni 2 për të siguruar kryerjen e një hetimi efektiv dhe të pavarur në rastet e vdekjeve që janë pasojë e përlëshjeve që përfshijnë forcat e sigurisë, aq më tepër në raste siç është rasti në fjalë kur rrethanat janë në shumë aspekte të paqarta.²⁴

Në kontekstin e përlëshjeve të armatosura të dhunshme, Gjykata gjithashtu përmendi rrezikun e zhvillimit të një klime mosndëshkueshmërie:

Megjithatë, rrethanat e kësaj natyre nuk mund të çlirojnë autoritetet nga detyrimet e tyre sipas Neni 2 për të kryer një hetim, pasi në të kundërtën kjo do të përkeqësonte edhe më shumë klimën e mosndëshkimit dhe pasigurisë në rajon dhe kështu do të krijojë një rreth vicioz (shihni mutatis mutandis, gjykimin e Kaya-s cituar më lart, f. 326, paragrafi 91).²⁵

Shihni gjithashtu nenet 2 dhe 3 të Konventës Ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukjet me Forcë e datës 20 dhjetor 2006:

Neni 2

Për qëllime të kësaj Konvente, me “zhdukje me forcë” do të kuptohet arrestimi, burgosja, rrëmbimi ose çdo formë tjetër heqjeje lirie nga agjentë të shtetit apo nga persona të tjerë a grupe personash, që veprojnë me autorizimin, mbështetjen ose miratimin e shtetit, pasuar nga mohimi i pranimit të heqjes së lirisë ose nga fshehja e fatit të personit të zhdukur a e vendit ku gjendet ai, duke e shkëputur nga mbrojtja e ligjit.

Neni 3

Çdo Shtet Palë merr masat e duhura për të hetuar mbi veprimet e përcaktuara në nenin 2, që janë vepër e personave a grupeve të personave, që veprojnë pa autorizimin, mbështetjen ose miratimin e shtetit dhe për t'i vënë përgjegjësit para drejtësisë.

Shihni gjithashtu “Parimet për parandalimin dhe hetimin efektiv të ekzekutimeve jashtëligjore, arbitrarë dhe përmbledhëse” (paragrafët 9-17), rekomanduar nga Rezoluta e Këshillit Ekonomik dhe Social 1989/65 e datës 24 maj 1989.

23 Paul dhe Audrey Edwards kundër Mbretësi së Bashkuar (nr. 46477/99) gjykimi I dates 14 mars 2002, paragrafi 74.

24 Kaya kundër Turqisë (nr. 158/96), gjykimi i datës 19 shkurt 1998, paragrafi 91.

25 Yaşa kundër Turqisë (nr. 22495/93), gjykimi i datës 2 shtator 1998, paragrafi 104.

Detyrimi për të hetuar qëndrimet raciste

Gjykata ka mbajtur qëndrimin se detyra e autoriteteve për të hetuar ekzistencën e një lidhje të mundshme midis qëndrimeve raciste dhe një akti dhune është një aspekt i detyrimeve procedurale që rrjedhin nga nenet 2 dhe 14 të Konventës:

Gjykata konsideron se kur hetohen incidente të dhunshme dhe, në veçanti, vdekje në duart e agjentëve të shtetit, autoritetet shtetërore kanë detyrë shtesë për të ndërmarrë të gjitha hapat e arsyeshëm për të demaskuar çdo motiv racist dhe për të vërtetuar në qoftë se urrejtja apo paragjykimet etnike mund të kenë luajtur ndonjë rol në këto ngjarje. Dështimi për të vepruar në këtë mënyrë dhe trajtimi i dhunës dhe brutalitetit të shkakuar nga racizmi në mënyrë të barabartë me rastet që nuk kanë elemente raciste është të mbyllësh sytë për natyrën specifike të akteve që janë veçanërisht shkatërrues për të drejtat themelore. Dështimi për të bërë një dallim të mënyrës në të cilën trajtohen situata që janë në thelb të ndryshme, mund të përbëjë trajtim një të pajustificuar i cili nuk është në pajtim me Nenin 14 të Konventës (shihni, *mutatis mutandis*, *Thlimmenos kundër Greqisë [GC]*, nr. 34369/97, paragrafi 44, GjEDNj 2000-IV). Për të ruajtur besimin e publikut në makinerinë e tyre për zbatimin e ligjit, shtetet kontraktuese duhet të sigurojnë që në hetimin e incidenteve, të cilët përfshijnë përdorimin e dhunës, të bëhet dallim si në sistemet e tyre ligjore, gjithashtu dhe në praktikën midis rasteve të përdorimit të tepruar të dhunës dhe vrasjeve me motive raciste.

Nuk ka dyshim që vërtetimi i motiveve raciste në praktikë do të jetë jashtëzakonisht i vështirë. Detyrimi i shtetit të paditur për të hetuar motive të mundshme raciste në një akt të dhunshëm është një detyrim për të bërë përpjekjet më të mira e jo absolute (shihni, *mutatis mutandis*, *Shan-aghan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 37715/97, paragrafi 90, GjEDNj 2001-III, përcakton të njëjtin standard në lidhje me detyrimin e përgjithshëm për të hetuar). Autoritetet duhet të bëjnë atë që është e arsyeshme në ato rrethana për të mbledhur dhe për të siguruar prova, të shqyrtojnë të gjitha mjetet praktike për zbulimin e së vërtetës dhe të japin vendime të arsyetuara plotësisht, të paanshme dhe objektive, pa përfshirë fakte të dyshimta që mund të jenë tregues të një dhune me motive raciste.²⁶

Ndalimi i torturës dhe trajtimit çnjerëzor ose poshtëruar ose ndëshkimit (Neni 3 i Konventës)

Shtetet kanë një detyrim procedural që rrjedh nga neni 3 i Konventës për të kryer një hetim efektiv për shkak të pretendimeve të besueshme që një person ka qenë i keqtrajtuar rëndë, ose kur autoritetet kanë arsye për të dyshuar se ka ndodhur një trajtim i tillë.

Menjëherë pasi zhvilloi detyrimin për të kryer një hetim efektiv sipas Nenit 2 të Konventës, Gjykata gjithashtu ndoqi këtë qasje në lidhje me Nenin 3 të Konventës:

Gjykata vlerëson se, në këto rrethana, kur një individ ngre një pretendim të argumentueshëm se ai është keqtrajtuar rëndë nga policia ose agjentë të tjerë të tillë të shtetit në mënyrë të paligjshme dhe në kundërshtim me Nenin 3, ajo dispozitë, e lexuar në lidhje me detyrën e përgjithshme të shtetit në bazë të Nenit 1 të Konventës për t'u "siguruar të gjithëve brenda juridiksionit të tij të drejtat dhe liritë e përcaktuara në ... [këtë] Konventë", kërkon shprehimisht që duhet të kryhet një hetim zyrtar efektiv. Ky hetim, siç është rasti edhe me atë në bazë të Nenit 2, duhet të jetë në gjendje të çojë në identifikimin dhe dënimin e personave përgjegjës (shihni, në lidhje me Nenin 2 të Konventës,

26 Nachova dhe të tjerë kundër Bullgarisë (nr. 43577/98 dhe 43579/98), gjykimi i datës 26 Shkurt 2004, paragrafët 158-159. Për sa i përket përgjegjësi në bazë të Nenit 14 të Konventës (lexuar në lidhje me Nenin 2 të Konventës), shihni Nachova dhe të tjerët kundër Bullgarisë (nr. 43577/98 dhe 43579/98), gjykimi i datës 6 Korrik 2005 [Dhoma e Madhe], paragrafi 161.

McCann dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar, gjykimi i datës 27 shtator 1995, Seria A nr. 324, f. 49, paragrafi 161, Kaya kundër Turqisë, gjykim i datës 19 Shkurt 1998, Raportet 1998-I, f. 324, paragrafi 86, dhe Yaşa kundër Turqisë, gjykim datës 2 Shtator 1998, Raportet 1998 -VI, p. 2438, paragrafi 98). Nëse ky nuk do të ishte rasti, ndalimi i përgjithshëm ligjor i torturës dhe trajtimit çnjerëzor dhe degradues dhe ndëshkimit, pavarësisht rëndësisë së tij themelore (shihni paragrafin 93 më lart), do të ishte i paefektshëm në praktikë dhe do të ishte e mundur në disa raste që agjentët e shtetit të abuzojnë me të drejtat e personave nën kontrollin e tyre thuajse pa u ndëshkuar.²⁷

Gjykata dha si arsytim për detyrimin pozitiv për të hetuar në mënyrë efektive rastet e dyshuara të keqtrajtimit serioz:

Në rastet e keqtrajtimit të qëllimshëm shkelja e Nenit 3 nuk mund të rregullohet vetëm me një dëmshpërblim të viktimës. Kjo për shkak se, në qoftë se autoritetet do të mund ta kufizojnë reagimin e tyre ndaj incidenteve të keqtrajtimit me paramendim nga agjentët e shtetit në pagesën e thjeshtë të kompensimit, ndërsa nuk janë përpjekur mjaftueshëm për të ndjekur penalisht dhe për të ndëshkuar ata që janë përgjegjës, kjo do të mundësonte në disa raste që agjentët e shtetit të abuzojnë me të drejtat e personave nën kontrollin e tyre thuajse pa u ndëshkuar, dhe si pasojë ndalimi i përgjithshëm ligjor i torturës dhe trajtimit çnjerëzor dhe poshtëruës, pavarësisht nga rëndësia e tij themelore, do të ishte i paefektshëm në praktikë (shihni, midis shumë autoriteteve të tjera, Krastanov, cituar më lart, paragrafi 60, Çamdereli, cituar më lart, paragrafi 29, dhe Vladimir Romanov, cituar më lart, paragrafi 78).²⁸

Ndalimi i skllavërisë dhe i punës së detyruar (Neni 4 i Konventës)

Ndalimi i skllavërisë dhe punës së detyruar përfshin një detyrim procedural për të kryer një hetim efektiv në situatat e trafikimit të mundshëm të qenieve njerëzore.

Gjykata konstatoi një detyrim procedural për të hetuar në bazë të Nenit 4 të Konventës në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore:

Si nenet 2 dhe 3, neni 4 gjithashtu përfshin një detyrim procedural për të hetuar situatat e trafikimit të mundshëm.²⁹

Detyra për të hetuar situata të trafikimit të qenieve njerëzore është përpunuar më tej në kreun V ("Hetimi, ndjekja penale dhe ligji procedural") të Konventës së Këshillit të Evropës mbi Veprimin kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore të datës 16 maj 2005.

E drejta për liri dhe siguri (Neni 5 i Konventës)

Masat mbrojtëse procedurale që rrjedhin ndër të tjera nga e drejta për liri dhe siguri kërkojnë që shtetet të kryejnë hetime efektive për pretendimet e besueshme që një personi i është hequr liria e tij ose e saj dhe nuk është parë që atëherë.

Në lidhje me zhdukjet me forcë, Neni 5 i Konventës vendos një detyrim procedural ndaj shteteve për të kryer një hetim efektiv:

Gjykata thekson në këtë drejtim se ndalimi i një individi i mbetur pa përgjigje është një mohim i plotë i këtyre garancive dhe është shkelja më e rëndë e Nenit 5. Duke ushtruar kontroll mbi atë indi-

- 27 Assenov dhe të tjerë kundër Bullgarisë (nr. 24760/94), gjykim i datës 28 Tetor 1998, paragrafi 102
- 28 Gäfgen kundër Gjermanisë (nr. 22978/05), gjykim i datës 1 qershor 2010 [Dhoma e Madhe], paragrafi 119
- 29 Rantsev kundër Qipros dhe Rusisë (nr. 25965/04), gjykim i datës 7 janar 2010, paragrafi 288

vid, është detyrë e autoriteteve të përgjigjen për vendndodhjen e tij ose të saj. Për këtë arsye, Neni 5 duhet të kuptohet në mënyrë që u kërkon autoriteteve të marrin masa efektive për të mbrojtur nga rreziku i zhdukjes dhe për të kryer një hetim të shpejtë efektiv në bazë të një pretendimi të argumentuar se një person është ndaluar dhe nuk është parë që atëherë.³⁰

E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare (Neni 8 i Konventës)

Shtetet kanë për detyrë të hetojnë në mënyrë efektive pretendime të besueshme për shkelje serioze të të drejtave të përfshira në Nenin 8 të Konventës, ku natyra dhe rëndësia e shkeljes së pretenduar kështu kërkon, në përputhje me praktikën e mëparshme të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Gjykata ka konstatuar se e drejta për një ankim efektiv (neni 13 i Konventës), mund të kërkojë shteteve të kryejë hetime efektive në lidhje me të drejtën për një jetë private (Neni 8 i Konventës):

Gjykata ripërsërit se neni 13 garanton disponueshmërinë në nivel kombëtar të një zgjidhjeje për të zbatuar thelbin e të drejtave dhe lirive të Konventës në çfarëdo forme që ato mund të paraqiten, të cilat sigurisht të jenë përfshirë në legjislacionin në të brendshëm. Veprimi i këtij neni është që në këtë mënyrë ai kërkon sigurimin e një zgjidhjeje të brendshme që i lejon "autoritetit kompetent kombëtar", si të merret me thelbin e ankesës përkatëse të Konventës, ashtu edhe të japë një ndihmë e duhur, edhe pse shteteve kontraktuese u janë dhënë disa liri veprimi për sa i përket mënyrës me të cilën ata përputhen me detyrimet e tyre në bazë kësaj dispozite. Zgjidhja duhet të jetë "efektive" si në praktikë, ashtu edhe në legjislacion, në mënyrë të veçantë në kuptimin që ushtrimi i saj nuk duhet të pengohet në mënyrë të pajustificueshme nga veprimet ose mosveprimet e autoriteteve të shtetit të paditur (shih vendimin Aksoy të cituar më sipër, f. 2286, §95, dhe gjykimi i lartpërmendur Aydın, f. 1895-1896, §103).

Më tej, natyra dhe serioziteti i ndërhyrjes që përputhet me dispozitën e nenit 8 të Konventës, ose në bazë të saj, në rastin konkret ka implikime për nenin 13. Dispozita imponon, që pa pasur par-agjykuar për ndonjë zgjidhje tjetër që është në dispozicion në sistemin e brendshëm, detyrimin e shtetit të paditur që të kryejë një hetim të plotë dhe efektiv të akuzave të paraqitura për shkatërrim të qëllimshëm të shtëpive dhe pronave të individëve nga agjentët e tij.

Kështu, kur një individ ka një pretendim të argumentuar se shtëpia dhe prona e tij ose e saj janë shkatërruar me qëllim nga agjentët e shtetit, nocioni i një 'zgjidhjeje efektive' nënkupton, përveç pagesës së kompensimit të dëmit, kur kjo është e përshtatshme, një hetimi të plotë dhe efektiv që ka mundësinë të çojë në identifikimin dhe ndëshkimin e personave përgjegjës dhe duke përfshirë qasje efektive të ankimesit në procedurën e hetimit.³¹

Përsa i përket përdhunimit, Gjykata deklaron:

Për këtë gjë, Gjykata konsideron që shtetet kanë një detyrim pozitiv që është pjesë e pandashme e neneve 3 dhe 8 të Konventës për të miratuar dispozita të Kodit Penal që dënojnë në mënyrë efektive përdhunimin dhe ti zbatojnë ato në praktikë nëpërmjet hetimeve dhe ndjekjeve penale efektive.³²

30 Kurt kundër Turqisë (nr. 24276/94), gjykim i datës 25 maj 1998, paragrafi 124; Orhan kundër Turqisë (nr. 25656/94), gjykim i datës 18 qershor 2002, paragrafi 369.

31 Mentés dhe të tjerë kundër Turqisë (nr.23186/94, vendimi gjyqësor i 28 Nëntorit 1997, paragrafi 89.

32 M.C. kundër Bullgarisë (nr.39272/98, vendimi gjyqësor i 4 Dhjetorit 2003, paragrafi 153.

2. Kur është bërë një pretendim i argumentuar, apo autoritetet kanë shkaqe të arsyeshme për të dyshuar se ka ndodhur një shkelje e rëndë të drejtave të njeriut, autoritetet duhet të fillojnë një hetim me iniciativën e tyre.

Gjykata ka përcaktuar detyrimin që kanë autoritetet e shtetit për të filluar një hetim motu proprio :

Qëllimi esencial i një hetimi të tillë është që të sigurojë zbatim efektiv të ligjeve vendase të cilat mbrojnë të drejtën e jetës dhe, në rastet që përfshijnë agjentë ose organe të shtetit, të sigurojë që ata të mbajnë përgjegjësi për vdekjet që ndodhin kur ata janë në detyrë. Forma e hetimit që do të zbatohet për të arritur këto qëllime do të i ndryshëm në varësi të rrethanave. Sidoqoftë, autoritetet duhet të veprojnë gjithmonë me detyrë zyrtare sapo çështja të ketë mbërritur tek ta, pavarësisht nga forma e ndërmarrë e hetimit.³³

Gjithashtu, hetimi mund të fillohet menjëherë (shih më poshtë, Udhëzimi VI)

3. Fakti që viktimi nuk dëshiron të paraqesë ankesë zyrtare, që më pas tërheq një ankesë të tillë ose që vendos të ndërpresë procedimin, nuk i liron autoritetet nga detyrimi i tyre për të kryer një hetim efektiv, në qoftë se ekziston arsye për të besuar se ka ndodhur një shkelje e rëndë e të drejtave të njeriut.

Sidoqoftë, autoritetet duhet të veprojnë gjithmonë me detyrë zyrtare sapo çështja të ketë mbërritur tek ta, pavarësisht nga forma e ndërmarrë e hetimit. Ato nuk mund të lënë atë në iniciativën e një të afërmi të personit, si për të paraqitur një ankesë formale, ashtu edhe për të mbajtur përgjegjësi për kryerjen e procedurave hetimore. (shiko, mutatis mutandis, Ilihan kundër Turqisë [GC], nr.22277/93, paragrafi 63, GjEDNj 2000-VII, dhe Finuance kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr.29178/95, paragrafi 67, GjEDNj 2003-VIII.³⁴

Kjo gjë zbatohet edhe në rastin kur viktimi më vonë tërheq ankimimin e tij ose të saj:
[...]

Gjykata në lidhje me këtë gjë ripërsërit që, sapo situata ka mbërritur tek ata, autoritetet shtetërore vendase nuk mund të varen nga qëndrimi i viktimës për të mos ndërmarrë masa të përshtatshme me të cilat të parandalojnë mundësinë e agresorit për të bërë kërcënimet e tij kundër integritetit fizik të viktimës (shih, Osman kundër Mbretërisë së Bashkuar, që përmendet më lart, paragrafi 116).
[...]

Lidhur me këtë, Qeveria bëri me faj ankimuesen për tërheqjen e ankimimit dhe për mosbashkëpunim me autoritetet, që parandaluan të lartpërmendurën për të vazhduar ndjekjen penale kundër H.O., në pajtim me dispozitat e legjislacionit vendas që kërkojnë përfshirje aktive të viktimës (shih, paragrafin 70 si më sipër).

Gjykata ripërsërit opinionin e saj në lidhje ankimimin sipas nenit 2, domethënë që kuadri ligjor duhet tu jepte mundësi organeve të ndjekjes për të zhvilluar hetime penale kundër H.O., edhe pse ankimuesja tërhoqi ankimimin, në bazë të asaj që dhuna e ushtruar nga H.O. ishte e mjaftueshme për të urdhëruar ndjekjen penale, dhe që kjo dhunë ishte kërcënim i vazhdueshëm për integritetin fizik të ankimueses. (shih, paragrafët 137-148 si më sipër).³⁵

- 33 Kelly dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar (nr.30054/96), vendimi gjyqësor i 4 Majit 2001, paragrafi 94.
- 34 Tashin Acar kundër Turqisë (nr.26307/95), vendimi gjyqësor i 8 Prillit 2004 [Dhoma e Madhe], paragrafi 221.
- 35 Opuz kundër Turqisë (nr.33401/02), vendimi gjyqësor i 9 Qershorit 2009, paragrafët 153, 167-168.

1. Vendimi për të refuzuar fillimin ose përfundimin e hetimeve mund të merret vetëm nga një autoritet i pavarur dhe kompetent, në përputhje me kriteret e një hetimi efektiv siç përcaktohet në Udhëzimin VI. Ato duhet të jenë të arsyetuara në mënyrë të rregullt.
2. Vendime të tilla duhet të jenë subjekt i shqyrtimit të duhur dhe të jenë në përgjithësi të diskutueshme nëpërmjet një procesi gjyqësor.

Gjykata deklaron:

[...] Komisioni ka vrotuar me tej se vendimet e autoriteteve kombëtare që i janë dërguar, nuk përbajnë arsyetime të hollësishme për hedhjen poshtë të ankimeve të prindërve të ankimesues. Më tej është vënë re se kanë munguar plotësisht shënimet e asaj kohe të cilat mund të tregojnë, hap pas hapi, natyrën e hetimeve të kryera për akuzat dhe rezultoni që asnjë autoritet i jashtëm nuk është përfshirë në këto hetime. Në këto rrethana, Komisioni nxori përfundimin se hetimet kanë qenë të përcipta dhe sa për formë dhe nuk pasqyrojnë asnjë përpjekje serioze për të zbardhur se çfarë ndodhi në burg në Shator të vitit 1998.

N dritën e shqyrtimeve të veta të materialit të parashtruar, Gjykata pranon konstatimet dhe arsyetimin e Komisionit dhe nxjerr përfundimin që pretendimi i argumentuar i ankimesit që ishte keqtrajtuar në burg nuk ishte objekt i një hetimi efektiv nga ana e autoriteteve vendase, siç e kërkon neni 3 i Konventës.³⁶

VI. Kriteret për një hetim efektiv

Me qëllim që një hetim të jetë efektiv, ai duhet të respektojë kërkesat e mëposhtme themelore:

Përshtatshmëria

Hetimi duhet të jetë në gjendje të çojë në identifikimin dhe dënimin e atyre që janë përgjegjës. Kjo nuk krijon një detyrim për shtetet që të sigurojnë që hetimi të shpjerë në një rezultat të caktuar, por autoritetet duhet të kenë marrë hapat e arsyeshme në dispozicionin e tyre për të siguruar dëshmi lidhur me incidentin.

Gjykata e përcakton përshtatshmërinë e hetimeve si më poshtë:

Për të qenë "efektiv", term që duhet kuptuar si në kontekstin e nenit 2 të Konventës, një hetim për një vdekje që përfshin përgjegjësinë e një Pale Kontraktuale sipas këtij neni duhet të jetë fillimisht i përshtatshëm. Kjo do të thotë, që hetimi duhet të jetë i aftë për të çuar në identifikimin dhe dënimin e atyre që janë përgjegjës. Kjo nuk përbën detyrim për rezultatet e tij, por është një nga mjetet. Autoritetet duhet të ndër marrin hapat e arsyeshme që kanë në dispozicion të tyre për të siguruar dëshmi lidhur me incidentin. Çdo mungesë në hetim që minon aftësinë e tij për të identifikuar autorin ose autorët do të rrezikojë moszbatimin e këtij standardi (cf Tahsin Acar kundër Turqisë [GC], nr26307/95, paragrafi 223, GJEDNJ 2004-III).³⁷

36 Polotratskiy kundër Ukrainës (nr.38812/97), vendimi gjyqësor i 29 Prillit 2003, paragrafët 126-127.

37 Ramsahai dhe të tjerë kundër Hollandës (nr.24746/94, vendimi gjyqësor i 15 Majit 2007 [Dhoma e Madhe], paragrafi 324.

Për më tepër, në Raportin e përgjithshëm të 14 të Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës (KPT) theksoi se hetimi duhet të jetë gjithëpërfshirës:

Hetimi duhet gjithashtu të zhvillohet në një mënyrë gjithëpërfshirëse. KPT duke këqyrur çështjet, në dritën e shumë incidenteve dhe fakteve të supozuara që lidhem me keqtrajtim të mundshëm, qëllimi i hetimit është përcaktuar gabimisht, si dhe që ngjarje të rëndësishme dhe rrethana që tregojnë qartë për keqtrajtme janë lënë pas dore.³⁸

Përpikmëria

Hetimi duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe të adresojë të gjitha rrethanat përkatëse në prapavijë, duke përfshirë çdo motivim racist apo diskriminues. Ai duhet të jetë i aftë për të identifikuar çdo dështim sistematik që shpie në shkelje. Kjo kërkon marrjen e të gjitha hapave të arsyeshme për të siguruar prova relevante të tilla si identifikimi dhe marrja në intervistë e viktimave të supozuara, të dyshuarve dhe dëshmitarëve; ekzaminimi i vendit së shkeljes së supozuar për prova materiale; dhe mbledhja e provave të ekspertizës dhe ato mjekësore nga specialistët kompetentë. Provat duhet të vlerësohen në mënyrë të plotë, të qëndrueshme dhe objektive.

Gjykata ka përshkruar kërkesën e “Përpikmërisë” si më poshtë:

Autoritetet duhet të ndërmarrin hapat e arsyeshme që kanë në dispozicion të tyre për të siguruar dëshmitë lidhur me incidentin, duke përfshirë inter alia dëshmitë okulare, dëshmi ekspertize dhe, kur është e mundur, autopsi e cila ofron një shënim të plotë dhe të saktë të dëmtimeve dhe një analizë objektive e konstatimeve klinike, duke përfshirë arsyen e vdekjes (shih, që ju përkasin autopsive, p.sh. Salman kundër Turqisë i cituar më lart, paragrafi 106; që përfshijnë dëshmitarë p.sh. Tarikulu kundër Turqisë [GC], nr.23763/94. GJEDNJ 1999-IV, paragrafi 109; që përfshijnë dëshmi ekspertize p.sh. Gül kundër Turqisë, nr.22676/93, [Seksioni 4], paragrafi 89). Çdo mangësi në hetim që minon aftësinë e tij për të përcaktuar shkaqet e vdekjes ose të personit ose personave përgjegjës do të rrezikojë moszbatimin e këtij standardi.³⁹

Për më tepër, në Raportin e përgjithshëm të 14 të KPT-së theksoi se:

Hetimi për një keqtrajtim të mundshëm nga ana e zyrtarëve të shtetit duhet të përputhet me kriterin e përpikmërisë. Ai duhet të jetë i aftë për të çuar në përcaktimin nëse forca ose metodat e tjera të përdorura ishin ose nuk ishin të justifikuara në ato rrethana, dhe tek identifikimi dhe, nëse është e mundur, tek ndëshkimi i atyre që janë të përfshirë në të. Kjo nuk përbën detyrim për rezultatet e tij, por është një nga mjetet. Kjo gjë kërkon që të të ndërmerren gjitha hapat e arsyeshëm për të siguruar dëshmi që lidhen me incidentin, duke përfshirë, inter alia, për të identifikuar dhe marrë në pyetje viktimat e supozuara, të dyshuarit dhe dëshmitarët okularë (p.sh. oficerët e policisë që ishin me detyrë, të ndaluar të tjerë), të sekuestrojnë mjetet që mund të jenë përdorur për keqtrajtimin, si dhe të mbledhë dëshmi ekspertësh. Ku është e mundur, duhet të bëhet autopsi e cila ofron një shënim të plotë dhe të saktë të dëmtimeve dhe një analizë objektive e konstatimeve klinike, duke përfshirë arsyen e vdekjes. [...]”⁴⁰

38 Raporti i përgjithshëm i 14 për punën e KPT-së, që mbulon periudhën nga 1 Gushti 2003 deri në 31 Korrik 2004 [KPT/Inf (2004) 28], paragrafi 33.

39 Hugh Jordan kundër Mbretërisë së Bashkuar (nr.24746/94), vendimi gjyqësor i 4 Majit 2001, Paragrafi 107.

40 Raporti i përgjithshëm i 14 për punën e KPT-së, që mbulon periudhën nga 1 Gushti 2003 deri në 31 Korrik 2004 [KPT/Inf (2004) 28], paragrafi 33.

Paanshmëria dhe pavarësia

Personat përgjegjës për kryerjen e hetimit duhet të jenë të paanshëm dhe të pavarur nga personat e përfshirë në ngjarjet. Kjo kërkon që autoritetet të cilat janë të përfshira në ngjarjet nuk mund të kryejnë marrjen e provave dhe as hetimet paraprake; në veçanti, hetuesit nuk mund të jenë pjesë e së njëjtës njësi si zyrtarët të cilët janë objekt i hetimit.

Gjykata deklaron:

Që një hetim i një vrasjeje të supozuar të paligjshme të agjentëve të shtetit të jetë efektiv, personat përgjegjës për zhvillimin e hetimit duhet të jenë të paanshëm dhe të pavarur, si ligjërisht ashtu edhe në praktikë. (shih, Güleç kundër Turqisë, vendimi gjyqësor i 27 Korrikut 1998, Raportet 1998-IV, paragrafi 1733, paragrafët 81-82; Oğur kundër Turqisë [GC], nr. 21594/93, paragrafët 91-92, GJEDNJ 1999-III; dhe Ergi kundër Turqisë, vendimi gjyqësor i 28 Korrikut 1998, Raportet 1998-IV, paragrafët 1778-79, paragrafët 83-84).⁴¹

Ky princip është përpunuar më tej nga Gjykata:

Ajo ripërsërit atë, që një hetim mbi faktet e një vrasjeje ose keqtrajtimi të supozuar nga ana e agjentëve të shtetit të jetë efektiv, është e nevojshme në përgjithësi që personat përgjegjës për hetimin dhe ata që zhvillojnë hetimin të jenë të pavarur nga ata që janë të përfshirë në këto ngjarje (shih, për shembull, vendimin gjyqësor Güleç kundër Turqisë, i 27 Korrikut 1998, Raportet 1998-IV, paragrafët 81-82; Oğur kundër Turqisë [GC], nr. 21594/93, GJEDNJ 1999-III, paragrafët 91-92). Kjo kërkon jo vetëm që të eliminohen të gjitha hierarkitë ose lidhjet institucionale, por gjithashtu edhe pavarësinë në praktikë (shih, për shembull, vendimin gjyqësor Ergi kundër Turqisë, i 28 Korrikut 1998, Raportet 1998-IV, paragrafët 1778-79, paragrafët 83-84; dhe Kelly dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr.30054/96, paragrafi 114, i 4 Majit 2001).⁴²

Shembujt në të cilët Gjykata ka gjetur që një hetim nuk ka qenë i paanshëm dhe i pavarur:

- hetimi ishte kryer nga kolegët e afërt të personave të cilët supozoheshin së ishin të përfshirë (shiko, Aktaş kundër Turqisë (nr.24351/94, vendimi gjyqësor i 24 Prillit 2003, paragrafi 301);
- hetimi për thëniet e një të burgosuri ishte kryer nga autoritetet e burgut pa përfshirjen e ndonjë autoriteti ose organi të jashtëm (shiko, Kuznetsov kundër Ukrainës (nr.39042/97), vendimi gjyqësor i 29 prillit 2003, Paragrafi 106);
- një hetim i zhvilluar nga prokurorët ushtarakë të cilët, në kuptimin e rregulloreve në fuqi, ishin pjesë e të njëjtës strukturë si policia (shih, Anghelesku kundër Rumanisë (nr.46430/99), vendimi gjyqësor i 5 Tetorit 2004, paragrafi 67 (i disponueshëm vetëm në Frëngjisht);
- pjesë thelbësore të një hetimi ishin kryer nga e njëjta njësi pjesëtare të të cilës ishin autorët e supozuar dhe që vepronin në zinxhirin e komandave të saj (shih, Ramsahai dhe të tjerë kundër Hollandës (nr.24746/94, vendimi gjyqësor i 15 Majit 2007 [Dhoma e madhe], paragrafi 406).

Për më tepër, në Raportin e përgjithshëm të 14 të KPT-së thuhet:

Që një hetim për një keqtrajtimit të mundshëm të jetë efektiv, është thelbësore që personat përgjegjës për kryerjen e tij të jenë të pavarur nga ata që janë të përfshirë në këto ngjarje. Në disa legjisla-cione, të gjitha ankimmimet për keqtrajtime të bëra kundër policisë ose zyrtarëve të tjerë të shtetit

41 Nachova e të tjerë kundër Bullgarisë (nr.s. 43577/98 dhe 43579/98), vendimi gjyqësor i 6 Korrikut 2005 [Dhoma e Madhe], paragrafi 112.

42 Bursuc kundër Rumanisë (nr.42066/98), vendimi gjyqësor i 12 Tetorit 2004, paragrafi 103 (në dispozicion vetëm në gjuhën Franceze: përkthim jozyrtar është ofruar nga ana e Sekretariatit).

duhet ti dorëzohet një prokurori, dhe është ky – pra jo policia – i cili përcakton nëse duhet të hapet një hetim paraprak për një ankimim; KPT-ja e mirëpret një qasje të tillë. Megjithatë, nuk është e pazakontë për përgjegjësinë e përditshme zhvillimit operativ të një hetimi tu kalohet zyrtarëve që janë në shërbim të zbatimit të ligjit. Përfshirja e prokurorit është tashmë e kufizuar në dhënien e instruksioneve për këta zyrtarë se si të kryejnë hetimet, në marrjen e njoftimeve për rezultatet, dhe për të përcaktuar nëse duhet ngritur padi penale ose jo. Është e rëndësishme të sigurohet që zyrtarët që zhvillojnë hetimin nuk janë në të njëjtin shërbim me zyrtarët që janë objekt i hetimit. Në mënyrë ideale, atyre që ju është besuar zhvillimi operativ i hetimit duhet të jenë plotësisht të pavarur nga agjencia e përfshirë. Për më tepër, autoritetet e prokurorisë duhet të ushtrorjnë mbikëqyrje efektive nga afër të zhvillimit operativ të hetimit për një keqtrajtim të mundshëm nga ana e zyrtarëve të shtetit. Atyre duhet tu jepen instruksione të qarta e po ashtu edhe mënyrat se si duhet ti mbikëqyrin hetime të tilla.⁴³

Gatishmëria

Hetimi duhet të fillohet me gatishmërinë e mjaftueshme me qëllim që të arrihet sasia dhe cilësia më e mirë e mundshme e dëshmive në dispozicion. Edhe pse mund të ketë pengesa apo vështirësi të cilat parandalojnë avancimin në një hetim në një situatë të veçantë, një përgjigje e shpejtë nga autoritetet mund, në përgjithësi, të konsiderohet si thelbësore në ruajtjen e besimit të publikut, në ruajtjen e sundimit të ligjit si dhe në parandalimin e shfaqjes së çdo marrëveshjeje të fshehtë për tolerimin e akteve të paligjshme. Hetimi duhet të përfundojë brenda një kohe të arsyeshme dhe, në të gjitha rastet, të bëhet me gjithë kujdesin e nevojshëm.

Gjykata konstaton:

Hetimi duhet të jetë efektiv në atë kuptim që të jetë i aftë për të çuar në identifikimin dhe ndëshkrimin e personave përgjegjës (shih, Oğur kundër Turqisë [GC], nr. 21594/93, paragrafi 88, 2GJEDNJ 1999-III). Çdo mangësi në hetim që minon aftësinë e tij për të përcaktuar shkaqet e vdekjes ose të personit ose personave përgjegjës do të rrezikojë moszbatimin e këtij standardi. Në këtë kontekst, duhet gjithashtu të ekzistojë një kërkesë e fortë për gatishmëri dhe kryerje brenda një afati të arsyeshëm (shih, Yaşa kundër Turqisë, vendimi gjyqësor i 2 Shtatorit 1998, Raportet 1998-IV, paragrafët 102-104; dhe Mahmut Kaya kundër Turqisë, nr.22535/93, GJEDNJ 2000-III, paragrafët 106-107). Duhet të pranojmë se mund të ketë pengesa ose vështirësi të cilat parandalojnë avancimin në një hetim në një situatë të veçantë. Sidoqoftë, një përgjigje e shpejtë nga autoritetet që bëjnë hetimin e përdorimit të dhunës vdekjeprurëse mund të konsiderohet, në përgjithësi, si thelbësore në ruajtjen e besimit të publikut, në ruajtjen e sundimit të ligjit si dhe në parandalimin e shfaqjes së çdo marrëveshjeje të fshehtë për tolerimin e akteve të paligjshme.⁴⁴

Për më tepër, në Raportin e përgjithshëm të 14 të KPT-së thuhet:

Që një hetim të jetë efektiv, ai duhet të zhvillohet menjëherë dhe të kryhet brenda një kohe të arsyeshme. KPT-ja ka konstatuar raste ku veprimet e domosdoshme hetimore janë shtyrë në mënyrë të pakuptueshme, ose organet e prokurorisë e ato gjyqësore në mënyrë të dukshme nuk kanë treguar vullnetin e duhur për të shfrytëzuar mjetet ligjore që kanë në dispozicion për të reaguar ndaj akuzave ose informacioneve të rëndësishme që tregojnë për keqtrajtim. Hetimet për këtë gjë janë pezulluar pa afat ose janë hedhur poshtë, dhe të gjithë zyrtarët e zbatimit të ligjit të cilët kanë qenë të përfshirë kanë arritur që ti shpëtojnë përgjegjësisë penale. Me fjalë të tjera, mos reagimi për të marrë provat bindëse për veprime shumë të këqija ka çuar në një "hetim" që nuk e meriton të quhet i tillë.⁴⁵

43 Raporti i përgjithshëm i 14 për punën e KPT-së, që mbulon periudhën nga 1 Gushti 2003 deri në 31 Korrik 2004 [KPT/Inf (2004) 28], paragrafi 32.

44 Kukayev kundër Rusisë (nr.29361/02. Vendimi gjyqësor i 15 Nëntorit 2007, paragrafi 95.

45 Raporti i përgjithshëm i 14 për punën e KPT-së, që mbulon periudhën nga 1 Gushti 2003 deri në

Mbikëqyrje publike

Duhet të ekzistojë një element i mjaftueshëm i mbikëqyrjes publike mbi hetimin ose rezultatet e tij për të siguruar përgjegjësi, për të ruajtur besimin e publikut në respektimin e sundimit të ligjit nga ana e autoriteteve dhe për të parandaluar çdo shfaqje të marrëveshjeve të fshehta për aktet e paligjshme ose tolerancën e tyre. Mbikëqyrja publike nuk duhet të rrezikojë qëllimet e hetimit dhe të drejtat themelore të palëve.

Në lidhje me përfshirjen e viktimës, Gjykata thotë:

Niveli i mbikëqyrjes publike të kërkuar mund të jetë i ndryshëm nga rasti në rast. Megjithatë, në të gjitha rastet të afërm të viktimës duhet të përfshihen në procedurë në nivelin e nevojshëm për të mbrojtur interesat e ligjshme të tij ose të saj (shih, Güleç, i përmendur më lart, paragrafi 1733, paragrafi 82, ku babai i viktimës nuk ishte informuar për vendimin e mos vazhdimit të procedimit; Oğur, i përmendur më lart, paragrafi 92, ku familja e viktimës nuk pati mundësi qasjeje në hetime dhe në dokumentet gjyqësore; dhe Gül, i përmendur më lart, paragrafi 93).⁴⁶

Për më tepër, në Raportin e përgjithshëm të 14 të KPT thuhet:

Në shtesë të kriterit të lartpërmendur për një hetim efektiv, e kjo për të siguruar përgjegjshmërinë si në praktikë ashtu edhe në teori, duhet të ekzistojë elementi i një mbikëqyrjeje publike të mjaftueshme të hetimit ose të rezultateve të tij. Niveli i mbikëqyrjes publike të kërkuar mund të jetë i ndryshëm nga rasti në rast. Në të gjitha rastet, viktimë (ose, në bazë të llojit të çështjes, i afërmi i viktimës) duhet të përfshihet në procedurë në masën e nevojshme për të mbrojtur interesat e ligjshme të tij ose të saj.⁴⁷

Shih gjithashtu "Principet e parandalimit dhe hetimit efektiv të ekzekutimeve të jashtëligjshme, arbitrarë dhe pa gjyq" (paragrafët 16-17), të rekomanduara nga Rezoluta e Këshillit Ekonomik dhe Social të Kombeve të Bashkuara 1989/65 datë 24 Maj 1989.

VII. Përfshirja e viktimave në hetim

1. Shtetet duhet të sigurojnë që viktimat të kenë mundësi të marrin pjesë në hetim dhe në procedura deri në masën e nevojshme për të mbrojtur interesat e tyre legjitime nëpërmjet procedurave përkatëse sipas ligjit kombëtar.

Në lidhje me pjesëmarrjen e viktimave Gjykata deklaron:

Gjykata ripërsërit që natyra e të drejtave që mbrohen me nenin 3 ka implikime për nenin 13. Kur një individ ka një pretendim të argumentuar që e kanë torturuar ose ka qenë objekt i një keqtrajtimit të rëndë nga ana e agjentëve të shtetit, nocioni i "ilaçit të përshtatshëm" kërkon në vazhdim, pagim dëmshpërblimi, kur ky është i përshtatshëm, dhe kjo nëpërmjet një hetimi efektiv të aftë për të çuar në identifikimin dhe ndëshkimin e personave përgjegjës, duke përfshirë qasje efektive të ankimesit në procedurën hetimore (shih citimin e më sipërm të vendimit gjyqësor Aksoy, paragrafi 98).⁴⁸

31 Korrik 2004 [KPT/Inf (2004) 28], paragrafi 35.

46 McKerr kundër Mbretësisë së Bashkuar (nr.28883/95, vendimi gjyqësor i 4 majit 2001, paragrafi 115.

47 Raporti i përgjithshëm i 14 për punën e KPT-së, që mbulon periudhën nga 1 Gushti 2003 deri në 31 Korrik 2004 [KPT/Inf (2004) 28], paragrafi 36.

48 Yaman kundër Turqisë (nr.32446/96, vendimi gjyqësor i 2 Nëntorit 2004, paragrafi 53 [theksim

Këtë gjë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut e përcakton në "Setin e principeve për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut nëpërmjet veprimeve për të luftuar mosndëshkueshmërinë" të 8 Shkurtit 2005, me Principin 4 ("E drejta e viktimës për të ditur"):

Pavarësisht nga çdo lloj procedimi ligjor, viktimat dhe familjet e tyre kanë të drejtën ligjore që nuk parashkruhet asnjëherë për të mësuar të vërtetën për rrethanat në të cilat u bë keqtrajtimi, dhe në rast vdekjeje ose zhdukjeje, fatin e viktimës.

Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në "Principet dhe Udhëzimet për të Drejtën e Kompensimit dhe të Riparimit për Viktimat e Shkeljeve të Mëdha të Ligjit Ndërkombëtar të të Drejtave të Njeriut dhe të e Shkeljeve të Rënda të Ligjit Humanitar Ndërkombëtar", e përcakton me Principin 24:

Gjithashtu, viktimave dhe përfaqësuesve të tyre duhet tu jepet e drejta për të kërkuar dhe marrë informacione për shkaqet që çuan në viktimizimin e tyre dhe në shkaqet dhe kushtet që kanë të bëjnë me shkeljet e mëdha të Ligjit ndërkombëtar të të drejtave të njeriut dhe të e shkeljeve të rënda të ligjit ndërkombëtar për humanizmin dhe për të mësuar të vërtetën në lidhje me këto shkelje.

1. Shtetet duhet të sigurojnë që viktimat të kenë mundësi që, në masën e nevojshme për të mbrojtur interesat e tyre legjitime, të marrin informacione në lidhje me vijueshmërinë dhe rezultatin e ankesave të tyre, progresin e hetimit dhe të ndjekjes penale, ekzekutimin e vendimeve gjyqësore dhe të gjitha masat e marra në lidhje me dëmshpërblimin për dëmet e shkaktuara ndaj viktimave.

Në lidhje me të drejtën për të marrë informacione në procedimet penale, Vendimi Kuadër i Këshillit të Evropës së Bashkuar i 15 marsit 2001 për pozicionin e viktimave në procedimet penale (2001/220/JHA) në nenin 4 thotë:

2. Çdo shtet anëtar duhet të sigurojë që viktimat që kanë shprehur dëshirën për këtë gjë të informohen për:
 - (a) rezultatet e ankimimit të tyre;
 - (b) faktorët e rëndësishëm që u japin të drejtën atyre, në rast ndjekjeje penale, të marrin dijeni për zhvillimin e procedimit penal në lidhje me personin në ndjekje për shkeljet në lidhje me ta, përveç rasteve të jashtëzakonshme kur në menaxhimin e rregullt të çështjes mund të ndikohet negativisht.
 - (c) vendimin gjyqësor.

3. Në rastet e vdekjeve të dyshimta ose rrëmbimeve të dhunshme, shtetet duhet, deri në masën e mundur, të sigurojnë informacione për familjen e tij ose të saj në lidhje me fatin e personit në fjalë.

Në nenin 24 të Konventës ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Gjithë Personave të Zhdukur me Dhunë thuhet që:

1. Për qëllime të Konventës, "viktimë" quhet personi i zhdukur dhe çdo individ që i është shkaktuar dëmtim si rezultat i drejtpërdrejtë i zhdukjes së dhunshme.
2. Çdo viktimë ka të drejtë të mësojë të vërtetën në lidhje me rrethana e zhdukjes së dhunshme, zhvillimin dhe rezultatin e hetimeve dhe fatin e personit të zhdukur. Çdo shtet si palë duhet të ndër marrë masat e duhura në lidhje me këtë gjë.

3. Çdo shtet palë duhet të ndërmarrë masat e duhura për të kërkuar, lokalizojë dhe çlirojë personat e zhdukur dhe, në rast vdekjeje, të lokalizojë, nderojë dhe kthejë kufomat e tyre.

4. Viktimave mund tu jepet mundësia që të thonë se ata nuk dëshirojnë të marrin një informacion të tillë.
5. Atje ku legjislacioni i brendshëm parashikon pjesëmarrjen si palë në procedurë, shtetet duhet të sigurojnë që viktimës ti ofrohet ndihma dhe këshillat e duhura juridike publike, aq sa është e nevojshme për pjesëmarrjen e tyre në procedurë.

Deklarata e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara për Principet Bazë të Drejtësisë për Viktimat e Krimeve dhe Abuzimeve të Pushtetit të 19 Nëntorit 1985, thuhet:

Përgjegjshmëria e proceseve juridike dhe administrative ndaj kërkesave të viktimave duhet të lehtësohet me anë të:

- (c) Ofrimit të ndihmës së duhur për viktimat nëpërmjet procesit ligjor;
- (d) Marrjes së masave për të minimizuar pakënaqësitë e viktimave, mbrojtur intimitetin e tyre, kur kjo gjë është e nevojshme, dhe të sigurojnë mbrojtjen e tyre, si dhe për shkak të tyre të mbrojnë familjet e tyre dhe dëshmitarët nga frikësimi dhe veprimet hakmarrëse; [...]

6. Shtetet duhet të sigurojnë që, në të gjitha fazat e procedurës kur ekziston nevoja, të merren masa mbrojtëse për integritetin fizik dhe psikik të viktimave dhe dëshmitarëve. Shtetet duhet të sigurojnë që viktimat dhe dëshmitarët të mos jenë të frikësuar, subjekte të përndjekjes ose të dekurajuar me mjete të tjera për të bërë ankimim ose për të ndjekur ankesën ose për të marrë pjesë në procedurat gjyqësore. Këto masa mund të përfshijnë mjete të veçanta të hetimit, mbrojtje dhe asistencë para, gjatë ose pas procesit hetimor, për të garantuar sigurinë dhe dinjitetin e personave në fjalë.

Për pjesëmarrjen e viktimave, shih gjithashtu Rekomandimet e Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare të Këshillit të Evropës të 14 Qershorit 2006, për asistencën që u jepet viktimave:

6. Informacioni

Ofrimi i informacionit

- 6.1. Shtetet duhet të sigurojnë që viktimat të kenë qasje ndaj informacioneve të rëndësishme për çështjen e tyre dhe të nevojshme për të mbrojtur interesat e tyre, si dhe për të ushtruar të drejtat e tyre.
- 6.2. Ky informacion duhet të ofrohet sa më parë kur viktima vjen në kontakt me organet e zbatimit të ligjit ose të drejtës penale, ose me shërbimet sociale dhe të mbrojtje së shëndetit. Ai duhet të komunikohet si gojarisht, ashtu edhe me shkrim, dhe në rast se është e mundëshme, në një gjuhë që e kupton viktima.

Përmbajtja e informacionit

- 6.3. Të gjitha viktimat duhet të informohen për shërbimet ose organizatat që mund të ofrojnë ndihmë dhe për tipin e saj, e kur duhet, edhe me shpenzimet e mbështetjes.
- 6.4. Kur raportohet një shkelje tek agjencitë e zbatimit të ligjit dhe të drejtës penale, informacioni që i ofrohet viktimës, si minimum, gjithashtu duhet të përfshijë:
 - i. procedurat që do të ndiqen dhe rolin e viktimës në këto procedura;
 - ii. si dhe në ç'rrethana viktima mund të përfitojë mbrojtje;
 - iii. si dhe në ç'rrethana viktima mund të përfitojë dëmshpërblim nga autori i veprës;
 - iv. disponibiliteti dhe, kur duhet, me shpenzimet për:
 - konsulencë ligjore,

- ndihmë ligjore, ose
- çdo lloj tjetër konsulence;
- v. si të bëjë kërkesë për dëmshpërblim nga shteti, nëse është e mundëshme;
- vi. nëse viktimat është me banim në një shtet tjetër, çdo mbështetje që do të ndihmonte në mbrojtjen e interesave të tij ose të saj.

Informacioni për procedimin ligjor

- 6.5. Shtetet duhet të sigurojnë në mënyrë të përshtatshme që viktimat të mbahen të informuar dhe të kuptojnë:
- rezultatin e ankimimit të tyre;
 - fazat kryesore të zhvillimit të procedimeve penale;
 - vendimin e Gjykatës kompetente dhe, kur duhet, edhe vendimin penal
- Viktimave u duhet dhënë mundësia për të deklaruar që ata nuk duan të marrin informacione të tilla. [...]

10. Mbrojtja

Mbrojtja e integritetit fizik dhe psikologjik

- 10.1. Shtetet duhet të sigurojnë në të gjitha fazat e procedurës, mbrojtjen e integritetit fizik dhe psikologjik të viktimës. Për viktimat të cilave ju kërkohet që të dëshmojnë mund të kërkohet mbrojtje e veçantë.
- 10.2. Masa mbrojtëse speciale mund të ndërmerren për viktimat që janë nën rrezikun e frikësimit, represalies ose të përsëritjes së viktimizimit.
- 10.3. Shtetet duhet të ndërmarrin masat e nevojshme për të siguruar, të paktën në rastet që mund të jenë të rrezikshme për viktimat, kur personi i akuzuar ose i dënuar për një veprë është li-ruar, që të mund të merret një vendim për të njoftuar viktimat në rast se është e nevojshme.
- 10.4. Në rast se shteti jep me iniciativën e vet informacionin e përmendur në paragrafin 10.3., ai duhet të sigurojë që viktimat kanë të drejtë të zgjedhin të mos e marrin informacionin, dhe komunikimi i lartpërmendur është i detyrueshëm në bazë të procedimeve penale në fjalë.

VIII. Ndjekjet penale

3. Shtetet kanë detyrim që të ndjekin penalisht kur rezultati i hetimit e bën të domosdoshme këtë. Edhe pse nuk ekziston e drejta e cila garanton ndjekjen penale ose dënimin e një personi të caktuar, prokurori duhet që, aty ku faktet e bëjnë të domosdoshme këtë, të marrë hapat e nevojshme për të sjellë ata që kanë kryer shkelje të rënda të të drejtave të njeriut para drejtësisë.

Për këtë gjë Gjykata deklaron:

Nuk do të ndërhyhet në asnjë mënyrë për këtë që thuhet më lart që neni 2 mund të japë të drejtën që një ankimues të ndjekë penalisht ose të dënojë të tretët për veprë penale (shih, mutatis mutandis, Perez kundër Francës [GC], nr.47287/99, paragrafi 70, GJEDNJ 2004-I) ose një detyrim absolut që të gjitha ndjekjet penale të përfundojnë me dënim, ose me një vendim gjyqësor penal të përcaktuar (shih, mutatis mutandis, Tanli kundër Turqisë, nr.26129/95, paragrafi 111, GJEDNJ 2001-III). Nga ana tjetër, Gjykatat kombëtare në asnjë rast nuk duhet të jenë të përgatitura që të lejojnë që krime kundër jetës të mos ndëshkohen. Kjo është thelbësore në ruajtjen e besimit të publikut dhe për të siguruar përputhjen me zbatimin e ligjit dhe për të parandaluar çdo shfaqje të tolerancës ose të

marrëveshjeve të fshehta për vepra të paligjshme (shih, mutatis mutandis, Hugh Jordan, i përmendur më lart, paragrafi 108 dhe paragrafët 136-140). Detyra e Gjykatës konsiston në rishikimin nëse dhe në ç'masë gjykatat, për të mbërritur në konkluzionin e tyre, mund të kërkohet të të dorëzojnë çështjen për një mbikëqyrje të kujdesshme siç kërkohet nga neni 2 i Konventës, në mënyrë që efekti i sigurues i sistemit gjyqësor në fjalë dhe rëndësia e rolit që kërkohet të luajë për të parandaluar shkeljet e të drejtës së jetës nuk janë minuar.⁴⁹

Në lidhje me nenin 3 të konventës, Gjykata ka parasysh që:

Në rastet e keqtrajtimit të vullnetshëm shkelja e nenit 3 nuk mund të kompensohet vetëm me një dhënie dëmshpërblimi viktimës. Kjo për arsye se, në rast se autoritetet mund të kufizojnë reagimin e tyre për incidentet e keqtrajtimit të vullnetshëm nga ana e agjentëve të shtetit në masën e pagimit të dëmshpërblimit, kur ndërkohë nuk bëjnë sa duhet për të ndjekur penalisht dhe për të ndëshkuar personat përgjegjës, ka mundësi që në disa raste për agjentët e shtetit që të abuzojnë me të drejtat e atyre që i mbajnë nën kontroll me një pandëshkueshmëri virtuale, dhe që ndalimi me ligj i torturës dhe trajtimit johuman dhe degradues, edhe pse është e një rëndësie themelore, mund të jetë joefektive në praktikë (shih, ndërmjet shumë autoriteteve të tjera, Krastanov, i cituar më lart, paragrafi 60; Çamdereli, i cituar më lart, paragrafi 29; dhe Vladimir Romanov, i cituar më lart, paragrafi 78).⁵⁰

Në Raportin e Përgjithshëm të 12 të KPT-së thuhet:

Një ekzaminim i kujdesshëm nga ana e autoriteteve gjyqësore dhe autoriteteve të tjera me rëndësi të të gjitha ankimeve për keqtrajtime nga ana e zyrtarëve të zbatimit të ligjit dhe, kur është e duhur, dhënien e dënimeve të përshtatshme do të kishte një efekt të fortë frenues. Në mënyrë reciproke, në rast se këto autoritete nuk ndërmarrin veprime efektive në bazë të ankimeve që u janë paraqitur atyre, zyrtarët e zbatimit të ligjit para se të keqtrajtonin personat që i kanë në ruajtje do të mendoheshin për atë se nuk do të shpëtonin pa u ndëshkuar.⁵¹

2. Kërkesat themelore për një hetim efektiv të cilat janë të përcaktuara në Udhëzimet V dhe VI gjithashtu i referohen fazës së ndjekjes penale.

Në kontekstin e nenit 3 të Konventës, Gjykata ka pikëpamjen se detyrimet procedurale për të hetuar të shtrihen në procedime si një e tërë:

Në bazë të praktikës ligjore të përcaktuar nga Gjykata, kur një individ bën një pohim të besueshëm që ai i është nënshtruar vuajtjes nga një trajtim që shkel nenin 3, e kjo nga duart e agjentëve të shtetit, autoritetet kombëtare kanë për detyrë që të kryejnë "një hetim zyrtar efektiv" të aftë për të zbuluar faktet dhe për të identifikuar dhe ndëshkuar personat përgjegjës (shih, Slimani kundër Francës, nr.57671/00, paragrafët 30 dhe 31, GJEDNJ 2004-IX (ekstrakte), dhe Assenov dhe të tjerë kundër Bullgarisë, vendimi gjyqësor i 28 Tetorit 1998, Raportet, paragrafi 102). Për më tepër, kërkesat procedurale të nenit 3 shkojnë më tej se faza paraprake hetimore kur, si në këtë rast, hetimi çoi në veprim ligjor të ndërmarrë para gjykatave kombëtare: procedimet si tërësi, përfshi edhe fazën gjyqësore, duhet të përputhen me kërkesat e ndalimit që përfshihet në nenin 3. Kjo do të thotë që autoritetet gjyqësore kombëtare duhet që në asnjë rast të jenë të përgatitura që të tolerojnë që shkaktimi i vuajtjes fizike e psikologjike të mbetet i pandëshkuar. Kjo është thelbësore në ruajtjen e besimit të publikut dhe për mbështetur zbatimin e ligjit për të parandaluar çdo shfaqje të

- 49 Öneriyildiz kundër Turqisë (nr.48939/99) vendimi gjyqësor i 30 Nëntorit 2004 [Dhoma e Madhe], paragrafi 96.
- 50 Gäfgen kundër Gjermanisë (nr.22978/05), vendimi gjyqësor i 1 Qershorit 2010 [Dhoma e Madhe], paagrafi 119.
- 51 Raport i Përgjithshëm i 12 për punën e KPT-së, që mbulon periudhën 1 Janar – 31 Dhjetor 2001 [KPT/Inf (2002) 15].

tolerancës së autoriteteve ndaj marrëveshjeve të fshehta në veprimet e paligjshme (shih, mutatis mutandis, Önergyildiz, i cituar më lart, paragrafi 96)⁵²

IX. Procedurat gjyqësore

1. Shtetet duhet të sigurojnë pavarësinë dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor, në përputhje me parimin e ndarjes së pushteteve.
2. Masat mbrojtëse duhet të merren për të siguruar që avokatët, prokurorët dhe gjykatësit mos të kenë frikë nga hakmarrja për ushtrimin e funksioneve të tyre.
3. Procedura duhet të përfundojë brenda një kohe të arsyeshme. Shtetet duhet të sigurojnë që autoritetet gjyqësore dhe hetimore të kenë në dispozicion mjetet e nevojshme për këtë qëllim.
4. Personat e akuzuar se kanë kryer shkelje të rënda të të drejtave të njeriut kanë të drejtë për një gjykim të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga ana e një gjykatë të pavarur dhe të paanshme të themeluar me ligj.

Principi i 4 i Principeve Bazë të Kombeve të Bashkuara për Pavarësinë e Gjyqësorit:

Nuk duhet të ketë asnjë ndërhyrje e panevojshme dhe e pajustificuar në procesin gjyqësor, dhe as që vendimet gjyqësore të Gjykatave do të jenë objekt i revizionimit. Ky princip nuk bën fjalë për rikikimin gjyqësor, ose të zbutjes ose ndryshimit të vendimeve gjyqësore të kryera nga një autoritet kompetent gjyqësor, e kjo në përputhje me ligjin.

X. Vendimet penale

Duke respektuar pavarësinë e gjykatave, kur janë vërtetuar shkelje të rënda të të drejtave të njeriut, përcaktimi i një dënimi të përshtatshëm duhet të vijoj. Vendimet penale të cilat janë marrë duhet të jenë efektive, proporcionale dhe të përshtatshme me veprën e kryer.

Në lidhje me aplikimin e dënimit minimal nga Gjykatat pa arsye të justifikuara, Gjykata konstaton:

Gjykata vëren, gjithashtu, se jo vetëm që ka qenë e brengosur ti japë mbështetje më të madhe çështjeve të vogla në fjalë, fatkeqësisht duke mos bërë procedime të gjithpërfshirëse, por mos-ndëshkueshmëria që rezulton hedh mjaft hije dyshimi për aftësinë e makinës gjyqësore të vënë në punë në këtë rast për të prodhuar një efekt të mjaftueshëm frenues për të mbrojtur plotësisht çdo njeri nga shkeljet e ndalimit absolut të përcaktuar në nenin 3.

[...]

Në pikëpamjen e përmendur më lart, Gjykata konsideron që vendimi gjyqësor i kundërshtuar sugjeron që gjykatësit e kanë ushtruar lirinë e tyre të veprimit më shumë për të minimizuar pasojat e një veprimi të paligjshëm jashtëzakonisht të rëndë se sa të tregojnë që veprime të tilla nuk do të tolerohen në asnjë mënyrë (shih paragrafin 65 si më sipër).⁵³

Në Raportin e Përgjithshëm të 14 të KPT-së thuhet:

41. Është e qartë se nuk ka rëndësi se sa i efektshëm një hetim mund të jetë, dobia e tij do të jetë e vogël, nëse sanksionet e vendosura për keqtrajtim janë të pamjaftueshme. Kur keqtrajtimi ka qenë provuar, dhënia e një dënimi të përshtatshëm duhet të ndjekë këtë hetim. Kjo do të ketë një ndikim shumë të fortë bindës. Nga ana tjetër, dhënia e dënimeve të lehta vetëm mund të

52 Okkali kundër Turqisë (nr.520067/99), vendimi gjyqësor i 17 Tetorit 2006, paragrafi 65.

53 Okkali kundër Turqisë (nr.52067/99), vendimi gjyqësor i 17 Tetorit 2006, paragrafët 70 dhe 75.

sjellë një klimë të tolerimit të mosndëshkimit.

Natyrisht, autoritetet gjyqësore janë të pavarura, dhe në këtë mënyrë ata janë të lirë për të caktuar, brenda parametrave të përcaktuara me ligj, masën e dënimit për çdo rast të veçantë. Megjithatë, me anë të këtyre parametrave, qëllimi i ligjvënësit duhet të jetë i qartë: se sistemi i drejtësisë penale duhet të adoptojë një qëndrim të ashpër në lidhje me torturën dhe format e tjera të keqtrajtimit. Në mënyrë të ngjashme, dënimet e dhëna duke ndjekur përcaktimin e fajshmërisë disiplinore duhet të jenë proporcionale me seriozitetin dhe rëndësinë e çështjes.⁵⁴

XI. Zbatimi i vendimeve gjyqësore të gjykatave vendase

Vendimet gjyqësore të gjykatave vendase duhet të zbatohet plotësisht dhe pa vonesë nga autoritetet kompetente.

Edhe pse e drejta për të pasur një gjykim para një gjykate vendase të zhvilluar sipas nenit 6 paragrafi 1 të Konventës nuk aplikohet ndaj palëve të treta që kërkojnë ndjekje penale të një autori, arsyetimi i Gjykatës në rastin e Hornsby kundër Greqisë për të drejtën për të pasur qasje në gjykatë lidhur me të drejtat dhe detyrimeve civile, na jep disa udhëzime të një rëndësie të përgjithshme për shpejtësinë e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës prerë dhe që janë të ekzekutueshme:

40. [...] Megjithëse, kjo e drejtë mund të jetë iluzore në rast se sistemi ligjor vendas i Shtetit kontraktual lejon që një vendim gjyqësor i formës prerë dhe që është i ekzekutueshëm ngelet pa veprim në dëm të njërit palë. [...] Ekzekutimi i vendimit gjyqësor të dhënë nga cilado gjykatë duhet të konsiderohet si një pjesë përbërëse e "gjykimit" për qëllimet e nenit 6.⁵⁵

XII. Bashkëpunimi ndërkombëtar

Bashkëpunimi ndërkombëtar luan një rol të rëndësishëm në luftën kundër mosndëshkimit. Me qëllim që të parandalohet dhe të çrrënjosjet mosndëshkimi, shtetet duhet të plotësojnë detyrimet e tyre, sidomos në lidhje me ndihmën ligjore reciproke, ndjekjet penale dhe ekstradimet, në përputhje me respektimin e të drejtave të njeriut, duke përfshirë parimin e "moskthimit", dhe qëllim të mirë. Për këtë qëllim, shtetet inkurajohen që të intensifikojnë bashkëpunimin e tyre përtej detyrimeve të tyre ekzistuese.

Në kontekstin e trafikimit me qenie njerëzore, Gjykata ka thënë:

Në vijim të detyrimeve për të zhvilluar hetim vendas për ngjarje që ndodhin në territoret e tyre, shtetet anëtare kanë gjithashtu për detyrë që në rastet e trafikimit ndërkufitar të bashkëpunojnë me efektivitet me autoritetet kompetente të shteteve të tjera që janë përfshirë në hetimin e ngjarjeve që kanë ndodhur jashtë territoreve të tyre.⁵⁶

Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në "Principet dhe Udhëzimet për të Drejtën e Kompensimit dhe të Riparimit për Viktimat e Shkeljeve të Mëdha të Ligjit Ndërkombëtar të të Drejtave të Njeriut dhe të e Shkeljeve të Rënda të Ligjit Humanitar Ndërkombëtar", thotë:

4. Në rastet e shkeljeve të rënda të së Ligjit ndërkombëtar të të drejtave të njeriut dhe shkeljeve serioze të së Ligjit humanitar ndërkombëtar që përbëjnë krime në bazë të Ligjeve ndërkombëtare, shtetet kanë për detyrë të hetojnë dhe nëse ka prova të mjaftueshme, kanë për detyrë

54 Raport i Përgjithshëm i 14 për punën e KPT-së, që mbulon periudhën 1 Gusht 2003 – 31 Korrik 2004 [KPT/Inf (2004) 28].

55 Hornsby kundër Greqisë (nr.18357/91), vendimi gjyqësor i 1 Prillit 1998, paragrafi 40.

56 Rantsev kundër Greqisë dhe Rusisë (nr.25965/04, vendimi gjyqësor i 7 janarit 2010, paragrafi 289.

të ndjekin penalisht personin që dyshohet se është përgjegjës për këto shkelje dhe, në qoftë se shpallet fajtor, kanë për detyrë që ta ndëshkojnë atë. Për më tepër, në këto raste, Shtetet duhet, që në përputhje me ligjet ndërkombëtare, të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin dhe për të ndihmuar organet gjyqësore ndërkombëtare kompetente në hetimin dhe ndjekjen penale të këtyre shkeljeve.

Këshilli i Evropës me “Konventën Evropiane për Ekstradimin” të 13 Dhjetorit 1975 dhe me “Konventën Evropiane të Ndihmës së Ndërsjellët në Çështjet Penale” të 20 Prillit 1959 ka rregulluar bashkëpunimin ndërkombëtar në lidhje me procedimet penale.

Në lidhje me principin e moskthimit, qëndrimi i Gjykatës është:

Me që mbrojtja kundër keqtrajtit ndalohet në mënyrë absolute nga neni 3, kjo dispozitë përcakton detyrimin për të mos ekstraduar ose të dëbuar cilindo person që, në vendin pritës, e pret një rrezik real që të bëhet objekt i një trajtimi të tillë. Siç Gjykata është shprehur në mënyrë të përsëritur, nuk mund të bëhet shmangie nga ky rregull (shih praktikën gjyqësore të cituar më lart në paragrafin 127). Prandaj, ajo duhet të riafirmojnë parimin e deklaruar në vendimin gjyqësor Chahal (të cituar më lart, paragrafi 81) se nuk është e mundur që të vlerësohet rreziku i keqtrajtit në bazë të arsyeve të paraqitura për dëbimin, në mënyrë për të përcaktuar nëse përgjegjshmëria e një shteti përfshihet në dispozitën nenit 3, edhe kur një trajtim i tillë është imponuar nga një shtet tjetër.⁵⁷

Në bazë të Udhëzimit XII paragrafi 2 të “Udhëzimeve për të drejtat e njeriut dhe të luftës kundër terrorizmit” të Komitetit të Ministrave,

Është detyrë e shtetit që ka pranuar një kërkesë për azil për të siguruar që një kthim i mundshëm (“dëbimi”) i paraqitësit të kërkesës në vendin e tij ose të saj të origjinës nuk do ta ekspozojë atë ndaj dënimit me vdekje, torturës ose trajtimit degradues ose ndëshkim. Po kjo vlen edhe për dëbimin.

XIII. Përgjegjësia e vartësve

Ndërkohë që zbatimi i urdhrave ose udhëzimeve të dhëna nga një epror mund të ndikojë tek dënimi, kjo gjë nuk mund të shërbejë si një rrethanë për të përjashtuar përgjegjësinë për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut

Nën titullin “Përgjegjësia penale individuale”, si neni 7 i Statutit të Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë, ashtu edhe neni 6 i Statutit të Tribunalit Penal Ndërkombëtar për Ruandën deklarohet:

4. Fakti që një person i akuzuar ka vepruar në bazë të një urdhri të qeverisë apo eprorit nuk e liron atë nga përgjegjësia penale, por mund të merret parasysh për uljen e dënimit nëse Gjykata Ndërkombëtare vendos se kështu e kërkon drejtësia.

Statuti i Romës për Gjykatën Ndërkombëtare Penale përcakton parimin e urdhrave të drejtuesve në Nenin 33 (“Urdhrat e drejtuesve dhe parashkrimi ligjor”). Në Rezolutën e Kuvendit 1675 (2009) mbi “Gjendjen e të drejtave të njeriut në Evropë: nevoja për të çrrënjësuar mosndëshkimin”, Asambleja Parlamentare ka deklaruar se:

3. Asambleja më tej përkujton se është e njohur në nivel ndërkombëtar, që nga gjykimet e Nurembergut dhe Tokios të kryera në prag të Luftës së Dytë Botërore, se justifikimi i thjesht ndjekjes së urdhrave apo udhëzimeve nga eprorët nuk është i vlefshëm për rastet e shkeljeve të rënda të drejtave të njeriut.

57 Saadi kundër Italisë (nr.37201/06, vendimi gjyqësor i 28 Shkurtit 2008 [Dhoma e Madhe], paragrafi 138.

Shihni gjithashtu Parimin 27 ("Kufizimet për justifikimet që lidhen me bindjen e nevojshme, përgjegjësinë e eprorëve dhe statusin zyrtar") të "Grupit të Parimeve për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Njeriut me anë të Veprimit për të luftuar Mosndëshkimin" të Komisionit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut i datës 8 shkurt 2005.

XIV. Kufizime dhe limitime

Shtetet duhet të mbështesin, me të gjitha mjetet e mundshme, hetimin e shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut dhe ndjekjen penale të autorëve të dyshuar. Kufizimet dhe limitimet e ligjshme në hetimet dhe ndjekjet penale duhet të kufizohen në masën minimale të nevojshme për të arritur qëllimin e tyre.

Në lidhje me kufizimet dhe limitimet, Gjykata ka theksuar:

[...] ku një agjent i shtetit ka qenë i akuzuar për krime që përfshijnë torturën apo keqtrajtimin, është shumë e rëndësishme për qëllimet e një "zgjidhjeje efektive" që procedurat penale dhe dënimet të mos jenë të parashkuara dhe të mos lejohet dhënia e amnistisë ose faljes.⁵⁸

XV. Mekanizmat jashtë gjyqësore

Shtetet duhet të konsiderojnë krijimin e mekanizmave jashtë gjyqësore si diskutimet parlamentare ose diskutimet e tjera publike, Avokatin e Popullit, komisionet e pavarura dhe ndërmjetësimin si procedura të dobishme plotësuese për mjetet juridike vendase të garantuara në bazë të Konventës.

XVI. Dëmshpërblimi

Shtetet duhet të marrin të gjitha masat e duhura për të krijuar mekanizma të qasshëm dhe efektivë të cilët sigurojnë që viktimat e shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut të marrin dëmshpërblimin e menjëhershëm dhe adekuat për dëmin e pësuar. Kjo mund të përfshijë masat e rehabilitimit, kompensimit, shpërblimit moral, kthimit dhe garancisë që se një gjë e tillë nuk do të përsëritet.

E drejta për dëmshpërblime është e përpunuar në Parimet dhe Udhëzimet e Kombeve Bashkuara për të drejtën e dëmshpërblimit dhe kompensimit për viktimat e shkeljeve të rënda të së Drejtës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut dhe Shkeljeve Serioze të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare, në veçanti Parimet 15-24⁵⁹, dhe Grupi i parimeve për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Njeriut me anë të Veprimit për të luftuar Mosndëshkimin, Parimet 31-34.

Kjo është pohuar më tej nga një gamë e gjerë e dispozitave të traktateve ndërkombëtare, siç janë nenet 2 (3), 9 (5) dhe 14 (6) të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, si dhe në nenet 5 (5), 13 dhe 41 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Shihni gjithashtu Konventën Evropiane për Dëmshpërblimin e Viktimave të Krimeve të Dhunshme të datës 24 nëntor 1983 dhe Rekomandimin e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për shtetet anëtare mbi ndihmën ndaj viktimave të krimit të 14 qershorit 2006.

58 Yaman kundër Turqisë (nr. 32446/96), gjykim i datës 2 nëntor 2004, paragrafi 55. Shihni gjithashtu çështjet e Yeter kundër Turqisë (nr. 33750/03), gjykim i datës 13 janar 2009, paragrafi 70; dhe Ould Dah kundër Francës (nr. 13113/03), gjykim i 17 mars 2009, f. 17.

59 Përcaktimet e termave rehabilitim, dëmshpërblim, shpërblim moral, kthim dhe garanci për mospërsëritje janë dhënë në paragrafet 20 deri 24 të këtyre parimeve.